



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 146

Tiranë – E mërkurë, 30 tetor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 63/2019 datë 3.10.2019	Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban” 12063
Ligj nr. 64/2019 datë 3.10.2019	Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban” 12097
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 9, datë 25.10.2019	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 4, datë 14.5.2019 “Për kriteret dhe nivelin e vlerësimit, si dhe detajimi i pikësimit për të gjitha kategoritë ujore në ujërat e brendshme, format e tjera të peshkimit në det pa përdorimin e mjeteve lundruese, dhe zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike tokësore dhe ujore, për procedurën e konkurrimit publik..... 12109
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Eni themeli..... 12109



LIGJ
Nr. 63/2019

Numri i kontratës (FI N°) 87316
Numri i operacionit (Serapis N°) 2016-1020

**PËR RATIFIKIMIN E KONTRATËS
FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS
EUROPIANE TË INVESTIMEVE, PËR
PROJEKTIN “SHTRATI I LUMIT LANA
– ZHVILLIM URBAN”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet kontrata financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 3.10.2019

**SHTRATI I LUMIT LANA –
ZHVILLIM URBAN
KONTRATA FINANCIARE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS EVROPIANE TË INVESTIMEVE
POZNAN, 5 KORRIK 2019**

Kjo Kontratë është lidhur ndërmjet: Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, znj. Anila Denaj, në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (**Huamarrësi**), në njërën anë dhe Bankës Europiane të Investimeve, me seli në adresën: 100 Blvd Konrad Adenauer, Luxembourg, L-2950 Luxembourg, z. Luca Lazzaroli, drejtor i Përgjithshëm dhe zëvendësdrejtor i Operacioneve dhe z. Alessandro Cagnato, Këshilltar Ligjor (**Banka**), në anën tjetër.

Duke pasur parasysh se:

a) Huamarrësi ka deklaruar, se, nëpërmjet Bashkisë së Tiranës (**Zbatuesi**) po ndërmerr një projekt të rihvillimit urban të shtratit të lumit Lana (rreth 2 km) në qytetin e Tiranës, siç përshkruhet më gjerësisht në përshkrimin teknik (**Përshkrimi teknik**) të paraqitur në skedulin A.1 (**Projekti**);

b) kostoja totale e Projektit, siç vlerësohet nga Banka, është 23,770,000 euro (njëzet e tre milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë mijë euro), që do të financohet si më poshtë:

Burimi	Shuma (euro m)
Kredi nga Banka	8.00
Fondet e Buxhetit të	
Bashkisë	13.37
Granti	2.4
TOTALI	23.77

c) në mënyrë që të përmbushë planin e financimit të përcaktuar në paragrafin “b”, Huamarrësi ka kërkuar nga Banka një kredi prej 8,000,000.00 eurosh (tetë milionë euro) që do të vihet në dispozicion nga burimet e veta të Bankës dhe në përputhje me mandatin e huadhënies së jashtme të bankës 2014–2020, në përputhje me vendimin (**Mandati**);



d) në përputhje me:

i. vendimin nr. 466/2014/BE, të botuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian nr. L 135, datë 8 maj 2014, Parlamenti Europian dhe Këshilli i Bashkimit Europian vendosën të japin një garanci për Bankën kundrejt humbjeve, nën financimin e operacioneve mbështetëse të projekteve të investimeve, jashtë Bashkimit Europian (**Vendimi**); dhe

ii. marrëveshjen e lidhur midis Bashkimit Europian, e përfaqësuar nga Komisioni Europian dhe Banka që zbaton vendimin;

e) në rast mospagesash, Bashkimi Europian, me një garanci, mbulon pagesa të caktuara që nuk janë marrë nga Banka dhe të detyrueshme për t'i paguar Bankës, në lidhje me operacionet e financimit të Bankës të lidhura me, ndër të tjera, Huamarrësin (**Garancia e BE-së**). Duke filluar nga data e kësaj Kontrate (siç përcaktohet më poshtë), Republika e Shqipërisë është një vend i pranueshëm (siç përcaktohet më poshtë). Më 5 shkurt 1998, Republika e Shqipërisë dhe Banka nënshkruan një marrëveshje kuadër që rregullon veprimtaritë e Bankës në territorin e Republikës së Shqipërisë (**Marrëveshja Kuadër**). Banka e bën huan (siç është përcaktuar më poshtë) të disponueshme në bazë të faktit se Marrëveshja Kuadër vazhdon të jetë në fuqi dhe efekt gjatë gjithë periudhës së kësaj Kontrate. Me anë të një letre, të datës 14 dhjetor 2016, Republika e Shqipërisë konfirmoi se Projekti (siç përcaktohet më poshtë) është në përputhje me objektin e Marrëveshjes Kuadër. Banka e bën Huan të disponueshme për Huamarrësin, në bazë të faktit se këto deklarata vazhdojnë të jenë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet gjatë afatit të kësaj Kontrate;

f) Banka, duke konsideruar se financimi i Projektit është brenda objektit të funksioneve të saj, dhe në përputhje me objektivat e mandatit, dhe duke pasur parasysh deklaratat dhe faktet e cituara në këto paragrafë, ka vendosur t'i japë efekt kërkesës së Huamarrësit, duke i siguruar atij një kredi në shumën prej 8,000,000.00 eurosh (8 milionë euro), sipas kësaj Kontrate financiare (**Kontrata**); me kusht që shuma e huas së Bankës, në asnjë rast, të mos kalojë 50% (pesëdhjetë për qind) të koston totale të Projektit të përcaktuar në pikën "b";

g) Huamarrësi ka autorizuar huamarrjen e shumës prej 8,000,000.00 eurosh (tetë milionë euro) të përfaqësuar nga kjo hua, sipas kushteve dhe termave të përcaktuar në këtë Kontratë;

h) Projekti kontribuon në objektivat e Iniciativës së Elasticitetit Ekonomik të Bankës (ERI), që synon mbështetjen e investimeve për infrastrukturën jetike në vend;

i) statuti i Bankës parashikon që Banka do të sigurojë që fondet e saj të përdoren në mënyrë sa më racionale në interes të Bashkimit Europian dhe, në përputhje me rrethanat, kushtet dhe termat e operacioneve të huas së Bankës. duhet të jenë në përputhje me politikat përkatëse të Bashkimit Europian. Banka konsideron se aksesimi në informacion luan rol thelbësor në reduktimin e rreziqeve mjedisore dhe sociale, duke përfshirë shkeljet e të drejtave të njeriut të lidhura me projektet që financon dhe për këtë arsye ka krijuar politikën e saj të transparencës, qëllimi i së cilës është rritja e llogaridhënies së Grupit të Bankës ndaj aksionarëve të saj;

j) përpunimi i të dhënave personale do të kryhet nga Banka, në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm të Bashkimit Europian, për mbrojtjen e individëve, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga institucionet dhe organet e Bashkimit Europian dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave.

Tani, si rrjedhojë, është rënë dakord si më poshtë:

INTERPRETIMI DHE PËRKUFIZIME

Interpretime

Në këtë Kontratë:

a) referencat për nenet, paragrafët, skedulet dhe anekset janë, përveç rasteve kur përcaktohen shprehimisht ndryshe, referenca përkatësisht neneve dhe paragrafëve, skeduleve dhe anekseve të kësaj Kontrate;

b) referencat në lidhje me "ligjin" ose "ligjet" do të thotë:

i. çdo ligj dhe çdo traktat i zbatueshëm, kushtetutë, statut, legjislacion, dekret, akt normativ, rregull, rregullore, gjykim, urdhër, urdhër gjyqësor, vendim gjyqësor, vendim përfundimtar, vendim përfundimtar arbitrazhi apo masë tjetër legjislative ose administrative ose vendime gjyqësore ose arbitrazhi në çdo juridiksion që është sipas ligjit detyrues ose i zbatueshëm; dhe

ii. ligji i BE-së;



c) referencat ndaj “ligjit të zbatueshëm”, “ligjeve të zbatueshme” apo “juridiksionit të zbatueshëm”, do të thotë:

i. një ligj ose juridiksion i zbatueshëm për Huamarrësin, të drejtat dhe/ose detyrimet e tij (në secilin rast, që lindin nga ose në lidhje me këtë Kontratë), kapacitetin dhe/ose asetet dhe/ose Projektin; dhe/ose, sipas rastit; ose

ii. një ligj ose juridiksion (duke përfshirë në çdo rast Statutin e Bankës) të zbatueshëm për Bankën, të drejtat, detyrimet, kapacitetet dhe/ose asetet e saj;

d) referencat për një dispozitë të ligjit janë referenca për atë dispozitë të ndryshuar ose rimiruar;

e) referencat ndaj çdo marrëveshjeje ose instrumenti tjetër janë referenca për atë marrëveshje ose instrument tjetër të ndryshuar, zëvendësuar, plotësuar, zgjeruar ose riparaqitur; dhe

f) fjalët dhe shprehjet në shumës do të përfshijnë numrin njëjës dhe anasjelltas.

Përkufizimet

Në këtë Kontratë:

“Transhi i pranuar” do të thotë një transh, në lidhje me të cilin një ofertë e disbursimit është pranuar në mënyrë të rregullt nga Huamarrësi, në përputhje me kushtet e tij në ose para afatit të fundit të pranimit të disbursimit.

“Data e miratuar e shtyrjes së disbursimit” ka kuptimin që i është dhënë në nenin 1.5.A(2)(b).

“Autorizim” nënkupton autorizimin, lejen, pëlqimin, miratimin, zgjidhjen, licencën, përjashtimin, paraqitjen, noterizimin ose regjistrimin.

“Nënshkruesi i autorizuar” nënkupton një person të autorizuar që të nënshkruajë në mënyrë individuale ose bashkërisht (sipas rastit) pranimet e disbursimit, në emër të Huamarrësit, dhe të përmendur në listën më të fundit të nënshkruesve dhe llogarisë, të autorizuar, të marra nga Banka, para marrjes së pranimit përkatës të disbursimit.

“Ditë pune” do të thotë një ditë (përveç së shtunës apo së dielës), në të cilën Banka dhe bankat tregtare janë të hapura për biznes të përgjithshëm në Luksemburg dhe në Tiranë.

“Ngjarja e ndryshimit të ligjit” ka kuptimin e dhënë në nenin 4.3.A(3).

“Kontratë” ka kuptimin e dhënë në paragrafin “P”.

“Numri i kontratës” do të thotë numri i gjeneruar i Bankës që identifikon këtë Kontratë dhe i caktuar në faqen e parë të kësaj Kontrate pas shkronjave “FIN”.

“Kredi” ka kuptimin e dhënë në nenin “b”.

“Dëmshpërblim i shtyrjes” nënkupton një tarifë të llogaritur mbi shumën e disbursimit të shtyrë ose të pezulluar, duke qenë më e larta ndër:

a) 0.125% (12.5 pikë bazë), në vit; dhe

b) shkalla e përqindjes me të cilën:

i. norma e interesit që do të ishte e zbatueshme për një shumë të tillë, nëse ajo do t'i ishte disbursuar Huamarrësit në datën e planifikuar të disbursimit, tejkalon;

ii. EURIBOR (norma njëmuajore) më pak se 0.125% (12.5 pikë bazë), përveç nëse kjo vlerë është më pak se zero, e cila në atë rast do të vendoset në zero.

Një tarifë e tillë do të rritet nga data e planifikuar e disbursimit deri në datën e disbursimit ose, sipas rastit, deri në datën e anulimit të transhit të pranuar, në përputhje me këtë Kontratë.

“Pranimi i disbursimit” nënkupton një kopje të ofertës së disbursimit, të sigluar siç duhet nga Huamarrësi.

“Afati i fundit për pranimin e disbursimit” nënkupton datën dhe kohën e skadimit të ofertës së disbursimit, siç është specifikuar aty.

“Llogari e disbursimit” do të thotë, në lidhje me secilin transh, llogarinë bankare të përcaktuar në listën më të fundit të nënshkruesve dhe llogarisë së autorizuar.

“Data e disbursimit” do të thotë data në të cilën pagesa e një transhi është bërë nga Banka.

“Oferta e disbursimit” do të thotë një letër kryesisht në formën e paraqitur në skedulën “C”.

“Mosmarrëveshje” ka kuptimin e dhënë në nenin 11.2.

“Rast i ndërprerjes” do të thotë njëra ose të dyja prej:

a) një ndërprerje materiale në ato sisteme të pagesave ose të komunikimit ose në ato tregje financiare, të cilat në çdo rast janë të detyruara të veprojnë në mënyrë që pagesat të bëhen në lidhje me këtë Kontratë; ose

b) ndodhia e çdo ngjarjeje tjetër që rezulton në një ndërprerje (të natyrës teknike ose të sistemit), në operacionet e thesarit ose të pagesave, si të Bankës ashtu edhe të Huamarrësit, duke parandaluar atë palë nga:



i. kryerja e detyrimeve të saj të pagesës sipas kësaj Kontrate; ose

ii. komunikimi me palët e tjera,

dhe ndërprerje, e cila (në asnjë rast të tillë si në “a” ose “b” më sipër) nuk është shkaktuar nga dhe është përtej kontrollit të palës, operacionet e së cilës janë ndërprerë.

“Data e efektivitetit” ka kuptimin e dhënë asaj në nenin 12.3.

“Manual mjedisor dhe social i EIB-it” nënkupton manualin që siguron një përkthim funksional të politikave dhe të parimeve të përfshira në Deklaratën e parimeve dhe standardeve mjedisore dhe sociale të EIB-it dhe që është publikuar në faqen e internetit të Bankës.

“Deklarata e EIB-it për parimet dhe standardet mjedisore dhe sociale” nënkupton deklaratën e publikuar në faqen e internetit të EIB-it, që përcakton standardet që Banka kërkon nga projektet që financon dhe përgjegjësitë e palëve të ndryshme.

“Vend i pranueshëm” do të thotë çdo vend i specifikuar në aneksin III të vendimit, siç mund të ndryshohet herë pas here nga Komisioni Evropian, në përputhje me nenet 4(2) dhe 18 të vendimit ose, çdo vend tjetër, në lidhje me të cilin Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian kanë miratuar një vendim, në përputhje me nenin 4(1) të vendimit.

“Mjedis” do të thotë si më poshtë, në masën që ato ndikojnë në shëndetin e njeriut dhe mirëqenien sociale:

- a) fauna dhe flora;
- b) toka, uji, ajri, klima dhe peizazhi;
- c) trashëgimia kulturore; dhe
- d) mjedisi i ndërtimit.

“Standardet Mjedisore dhe Sociale” do të thotë:

a) çdo ligj mjedisor dhe çdo ligj social që zbatohet për projektin ose zbatuesin;

b) deklarata e EIB-it për Parimet dhe standardet mjedisore dhe sociale, siç përcaktohet në Manualin mjedisor dhe social të EIB-it;

c) studimet e vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social; dhe

d) plani i veprimit social.

“Miratim mjedisor ose social” nënkupton çdo leje, licencë, autorizim, pëlqim ose miratim tjetër të kërkuar nga një ligj mjedisor ose ligj social, në lidhje me ndërtimin ose funksionimin e Projektit.

“Kërkesë mjedisore ose sociale” nënkupton çdo

kërkesë, procedurë, njoftim zyrtar ose hetim, nga cilido person, në lidhje me mjedisin ose çështjet sociale që ndikojnë në Projekt, duke përfshirë çdo shkelje apo pretendim të shkeljeve të ndonjë standardi mjedisor dhe social.

“Dokumentet mjedisore dhe sociale” do të thotë:

a) kopja e Autorizimit Mjedisor të lëshuar nga Autoriteti Kompetent, me konfirmimin se Projekti nuk ndikon në ndonjë zonë të mbrojtur natyrore;

b) kopja e planit të menaxhimit të mjedisit;

c) kopjet e të gjitha dokumenteve që përbëjnë Planin e veprimit social, duke përfshirë Planin e veprimit për zhvendosje (PVZ); Planin e angazhimit të palëve të interesuara dhe një mekanizëm të gjerë të ankesave në të gjithë projektin.

“Plan i menaxhimit mjedisor dhe social (PMMS)” nënkupton planin që është pjesë e vlerësimit mjedisor dhe social dhe përcakton masat e nevojshme për të maksimizuar përfitimet e Projektit, për të shmangur, për të minimizuar, për të zvogëluar dhe për të kompensuar (në rastin e mjedisit) ose korrigjimin (në rastin e ndikimeve shoqërore), çdo ndikim negativ mjedisor dhe shoqëror, së bashku me vlerësimet e buxhetit dhe kostos, burimet e financimit dhe masat e duhura institucionale, raportuese të monitorimit dhe llogaridhënies, të aftë për të siguruar zbatimin e duhur dhe reagimet e rregullta, mbi pajtueshmërinë me planin e menaxhimit/të veprimit mjedisor dhe social

“Ligj mjedisor” do të thotë:

a) Ligji i BE-së në masën që zbatohet në ligjet e Republikës së Shqipërisë ose, siç përcaktohet nga Banka, para datës së kësaj Kontrate;

b) ligjet dhe rregulloret e Republikës së Shqipërisë; dhe

c) traktatet dhe konventat ndërkombëtare të zbatueshme, të nënshkuara, të ratifikuara ose të zbatueshme dhe të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë,

në secilin rast, prej të cilit një objektiv kryesor është ruajtja, mbrojtja ose përmirësimi i mjedisit.

“Garancia e BE-së” ka kuptimin që i është dhënë në pikën “b”.

“Ligji i BE-së” nënkupton *Acquis Communautaire* të Bashkimit Evropian, siç shprehet nëpërmjet traktateve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë të Bashkimit Evropian.



“EURO” ose “euro” nënkupton monedhën e ligjshme të shteteve anëtare të Bashkimit European, që e miratojnë ose e kanë miratuar atë si monedhë të tyre, në përputhje me dispozitat përkatëse të Traktatit për Bashkimin European dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit European.

“EURIBOR” ka kuptimin që i është dhënë në skedulin “B”.

“Rast i mospërmbushjes së detyrimit” do të thotë secila nga rrethanat, rastet ose ngjarjet e specifikuar në nenin 10.1.

“Datë e vlefshmërisë përfundimtare” do të thotë dita që bie 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga data e efektivitetit, e cila në çdo rast, nuk do të zgjasë më shumë se sa dita që bie 40 (dyzet) muaj nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

“Financim i terrorizmit” nënkupton sigurimin ose grumbullimin e fondeve, në çdo mënyrë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me qëllim që të përdoren ose, të qenit në dijeni që do të përdoren plotësisht ose pjesërisht për të kryer ndonjë shkelje, sipas kuptimit të neneve 1 deri 4 të vendimit kuadër të Këshillit të BE-së 2002/475/JHA të 13 qershorit 2002, mbi luftën kundër terrorizmit.

“Normë fikse” nënkupton një normë vjetore interesi të përcaktuar nga Banka, në përputhje me parimet e zbatueshme herë pas here, të përcaktuara nga organet drejtuese të Bankës për huat e kryera me një normë fikse interesi, të shprehur në monedhën e Transhit dhe duke dhënë kushte ekuivalente për shlyerjen e kapitalit dhe pagesën e interesit. Norma e tillë nuk do të jetë me vlerë negative.

“Transh me normë fikse” do të thotë një transh në të cilën zbatohet norma fikse.

“Normë e ndryshueshme” do të thotë një normë interesi vjetore e luhatshme fikse, e përcaktuar nga Banka për secilën periudhë të njëpasnjëshme të referencës me norma të ndryshueshme, e barabartë me EURIBOR plus marzhin. Nëse norma e ndryshueshme, për çdo periudhë referimi të normës së ndryshueshme, llogaritet të jetë nën zero, do të vendoset në zero.

“Periudhë e referimit të normës së ndryshueshme” nënkupton secilën periudhë nga një datë e pagesës deri në datën tjetër përkatëse të pagesës; periudha e parë e referencës së normës së ndryshueshme fillon në datën e livrimit të transhit.

“Transh me normë të ndryshueshme” do të thotë një transh në të cilën zbatohet norma e ndryshueshme.

“Marrëveshje Kuadër” ka kuptimin e dhënë në paragrafin “e”.

“GAAP” nënkupton parimet kontabël të pranuar përgjithësisht në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë IFRS-në.

“Udhëzues i prokurimit” nënkupton Udhëzuesin e prokurimit të publikuar në faqen e internetit të EIB-it, që informon zbatuesit për projekte të financuara tërësisht ose pjesërisht nga EIB-i, për organizimet që duhet të bëhen për prokurimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin.

“IFRS” nënkupton standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, brenda kuptimit të Rregullores IAS 1606/2002, në masën që zbatohet në pasqyrat financiare përkatëse.

“ILO” nënkupton Organizatën Ndërkombëtare të Punës.

“Standardet ILO” nënkupton çdo traktat, konventë ose zotim të ILO-së, të nënshkruar dhe të ratifikuar nga ose, ndryshe, të zbatueshme dhe të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë dhe standardet bazë të punës (siç përcaktohet në deklaratën e ILO-së, Mbi parimet themelore dhe të drejtat në punë).

“Ngjarje e parapagimit të zhdëmtimit” nënkupton një ngjarje të parapagimit, përveç atyre të specifikuar në paragrafët 4.3.A(2) ose 4.3.A(4).

“Rivlerësim/konvertim i interesit” do të thotë përcaktimi i kushteve të reja financiare në lidhje me normën e interesit, në mënyrë të veçantë, në bazë të normës së interesit (rivlerësim) ose një baze të ndryshme interesi (konvertim), që mund të ofrohet për periudhën e mbetur të një transhi ose deri në datën e ardhshme të rivlerësimit/konvertimit, nëse ka.

“Datë e rivlerësimit/e konvertimit të interesit” do të thotë data, e cila do të jetë një datë e pagesës, e specifikuar nga Banka, në përputhje me nenin 1.2B në ofertën e disbursimit.

“Propozim i rivlerësimit/konvertimit të interesit” do të thotë një propozim i bërë nga Banka sipas skedulit D.

“Kërkesë e rivlerësimit/e konvertimit të interesit” do të thotë një njoftim me shkrim nga Huamarrësi, të dorëzuar të paktën 75 (shtatëdhjetë e pesë) ditë para datës së rivlerësimit/konvertimit



të interesit, duke kërkuar nga Banka që të paraqesë një propozim për ndryshimin/konvertimin e interesit. Gjithashtu, kërkesa e rivlerësimit/e konvertimit të interesit, duhet të specifikojë:

a) datat e pagesave të zgjedhura, në përputhje me dispozitat e nenit 3.1;

b) shumën e transhit për të cilën do të zbatohet rivlerësimi/konvertimi i interesit; dhe

c) çdo datë e mëtejshme e rivlerësimit/konvertimit të interesit e zgjedhur, në përputhje me nenin 3.1.

“Lista e nënshkruesve dhe e llogarisë të autorizuar” nënkupton një listë, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën, duke përcaktuar:

a) nënshkruesit e autorizuar, të shoqëruar me dëshmi të autoritetit nënshkrues të personave të përmendur në listë dhe duke specifikuar nëse ata kanë autoritet individual ose të përbashkët nënshkrues;

b) nënshkrimet model të këtyre personave; dhe

c) llogarinë bankare në të cilën mund të kryhen pagesa sipas kësaj Kontrate (të specifikuar nga kodi IBAN, nëse vendi është përfshirë në regjistrin IBAN, të publikuar nga SWIFT ose në formatin përkatës të llogarisë, në përputhje me praktikën bankare lokale), kodi BIC/SWIFT i bankës dhe emri i zbatuesit të llogarisë bankare.

“Hua” nënkupton shumën totale të shumave të disbursuara, herë pas here nga Banka, sipas kësaj Kontrate.

“Hua e papaguar” nënkupton shumën totale të shumave të disbursuara, herë pas here nga Banka, sipas kësaj Kontrate që mbetet e papaguar.

“Mandat” ka kuptimin e dhënë në paragrafin “b”.

“Rast i mosfunksionimit të tregut” do të thotë një nga rrethanat e mëposhtme:

a) ekzistojnë, sipas mendimit të Bankës, ngjarje ose rrethana që ndikojnë negativisht në aksesin e Bankës në burimet e saj të financimit;

b) sipas mendimit të Bankës, fondet nuk janë të disponueshme nga burimet e zakonshme të financimit të Bankës, për të financuar në mënyrë të mjaftueshme një transh në monedhën përkatëse dhe/ose për maturimin përkatës dhe/ose në lidhje me profilin e rimbursimit të këtij transhi; ose

c) në lidhje me një transh për të cilin interesi do të paguhej në normën e ndryshueshme:

i. kostoja e Bankës për sigurimin e fondeve nga burimet e saj të financimit, siç përcaktohet nga Banka, për një periudhë të barabartë me periudhën e referencës së normës së ndryshueshme të një transhi të tillë (d.m.th., në tregun e parasë) do të jetë më e lartë se EURIBOR; ose

ii. nuk është e mundur të përcaktohet EURIBOR, në përputhje me përkufizimin e përfshirë në skedulin B.

“Ndryshim material negativ” do të thotë, në lidhje me Huamarrësin, çdo ngjarje ose ndryshim i gjendjes që ndikon te Huamarrësi, i cili, sipas mendimit të arsyeshëm të Bankës:

a) do të dëmtojë materialisht aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate; ose

b) do të dëmtojë materialisht gjendjen financiare apo perspektivat e Huamarrësit.

“Datë e maturimit” nënkupton datën e fundit të shlyerjes së një transhi të specifikuar në përputhje me nenin 4.1A(b)(iv) ose vetëm datën e shlyerjes së një transhi të specifikuar, sipas nenit 4.1B.

“Pastrim i parave” nënkupton:

a) konvertimin ose transferimin e pasurisë, duke ditur se prona e tillë rrjedh nga veprimtari kriminale ose nga një akt pjesëmarrjeje në një aktivitet të tillë, me qëllim fshehjen ose maskimin e origjinës së paligjshme të pronës ose ndihmën e çdo personi që është i përfshirë në kryerjen e një aktiviteti të tillë për të shmangur pasojat ligjore të veprimit të tij;

b) fshehjen ose maskimin e natyrës, burimit, vendndodhjes, disponimit, lëvizjes, të drejtave në lidhje me pronësinë e pronës, duke ditur se prona e tillë rrjedh nga veprimtari kriminale ose nga një akt pjesëmarrjeje në një aktivitet të tillë;

c) blerjen, zotërimin ose përdorimin e pronës, duke ditur në kohën e pranimin se prona e tillë është nxjerrë nga veprimtaria kriminale ose nga një akt pjesëmarrjeje në një aktivitet të tillë; ose

d) pjesëmarrjen, qëllimin për të kryer, tentativën për të kryer dhe për të ndihmuar, për të përkrahur, për të lehtësuar dhe për të këshilluar kryerjen e ndonjë prej veprimeve të përmendura në pikat e mësipërme.

“Financimi jo-EIB” ka kuptimin që i jepet në nenin “b”.

“Datë e pagesës” do të thotë: datat vjetore, gjysmëvjetore ose tremujore të specifikuar në ofertën e disbursimit deri në dhe duke përfshirë datën e rivlerësimit/konvertimit të interesit, nëse ka



ose, datën e maturimit, përveç se, në rast se ndonjë datë e tillë nuk është një ditë pune e përshtatshme, kjo do të thotë:

a) për një transh me normë fikse, ditët e përshtatshme të punës në vijim, pa rregullim të interesit të parashikuar sipas nenit 3.1, me përjashtim të atyre rasteve kur kryhet pagesa:

i. në mënyrë të plotë dhe në lidhje me rivlerësimin/konvertimin e interesit, në përputhje me skedulën D, pikën C; ose

ii. në një transh të vetëm në përputhje me nenin 4.1.B dhe vetëm me pagesën e interesit përfundimtar, kur do të nënkuptohet dita e mëparshme e punës përkatëse me përshtatjen e interesit sipas nenit 3.1; dhe

b) për një transh me normë të ndryshueshme, datën e nesërme, nëse ka, të atij muaji kalendarik që është ditë pune e përshtatshme ose, në mungesë të saj, ditës më të afërt pararendëse që është ditë pune e përshtatshme, në të gjitha rastet me korrigjimin përkatës të interesit sipas nenit 3.1.

“Persona të prekur nga projekti (PPP)” do të thotë të gjithë personat e ndikuar nga rivendosja e pavullnetshme. Kjo përfshin të gjithë anëtarët e familjes (gratë, burrat, vajzat, djemtë, përfshirë disa breza në rastin e familjeve të zgjeruara); pronari dhe punonjësit e një biznesi; anëtarë të një grupi të pakicave etnike; qiramarrësit; pronarët e tokës dhe aksionarët; kolonët joformalë (d.m.th. mungojnë tituj zyrtarë); mbajtësit e të drejtave të zakonshme të tokës; operatorët joformalë të biznesit dhe punonjësit/asistentët e tyre.

“Njësi e zbatimit të projektit (NZP)” do të thotë të gjitha organizimet e zbatimit të projektit, të cilat mbështeten në një grup të anëtarëve të stafit të caktuar zyrtarisht për të punuar së bashku me kohë të plotë ose, pothuajse me kohë të plotë, me përgjegjësi të veçantë, për të koordinuar dhe për të menaxhuar zbatimin e projektit.

“Shumë e parapagimit” nënkupton shumën e një transhi që duhet të parapaguhet nga Huamarrësi, në përputhje me nenin 4.2.A ose nenin 4.3.A, sipas rastit.

“Datë e parapagimit” nënkupton datën, e cila do të jetë një datë pagese në të cilën Huamarrësi propozon ose kërkohet nga Banka, sipas rastit, për të kryer parapagimin e shumës së parapagimit.

“Rast i parapagimit” do të thotë çdo ngjarje e përshkruar në nenin 4.3.A.

“Dëshmipërblim parapagimi” do të thotë në lidhje me çdo shumë kryesore të parapaguar ose të anuluar, shumën e komunikuar nga Banka të Huamarrësi si vlerë aktuale (e llogaritur si në datën e parapagimit ose në datën e anulimit, sipas nenit 1.6.C(2)) të tepricës, nëse ka, të:

a) interesit që do të rritet më pas për shumën e parapagimit gjatë periudhës nga data e parapagimit ose datën e anulimit sipas nenit 1.6.C(2) deri në datën e rivlerësimit/konvertimit të interesit, nëse ka ose në datën e maturimit, nëse do të ishte jo me parapagesë; mbi

b) interesin që do të rritet në atë periudhë, nëse do të llogaritej në normën e rishpërndarjes, më pak se 0.15% (pesëmbëdhjetë pikë bazë).

Vlera e tanishme aktuale llogaritet me një normë skontimi të barabartë me normën e shpërndarjes që zbatohet për çdo datë përkatëse të pagesës.

“Njoftim parapagimi” do të thotë një njoftim me shkrim nga Banka për Huamarrësin në përputhje me nenin 0.

“Kërkesë parapagimi” do të thotë një kërkesë me shkrim nga Huamarrësi për Bankën për të parapaguar të gjithë ose një pjesë të huas të paguar, në përputhje me nenin 0.

“Sjellje e ndaluar” nënkupton çdo financim të terrorizmit, pastrimit të parave ose praktikave të ndaluara.

“Praktikë e ndaluar” do të thotë çdo:

a) praktikë shtrënguese, që nënkupton dobësimin ose dëmtimin ose rrezikun për të dobësuar ose për të dëmtuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo palë ose pronën e një pale për të ndikuar në mënyrë të parregullt në veprimet e një pale;

b) praktika bashkëpunuese që nënkupton një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve, të hartuar për të arritur një qëllim të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin në mënyrë të papërshtatshme të veprimeve të një pale tjetër;

c) praktikë korruptive që nënkupton ofrimin, dhënien, marrjen ose kërkimin, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të ndonjë sendi me vlerë nga një palë për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme në veprimet e një pale tjetër;

d) praktikë mashtruese që do të thotë çdo veprim apo mosveprim, duke përfshirë një keqinterpretim, që me vetëdije ose nga pakujdesia, mashtron ose synon të mashtrojë një palë për të marrë një përfitim financiar apo



përfitim tjetër ose për të shmangur një detyrim; ose

e) praktikë penguese që do të thotë në lidhje me një hetim mbi praktikën shtrënguese, konfliktuese, korruptive ose mashtruese, në lidhje me këtë hua ose projekt: a) shkatërrimin, falsifikimin, ndryshimin ose fshehjen qëllimisht të materialeve dëshmuuese në hetim dhe/ose kërcënimin, rrezikun ose frikësimin e ndonjë pale për të parandaluar zbulimin e njohurive të tij për çështjet që lidhen me hetimin ose ndjekjen e hetimeve; b) veprime që synojnë të pengojnë materialisht ushtrimin e të drejtave kontraktuale të auditimit ose të qasjes në informacione;

“Projekt” ka kuptimin që i jepet në pikën “b”.

“Promovues” ka kuptimin që i jepet në pikën “b”.

“Normë e rivendosjes” do të thotë norma fikse vjetore e caktuar nga Banka, duke qenë një normë që Banka do të zbatojë në ditën e llogaritjes së dëmshpërblimit për një hua që ka të njëjtën monedhë, të njëjtat kushte për pagesën e interesit dhe të njëjtin profil të shlyerjes në datën e rivlerësimit/konvertimit të interesit, nëse ka, ose në datën e maturimit si transh, në lidhje me të cilën propozohet ose kërkohet parapagimi ose anulimi. Një normë e tillë nuk duhet të jetë me vlerë negative.

“Ditë pune e përshtatshme” do të thotë dita në të cilën sistemi i pagesave të transferimit të brendshëm bruto automatik trans-europian, në kohë reale, i cili përdor një platformë të përbashkët dhe që është vënë në punë më 19 nëntor 2007 (TARGET2), është i hapur për shlyerjen e pagesave në euro.

“Datë e shlyerjes” do të nënkuptojë secilën prej datave të pagesave të specifikuara për shlyerjen e principalit të një transhi në ofertën e disbursimit, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 4.1.

“Datë e kërkuar e disbursimit të shtyrë” ka kuptimin e dhënë në nenin 1.5.A(1)(b).

“Plan i veprimit të rivendosjes” nënkupton dokumentin në të cilin zbatuesi ose autoriteti tjetër përgjegjës kompetent përshkruan ndikimet e zhvendosjes së pavullnetshme, përcakton procedurat që do të ndiqen për të identifikuar, për të vlerësuar dhe për të kompensuar ndikimet dhe përcakton veprimet që duhen ndërmarrë gjatë të gjitha fazave të rivendosjes.

“Listë e sanksioneve” do të thotë:

a) çdo masë kufizuese ekonomike, financiare dhe tregtare dhe embargot e armëve të lëshuara nga Bashkimi Europian, në përputhje me kapitullin 2, të titullit V, të Traktatit për Bashkimin Europian, si dhe nenin 215 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, siç janë vënë në dispozicion në faqen e internetit të BE-së: http://ec.europa.eu/external_relations/cfsp/sanctions/conso-list_en.htm dhe http://eeas.europa.eu/cfsp/sanctions/docs/measures_en.pdf, të ndryshuar dhe të plotësuar herë pas here ose në çdo faqe pasuese; ose

b) çdo masë kufizuese ekonomike, financiare dhe tregtare dhe embargot e armëve të lëshuara nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara në përputhje me nenin 41 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, siç janë vënë në dispozicion në faqen zyrtare të OKB-së: <http://www.un.org/Docs/sc/committees/INTRO.htm>, të ndryshuar dhe të plotësuar herë pas here ose në ndonjë faqe pasuese.

“Persona të sanksionuar” nënkupton çdo individ ose subjekt të listuar në një ose më shumë lista sanksionuese.

“Datë e planifikuar e disbursimit” do të thotë data në të cilën një transh është caktuar të paguhet në përputhje me nenin 1.2B.

“Sigurim” nënkupton çdo hipotekë, peng, barrë, pagesë, transferim, hipotekë ose interes tjetër garancie, që siguron çdo detyrim të ndonjë personi ose ndonjë marrëveshje ose ujdj tjetër që ka efekt të ngjashëm

“Plani i veprimit social” nënkupton planin e masave për zbutjen sociale dhe përmirësimin, pasi një plan i tillë mund të ndryshohet, herë pas here, me pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës.

“Ligj Social” nënkupton secilin prej:

a) çdo ligj, rregull ose rregulloreje të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë, në lidhje me çështjet sociale;

b) çdo standard të ILO-së;

c) çdo traktat, konventë ose zotim të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut, të nënshkruar dhe ratifikuar ose, në ndonjë mënyrë tjetër, të zbatueshme dhe të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë.

“Çështje sociale” do të thotë të gjitha ose ndonjë nga në vijim:

a) kushtet e punës dhe të punësimit;

b) shëndeti dhe siguria në punë;



c) mbrojtja dhe fuqizimi i të drejtave dhe i interesave të popujve indigjenë, pakicave etnike dhe grupeve të prekshme;

d) trashëgimia kulturore (e prekshme dhe e paprekshme);

e) shëndeti publik, siguria dhe mbrojtja;

f) rivendosja e pavullnetshme fizike dhe/ose zhvendosja ekonomike dhe humbja e jetës së personave; dhe

g) pjesëmarrja e publikut dhe angazhimi i aksionarëve.

“Marzh” nënkupton marzhin fiks (që është vlera pozitive ose negative) ndaj EURIBOR-it, siç përcaktohet nga Banka dhe i njoftohet Huamarrësit në ofertën përkatëse të disbursimit ose në propozimin e rivlerësimit/konvertimit të interesit.

“Plan i angazhimit të palëve të interesuara” nënkupton dokumentin në të cilin zbatuesi i një projekti ose autoriteti tjetër kompetent përshkruan procesin gjithëpërfshirës dhe përsëritës që përfshin, në shkallë të ndryshme, analizën e palëve të interesuara dhe planifikimin e angazhimit, shpërndarjen në kohë dhe shpërndarjen e/konsultimet dhe pjesëmarrjen e palëve të interesuara, si dhe një mekanizëm që siguron akses në ankim dhe kompensim.

“Taksë” do të thotë çdo taksë, tatim, detyrim ose pagesë tjetër ose ndalim të një natyre të ngjashme (duke përfshirë çdo penalitet kim apo interes të pagueshëm, në lidhje me ndonjë moskryerje pagese ose ndonjë vonesë në pagimin e ndonjë rasti të njëjtë).

“Përshkrim teknik” ka kuptimin që i jepet në paragrafin “b”.

“Transh” do të thotë çdo disbursim që bëhet ose do të bëhet sipas kësaj Kontrate. Në rast se nuk është marrë pranimi i disbursimit, transhi do të nënkuptojë një transh të ofruar sipas nenit 1.2B.

Neni 1

Kredia dhe disbursimet

1.1 Shuma e kredisë

Me këtë Kontratë, Banka vendos në favor të Huamarrësit dhe Huamarrësi pranon një kredi prej 8,000,000.00 eurosh (8 milionë euro) për financimin e projektit (kredi)

1.2 Procedura e disbursimit

1.2.A Transhet

Banka do të disbursojë kredinë deri në 4 (katër) transhe. Shuma e secilit transh do të jetë në një shumë minimale prej 2,000,000.00 eurosh (dy milionë euro) ose (nëse është më e ulët), i gjithë bilanci i patërhequr i huas.

1.2. B Oferta e disbursimit

Me kërkesë të zbatuesit, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, me kopje të Huamarrësit dhe në përputhje me nenin 1.4.A, me kusht që asnjë rast i përmendur në nenin 1.5 ose nenin 1.6.B, nuk ka ndodhur dhe nuk vazhdon, Banka i dërgon Huamarrësit, brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas marrjes së një kërkesë të tillë, një ofertë disbursimi për livrimin e një transhi. Koha më e fundit për pranimin nga Banka të kërkesës së Huamarrësit është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune para datës së vlefshmërisë përfundimtare. Oferta e disbursimit do të specifikojë:

a) shumën e transhit në euro;

b) datën e planifikuar të disbursimit, e cila do të jetë një ditë pune e përshtatshme që bie të paktën 10 (dhjetë) ditë pas datës së ofertës së disbursimit dhe, në, ose para datës së vlefshmërisë përfundimtare;

c) bazën e normës së interesit të transhit, duke qenë ai: i. një transh me normë fikse interesi; ose ii. një transh me normë të ndryshueshme, në secilin rast, në përputhje me dispozitat përkatëse të nenit 3.1;

d) datat e pagesës dhe data e parë të pagesës së interesit për transhin;

e) kushtet e shlyerjes së principalit për transhin, në përputhje me dispozitat e nenit 4.1;

f) datat e shlyerjes dhe datën e parë dhe të fundit të shlyerjes për transhin ose datën e vetme të shlyerjes;

g) Datën e rivlerësimit/konvertimit të interesit, nëse kërkohet nga Huamarrësi, për transhin;

h) për një transh me normë fikse, normën fikse dhe për një transh me normë të ndryshueshme marzhin, të zbatueshëm deri në datën e rivlerësimit/konvertimit të interesit, nëse ka ose deri në datën e maturimit; dhe

i) afatin e fundit për pranimin e disbursimit.

1.2.C Pranimi i disbursimit

Huamarrësi mund të pranojë një ofertë disbursimi, duke i dorëzuar një pranim të disbursimit Bankës, jo më vonë se afati i fundit i pranimit të disbursimit. Pranimi i disbursimit nënshkruhet nga një nënshkrues i autorizuar me të



drejtë individuale të përfaqësimit ose dy ose më shumë nënshkrues të autorizuar me të drejtë të përfaqësimit të përbashkët dhe përcakton llogarinë e disbursimit, në të cilën duhet të kryhet livrimi i transhit, në përputhje me nenin 1.2D.

Nëse oferta e disbursimit është pranuar në mënyrën e duhur nga Huamarrësi, në përputhje me afatet e tij në ose para skadimit të afatit të fundit të pranimit të disbursimit, Banka do të vendosë transhin e pranuar në dispozicion të Huamarrësit, në përputhje me ofertën përkatëse të disbursimit dhe në bazë të kushteve të kësaj Kontrate.

Huamarrësi do të konsiderohet se ka refuzuar çdo ofertë të disbursimit, e cila nuk është pranuar siç duhet, në përputhje me kushtet e saj në ose para skadimit të afatit të fundit të pranimit të disbursimit.

1.2.D Llogaria e disbursimit

Disbursimi do të bëhet në llogarinë e disbursimit, me kusht që kjo llogari e disbursimit të jetë e pranueshme për Bankën.

Pavarësisht nga neni 5.2(e), Huamarrësi pranon se pagesat për një llogari disbursimi, të njoftuar nga Huamarrësi, do të përbëjnë pagesa sipas kësaj Kontrate, sikur të ishin bërë në llogarinë bankare të Huamarrësit.

Për secilin transh mund të specifikohet vetëm një llogari disbursimi.

1.3 Monedha e disbursimit

Banka do të disbursojë secilin transh në euro.

1.4 Kushtet e disbursimit

1.4.A Kushti pararendës për kërkesën e parë për ofertën e disbursimit

Banka duhet të ketë marrë nga Huamarrësi ose Zbatuesi, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën:

a) dëshmi se nënshkrimi i kësaj Kontrate nga Huamarrësi ka qenë i autorizuar në mënyrë të rregullt dhe se personi ose personat, që nënshkruajnë këtë Kontratë në emër të Huamarrësit, janë të autorizuar rregullisht për ta bërë këtë së bashku me nënshkrimin e secilit person ose personave; dhe

b) listën e nënshkruesve dhe llogaris të autorizuar;

c) termat e referencës të mekanizmit të kompensimit që ofron procedura shqyrtimi të pranueshme për Bankën dhe në dispozicion të çdo personi ose subjekti që ka ose ka pasur interes në

marrjen e një Kontrate të financuar nga BEI dhe (në rrezik të) dëmtimit nga një shkelje e dyshuar e rregullave të zbatueshme të prokurimit; dhe

d) një opinion të favorshëm ligjor të lëshuar në gjuhën angleze nga ministri i Drejtësisë i Huamarrësit, duke konfirmuar, ndër të tjera: i. autoritetin e personave që nënshkruajnë këtë Kontratë në emër të Huamarrësit; dhe ii. kjo Kontratë është nënshkruar siç duhet nga Huamarrësi dhe përbën detyrim të vlefshëm, detyrues dhe të zbatueshëm të Huamarrësit, sipas kushteve të saj; iii. zgjedhjen e vlefshme të ligjit të Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian, sipas kësaj Kontrate; iv. njohjen dhe zbatimin e vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian në çdo procedurë të ndërmarrë në Republikën e Shqipërisë, në lidhje me këtë Kontratë; dhe iv. të gjitha pagesat e principalit, interesit dhe shumave të tjera të përcaktuara në këtë rast janë të lira nga tatimi dhe pagesat e të gjitha shumave të tilla bruto, pa zbritur tatimin në burim, janë të lejuara,

para se të kërkojë ofertën e disbursimit sipas nenit 1.2B nga Huamarrësi. Çdo kërkesë për ofertë të disbursimit të bërë nga Huamarrësi, pa dokumentet e mësipërme të marra nga Banka dhe, sipas bindjes së saj, do të konsiderohet se nuk është bërë.

1.4.B Transhi i parë

Disbursimi i transhit të parë, sipas nenit 1.2, është i kushtëzuar me marrjen nga Banka, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për të, në ose para datës që bie 5 (pesë) ditë pune para datës së planifikuar të disbursimit, të dokumenteve ose dëshmime në vijim:

a) dëshmi se Zbatuesi ka marrë të gjitha autorizimet e nevojshme, të kërkuara në lidhje me këtë Kontratë dhe Projekt;

b) që NJZP-ja është në funksion me termat e referencës, stafit, burimet, të gjitha të kënaqshme për Bankën, në veçanti, në lidhje me aspektet mjedisore dhe sociale, si dhe prokurimin dhe se menaxhimi i Projektit nga NJZP-ja përfshin një person përgjegjës për të monitoruar mjedisin, klimën dhe ndikimet sociale, duke përfshirë sigurinë në rrugë.

c) çdo miratim i nevojshëm i kontrollit të shkëmbimit duhet të ishte marrë për të lejuar marrjen e disbursimeve më poshtë, shlyerjen e saj



dhe pagesën e interesit dhe të gjitha shumave të tjera përkatëse më poshtë;

d) kopje të dokumenteve mjedisore dhe sociale (ESDS), duke përfshirë:

i. kopjen e autorizimit mjedisor të lëshuar nga autoriteti kompetent, me konfirmimin se Projekti nuk ndikon në ndonjë zonë të mbrojtur natyrore;

ii. Plani i menaxhimit mjedisor, plani i veprimit për rivendosje (RAP) dhe plani i angazhimit të palëve të interesuara;

e) Një ekip të mbikëqyrjes së punës në funksion me termat e referencës, stafit dhe burimeve, të gjitha të kënaqshme për Bankën.

1.4.C Të gjitha transhet

Disbursimi i secilit transh, sipas nenit 1.2, duke përfshirë edhe të parin, u nënshtrohet kushteve të mëposhtme:

a) që Banka ka pranuar, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për të, në ose para datës që bie 5 (pesë) ditë pune para datës së planifikuar të disbursimit për transhin e propozuar, të dokumenteve ose provave të mëposhtme:

i. një certifikatë nga Huamarrësi në formën e skedulit E, të nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Huamarrësit dhe të datës jo më herët se data që bie 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së planifikuar të disbursimit (dhe në rast të shtyrjes së afatit sipas nenit 1.5, përkatësisht data e disbursimit të kërkuar të shtyrë ose data e miratuar e disbursimit të shtyrë);

ii. dëshmi që tregojnë se pas tërheqjes së transhit përkatës, shuma e huas nuk do të tejkalojë shpenzimet e pranueshme totale të bëra ose të kontraktuara nga Huamarrësi, në lidhje me Projektin, deri në datën e kërkesës përkatëse të disbursimit; dhe

iii. një kopje të çdo autorizimi tjetër ose dokumenti, mendimi ose garancie tjetër që Banka ka njoftuar Huamarrësin është e nevojshme ose e dëshirueshme, në lidhje me hyrjen dhe kryerjen e, dhe transaksionet e parashikuara nga kjo Kontratë ose ligjshmërinë, vlefshmërinë, efektin detyrues ose zbatueshmërinë e saj; dhe

iv. që Banka është e kënaqur që në datën e kërkesës përkatëse të disbursimit dhe datën e disbursimit për Transhin e propozuar:

1. Të gjitha faktet dhe pikat në përmbajtje të deklarimeve janë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet;

2. Garancia e BE-së është e ligjshme, e vlefshme, e detyrueshme dhe e zbatueshme dhe se asnjë ngjarje apo rrethanë nuk ka ndodhur, e cila sipas mendimit të Bankës mund të ndikojë negativisht në natyrën ligjore, të vlefshme, detyruese dhe të zbatueshme të garancisë së BE-së, sipas kësaj Kontrate ose të drejtën e Bankës për të bërë një kërkesë sipas garancisë së BE-së;

3. Republika e Shqipërisë është një vend i pranueshëm dhe:

b) që në datën e planifikuar të disbursimit (dhe në rast të shtyrjes sipas nenit 1.5, në datën e kërkuar të shtyrjes së disbursimit ose në datën e disbursimit të shtyrë të rënë dakord) për transhin e propozuar:

i. përfaqësimet dhe garancitë që përsëriten sipas nenit 6.11 janë të sakta në të gjitha aspektet; dhe

ii. asnjë ngjarje apo rrethanë që përbën ose do të përbente kalimin e kohës ose dhënien e njoftimit sipas kësaj Kontrate, nuk përmban:

1. Në rast mospërmbushjeje të detyrimeve; ose

2. Një rast parapagimi,

ka ndodhur dhe vazhdon i pakorrigjuar ose i paanashkalluar ose do të rezultojë nga disbursimi i transhit të propozuar.

1.4.D Transhi i fundit

Disbursimi i transhit përfundimtar është objekt i kushtit që Banka ka marrë në ose para datës që bie 5 (pesë) ditë pune para datës së planifikuar të disbursimit për transhin e propozuar, dëshmi të kënaqshme për statusin e zbatimit të Projektit të Përmirësimit të Kanalizimeve të Tiranës së Madhe, duke përfshirë Impiantin e Trajtimit të Ujit. Ky status zbatimi duhet të garantojë që mbledhësit e ujërave të zeza të përfshirë në Projekt do të integrohen në Projektin e trajtimit të ujërave të ndotura në zbatim, para përfundimit, në vitin 2022, të frontit të lumit Lana – Rizhivillimi Urban.

1.5 Shtyrja e disbursimit

1.5.A Arsyet për shtyrje

1.5.A(1) KËRKESA E HUAMARRËSIT

Huamarrësi mund të dërgojë një kërkesë me shkrim në Bankë, duke kërkuar shtyrjen e disbursimit të një transhi të pranuar. Kërkesa me shkrim duhet të merret nga Banka të paktën 5 (pesë) ditë pune para datës së planifikuar të disbursimit të transhit të pranuar dhe të specifikojë:

a) nëse Huamarrësi do të dëshironte të shtynte disbursimin, në tërësi ose pjesërisht, dhe në qoftë se pjesërisht, shuma që do të shtyhet; dhe



b) datën deri në të cilën Huamarrësi do të dëshironte të shtynte pagesën e shumës së lartpërmendur (data e kërkuar e shtyrjes së disbursimit), e cila duhet të jetë një datë që bie, jo më vonë se:

i. 6 (gjashtë) muaj nga data e planifikuar e disbursimit;

ii. 30 (tridhjetë) ditë para datës së parë të shlyerjes; dhe

iii. data e vlefshmërisë përfundimtare.

Pas marrjes së një kërkesë të tillë me shkrim, Banka do të shtyjë disbursimin e shumës përkatëse deri në datën e kërkuar të shtyrjes së disbursimit.

1.5.A(2) DËSHTIMI PËR TË PËRM-BUSHUR KUSHTET E DISBURSIMIT

a) disbursimi i një transhi të pranuar do të shtyhet në qoftë se ndonjë kusht për disbursimin e një transhi të tillë të pranuar të përmendur në nenin 1.4 nuk është plotësuar:

i. në datën e caktuar të disbursimit (ose, kur data e planifikuar e disbursimit është shtyrë më parë, në datën e pritshme për disbursim);

b) Banka dhe Huamarrësi do të bien dakord për datën deri në të cilën disbursimi i këtij transhi të pranuar do të shtyhet (data e përcaktuar të shtyrjes së disbursimit), e cila duhet të jetë një datë që nuk bie:

i. më shpejt se 7 (shtatë) ditë pune pas përmbushjes së të gjitha kushteve të disbursimit; dhe

ii. më vonë se dita e vlefshmërisë përfundimtare.

c) Pa cenuar të drejtën e Bankës për të pezulluar dhe/ose për të anuluar pjesën e padisbursuar të kredisë në tërësi ose pjesërisht, sipas nenin 1.6B, Banka do të shtyjë disbursimin e një transhi të tillë të pranuar deri në datën e përcaktuar të shtyrjes së disbursimit.

1.5.A(3) DËMSHPËRBLIMI I SHTYRJES

Nëse livrimi i një transhi të pranuar shtyhet sipas paragrafëve 1.5.A(1) ose 1.5.A(2) më lart, Huamarrësi do të paguajë dëmshpërblimin e shtyrjes.

1.5.B Anulimi i një disbursimi të shtyrë me 6 (gjashtë) muaj

Nëse një disbursim është shtyrë më shumë se 6 (gjashtë) muaj, në përputhje me nenin 1.5.A, Banka mund të njoftojë Huamarrësin me shkrim, se disbursimi i tillë do të anulohet dhe anulimi do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit me shkrim. Shuma e disbursimit që anulohet nga Banka, sipas këtij

neni 1.5.B, mbetet në dispozicion për disbursim sipas nenit 1.2.

1.6 Anulimi dhe pezullimi

1.6.A E drejta e Huamarrësit për anulim

Huamarrësi mund të dërgojë një njoftim me shkrim në Bankë, duke kërkuar anulimin e pjesës së padisbursuar të kredisë. Njoftimi me shkrim:

a) duhet të specifikojë nëse Huamarrësi do të dëshironte të anulonte pjesën e padisbursuar të huas, në tërësi ose pjesërisht dhe, nëse pjesërisht, shumën e huas që Huamarrësi do të dëshironte të anulonte; dhe

b) nuk duhet të lidhet me një transh të pranuar, i cili ka një datë të planifikuar të disbursimit brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e njoftimit me shkrim.

Pas marrjes të një njoftimi të tillë me shkrim, Banka do të anulojë pjesën e kërkuar të huas së padisbursuar me efekt të menjëhershëm.

1.6.B E drejta e Bankës për të pezulluar dhe anuluar

Në çdo kohë pas paraqitjes së ngjarjeve të mëposhtme, Banka mund të njoftojë Huamarrësin me shkrim se pjesa e padisbursuar e kredisë do të pezullohet dhe/ose do të anulohet tërësisht ose pjesërisht:

a) një rast parapagimi;

b) një rast mospërmbushjeje detyrimi;

c) një ngjarje ose rrethanë e cila me kalimin e kohës ose dhënien e njoftimit, sipas kësaj Kontrate, do të përbënte një rast të parapagimit ose një rast mospërmbushjeje të detyrimit;

d) nëse Republika e Shqipërisë nuk është më një vend i përshtatshëm për operacionet nën mandatin; ose

e) një ndryshim material negativ; ose

f) një rast të ndërprerjes së tregut, me kusht që Banka të mos ketë marrë një pranim disbursimi.

Në datën e një njoftimi të tillë me shkrim, pjesa përkatëse e padisbursuar e kredisë, pezullohet dhe/ose anulohet me efekt të menjëhershëm. Çdo pezullim do të vazhdojë derisa Banka të mbyllë pezullimin ose të anulojë shumën e pezulluar.

1.6.C Dëmshpërblimi për pezullimin dhe anulimin e një transhi

1.6.C(1) PEZULLIMI

Nëse Banka pezullon një transh të pranuar pas shfaqjes së një ngjarjeje të parapagimit të zhdëmtimit ose një ngjarjeje të mospërmbushjes së detyrimit ose me ndodhjen e një ndryshimi material negativ, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës



dëmshpërblimin e llogaritur në shumën e disbursimit të pezulluar.

1.6.C(2) ANULIMI

a) nëse një transh i pranuar, që është një transh me normë fikse anulohet:

i. nga Huamarrësi sipas nenit 1.6A; ose

ii. nga Banka në një ngjarjeje të parapagimit të zhdëmtimit ose me ndodhjen e një ndryshimi material negativ ose në përputhje me nenin 1.5B,

Huamarrësi duhet t'i paguajë Bankës dëmshpërblimin e parapagimit. Dëmshpërblimi i parapagimit do të llogaritet sikur shuma e anuluar të ishte disbursuar dhe shlyer në datën e planifikuar të disbursimit ose, në masën që disbursimi i transhit, aktualisht është shtyrë ose pezulluar, në datën e njoftimit të anulimit;

b) nëse Banka anulon një transh të pranuar, me rastin e mospërmbushjes së detyrimit, Huamarrësi duhet të dëmshpërblejë Bankën, në përputhje me nenin 10.3;

c) përveç rasteve “a” ose “b” të mësipërme, asnjë dëmshpërblim nuk do të paguhet për anulimin e një transhi.

1.7 Anulimi pas skadimit të kredisë

Në ditën pas datës së vlefshmërisë përfundimtare dhe, nëse nuk është rënë dakord ndryshe me shkrim nga Banka, çdo pjesë e kredisë për të cilën nuk është marrë pranimi i disbursimit në përputhje me nenin 1.2C, do të anulohet automatikisht, pa ndonjë njoftim nga Banka për Huamarrësin dhe pa përgjegjësi që lind nga ana e secilës palë.

1.8 Shumat e detyrueshme sipas neneve 1.5 dhe 1.6

Shumat e detyrueshme, sipas neneve 1.5 dhe 1.6, do të paguhet në Euro. Shumat e detyrueshme, sipas neneve 1.5 dhe 1.6, do të paguhet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës së Bankës nga Huamarrësi ose brenda një periudhe më të gjatë të përcaktuar në kërkesën e Bankës.

Neni 2

Huaja

2.1 Shuma e huas

Huaja duhet të përbëjë shumën totale të transheve të disbursuara nga Banka sipas të kredisë, siç konfirmohet nga Banka në pajtim me nenin 2.3.

2.2 Valuta e shlyerjes, interesit dhe pagesave të tjera

Interesat, shlyerjet dhe pagesat e tjera të pagueshme, në lidhje me secilin transh, do të kryhen nga Huamarrësi në monedhën në të cilën paguhet transhi.

Pagesa të tjera, nëse ka, do të kryhen në monedhën e specifikuar nga Banka, duke pasur parasysh monedhën e shpenzimeve që do të rimbursohen me anë të asaj pagese.

2.3 Konfirmimi nga Banka

Banka i dërgon Huamarrësit tabelën e amortizimit të referuar në nenin 4.1, nëse është e përshtatshme, duke treguar datën e disbursimit, monedhën, shumën e disbursuar, afatet e shlyerjes dhe normën e interesit të dhe për atë transh.

Neni 3

Interesi

3.1. Norma e interesit

3.1.A Transhet me normë fikse

Huamarrësi duhet të paguajë interes, në masën e papaguar të çdo transhi, me normë fikse në normën fikse tremujore, gjashtëmujore ose vjetore në vonesë në datat përkatëse të pagesave, siç është specifikuar në ofertën e disbursimit, duke filluar nga data e parë e pagesës së tillë, pas datës së disbursimit të transhit. Nëse periudha nga data e disbursimit deri në datën e parë të pagesës është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë ose më e shkurtër, atëherë pagesa e interesit të llogaritur gjatë kësaj periudhe do të shtyhet në datën e pagesës vijuese.

Interesi llogaritet në bazë të nenit 5.1(a).

3.1.B Transhet me normë të ndryshueshme

Huamarrësi do të paguajë interes në masën e papaguar të çdo transhi me normë të ndryshueshme me normën e ndryshueshme tremujore ose gjashtëmujore, në vonesë në datat përkatëse të pagesave, siç është specifikuar në ofertën e disbursimit, duke filluar nga data e parë e pagesës së tillë pas datës së disbursimit të transhit. Nëse periudha nga data e disbursimit deri në datën e parë të pagesës është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë ose më e shkurtër, atëherë pagesa e interesit të llogaritur gjatë kësaj periudhe do të shtyhet në datën e pagesës vijuese.

Banka do të njoftojë Huamarrësin për normën e ndryshueshme brenda 10 (dhjetë) ditëve pas fillimit të çdo periudhe referimi të normës së ndryshueshme.



Nëse në përputhje me nenet 1.5 dhe 1.6 disbursimi i çdo transhi me normë të ndryshueshme kryhet pas datës së planifikuar të disbursimit EURIBOR, që zbatohet në periudhën e parë të referencës së normës së ndryshueshme, do të zbatohet sikur disbursimi të ishte kryer në datën e planifikuar të disbursimit.

Interesi do të llogaritet në lidhje me çdo periudhë referimi të normës së ndryshueshme, në bazë të nenit 5.1(b).

3.1.C Rivlerësimi ose konvertimi i transheve

Kur Huamarrësi ushtron një opSION për të rishikuar ose konvertuar bazën e normës së interesit të një transhi, nga data e rivlerësimit/konvertimit të interesit (në përputhje me procedurën e përcaktuar në skedulën D) paguan interesin me një normë të caktuar, në përputhje me dispozitat e skedulit D.

3.2 Interesi për shumat që u ka kaluar afati

Pa cenuar nenin 10 dhe, me përjashtim të nenit 3.1, nëse Huamarrësi nuk paguan ndonjë shumë të pagueshme sipas kësaj Kontrate në datën e tij të caktuar, interesi do të rritet për çdo shumë të vonuar që paguhet, sipas kushteve të kësaj Kontrate, nga data e afatit në datën e pagesës aktuale me një normë vjetore të barabartë, me:

a) për shumat e vonuara të lidhura me kështet me normë të ndryshueshme, normën e ndryshueshme të zbatueshme plus 2% (200 pikë bazë);

b) për shumat e vonuara të lindura me transhet me normë fikse, më i larti prej:

c) normës së zbatueshme fikse plus 2% (200 pikë bazë);

d) EURIBOR plus 2% (200 pikë bazë); dhe

e) për shumat që u ka kaluar afati, të ndryshme nga pikat “a” ose “b” më lart, EURIBOR plus 2% (200 pikë bazë),

dhe do të paguhet në përputhje me kërkesën e Bankës. Për qëllim të përcaktimit të EURIBOR-it, në lidhje me këtë nen 3.2, periudhat përkatëse brenda kuptimit të skedulit B do të jenë periudha të njëpasnjëshme prej një muaji, duke filluar nga data kur lind detyrimi. Çdo interes i papaguar, por i detyrueshëm, mund të kapitalizohet në përputhje me nenin 1154 të Kodit Civil të Luksemburgut. Për shmangien e dyshimit, kapitalizimi i interesit do të bëhet vetëm për interesin e detyrueshëm për t'u paguar, por të papaguar për një periudhë më të gjatë se një vit. Huamarrësi, me këtë pranon paraprakisht që të ketë interesin e papaguar të

kërkueshëm për një periudhë më të gjatë se një vit të konsoliduar/të bashkuar dhe, që sa i përket kapitalizimit, ky interes i papaguar, nga ana tjetër, do të prodhojë interes me normën e interesit të përcaktuar në këtë nen 3.2.

Nëse shumat e prapambetur është në një monedhë të ndryshme nga monedha e Huas, do të zbatohet norma e mëposhtme në vit, d.m.th. norma përkatëse ndërbankare, që, përgjithësisht, ruhet nga Banka për transaksione në atë monedhë plus 2% (200 pikë bazë), e llogaritur në përputhje me praktikën e tregut për një normë të tillë.

3.3 Rasti i ndërprerjes së tregut

a) Nëse, ndonjëherë:

i. nga marrja e Bankës e një pranimi të disbursimit në lidhje me një transh; dhe

ii. deri në datën që bie 30 (tridhjetë) ditë kalendarike përpara datës së planifikuar të disbursimit, ndodh një rast i ndërprerjes së tregut, Banka mund të njoftojë Huamarrësin që kjo klauzolë ka hyrë në fuqi. Në këtë rast do të zbatohen rregullat e mëposhtme:

b) norma e interesit e zbatueshme për një transh të tillë të pranuar deri në datën e maturimit ose në datën e rivlerësimit/konvertimit të interesit nëse ka, do të jetë:

i. norma (e shprehur si përqindje në vit), e cila përcaktohet nga Banka si kosto gjithëpërfshirëse për Bankën, për financimin e transhit përkatës, bazuar në normën e referencës së Bankës të gjeneruar brenda vendit ose në një metodë alternative të përcaktimit të normës të përcaktuar në mënyrë të arsyeshme nga Banka.

Huamarrësi ka të drejtë të refuzojë me shkrim pagesën e tillë brenda afatit të caktuar në njoftim dhe do të paguajë shpenzimet e kryera si rezultat, nëse ka, rast në të cilin Banka nuk do të kryejë livrimin dhe pjesa përkatëse e huas do të mbetet e disponueshme për disbursim, sipas nenit 1.2B. Nëse Huamarrësi nuk refuzon disbursimin në kohë, palët bien dakord që disbursimi dhe kushtet e tyre të jenë plotësisht të detyrueshme për të dyja palët.

c) Marzhi ose norma fikse e pranuar nga Huamarrësi dhe e njoftuar më parë nga Banka në ofertën e disbursimit nuk do të jetë më e zbatueshme.



Neni 4 Shlyerja

4.1 Shlyerje normale

4.1.A Shlyerja me këste

a) Huamarrësi do të shlyejë çdo transh me këste, në datat e shlyerjes të specifikuar në ofertën përkatëse të disbursimit, në përputhje me kushtet e tabelës së amortizimit të dorëzuar në pajtim me nenin 2.3;

b) çdo tabelë amortizimi do të hartohet në bazë të:

i. në rastin e një transhi me normë fikse, pa një datë të rivlerësimit/ndryshimit të interesit, shlyerja do të bëhet tremujore, gjashtëmujore ose vjetore, me këste të barabarta të principalit ose kësteve të vazhdueshme të principalit dhe të interesit;

ii. në rastin e një transhi me normë fikse me një datë të rishikimit/konvertimit të interesit ose një transh me normë të ndryshueshme, shlyerja do të bëhet me këste të barabarta tremujore, gjashtëmujore ose vjetore të principalit;

iii. data e parë e shlyerjes të secilit transh do të jetë një datë pagese që bie jo më herët se 30 (tridhjetë) ditë nga data e planifikuar e disbursimit dhe jo më vonë se data e parë e shlyerjes, menjëherë pas përvjetorit të pestë (pestë) të datës së planifikuar të disbursimit të transhit; dhe

iv. data e fundit e shlyerjes të secilit transh do të jetë një datë pagese që nuk bie më parë se 4 (katër) vjet dhe jo më vonë se 20 (njëzet) vjet nga data e planifikuar e disbursimit.

4.1.B Kësti i vetëm

Në mënyrë alternative, Huamarrësi do të paguajë transhin në një këst të vetëm në datën e shlyerjes të specifikuar në ofertën e disbursimit, duke qenë një datë që bie jo më pak se 3 (tre) vjet ose më shumë se 12 (dymbëdhjetë) vjet nga data e planifikuar e disbursimit.

4.2. Parapagimi vullnetar

4.2.A Opsioni i parapagimit

Në bazë të neneve 4.2.B, 4.2.C dhe 4.4, Huamarrësi mund të parapaguajë të gjithë ose një pjesë të çdo transhi, së bashku me interesin e akumuluar dhe dëmshpërblimet nëse ka, pas dhënies së kërkesës së parapagimit, me njoftim paraprak prej të paktën 30 (tridhjetë) ditë kalendarike, duke specifikuar:

a) shumën e parapagimit;

b) datën e parapagimit;

c) nëse është e zbatueshme, zgjedhjen e metodës së aplikimit të shumës së parapagimit në përputhje me nenin 5.5.C(a); dhe

d) numrin e Kontratës.

Kërkesa për parapagim do të jetë e parevokueshme.

4.2.B Dëmshpërblimi i parapagimit

4.2.B(1) Transhi me normë fikse

Në bazë të nenit 4.2.B(3) më poshtë, nëse Huamarrësi parapaguan një transh me normë fikse, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës në datën e parapagimit, dëmshpërblimin e parapagimit në lidhje me një Transh me normë fikse, e cila është duke u parapaguar.

4.2.B(2) Transhi me normë të ndryshueshme

Në përputhje me nenin 4.2.B(3) më poshtë, Huamarrësi mund të parapaguajë një transh me normë të ndryshueshme, pa asnjë dëmshpërblim në çdo datë përkatëse të pagesës.

4.2.B(3) Rivlerësimi/konvertimi

Parapagimi i një transhi në datën e rivlerësimit/konvertimit të interesit mund të bëhet pa dëmshpërblim, përveç nëse Huamarrësi ka pranuar me shkrim një normë fikse sipas një propozimi për rivlerësimin/konvertimin e interesit, të pranuar në përputhje me nenin 1.2.C ose në përputhje me skedulën D

4.2.C Mekanizmi i parapagimit

Me paraqitjen e kërkesës për parapagim nga Huamarrësi te Banka, Banka do të lëshojë një njoftim parapagimi për Huamarrësin, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së parapagimit. Njoftimi për parapagim do të specifikojë shumën e parapagimit, interesin e llogaritur për shkak të saj, dëmshpërblimin e parapagimit të pagueshëm sipas nenit 4.2.B ose, sipas rastit, që nuk ka ndonjë dëmshpërblim, mënyrën e aplikimit të shumës së parapagimit dhe nëse një parapagesë dëmshpërblimi është e zbatueshme, afati i fundit në të cilin Huamarrësi mund të pranojë njoftimin për parapagim.

Nëse Huamarrësi pranon njoftimin për parapagim jo më vonë se afati (nëse ka) i përcaktuar në njoftimin për parapagim, Huamarrësi do të kryejë parapagesën. Në çdo rast tjetër, Huamarrësi mund të mos e bëjë parapagimin.

Huamarrësi duhet të shoqërojë pagesën e shumës së parapagimit me pagesën e interesit të akumuluar dhe dëmshpërblimin e parapagimit,



nëse ka, për shkak të shumës së parapagimit, siç përcaktohet në njoftimin për parapagim.

4.2.D Tarifa administrative

Nëse Huamarrësi paguan një transh në një datë të ndryshme nga një datë përkatëse e pagesës ose nëse Banka përjashton, vetëm me vendim të Bankës, një kërkesë për parapagim me njoftim paraprak prej më pak se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike, Huamarrësi duhet t'i paguajë Bankës një tarifë administrative në shumën që Banka do t'i njoftojë Huamarrësit.

4.3 Parapagimi i detyrueshëm

4.3.A Raste të parapagimit

4.3.A(1) Reduktimi i kostos së Projektit

Nëse kostoja totale e Projektit bie nën shifrën e paraqitur në paragrafin “b”, në mënyrë që shuma e kredisë të kalojë 50% (pesëdhjetë për qind) të kostos së përgjithshme të Projektit, Banka, duke njoftuar Huamarrësin, mund të anulojë menjëherë pjesën e padisbursuar të kredisë dhe/ose parapagimin e kërkesës së Huas së papaguar deri në shumën me të cilën Kredia tejkalon 50% (pesëdhjetë për qind) të kostos totale të Projektit, së bashku me interesin e llogaritur dhe të gjitha shumat e tjera të akumuluar dhe të papaguara në bazë të kësaj Kontrate, në lidhje me raportin e Huas së papaguar që duhet të parapaguhet. Huamarrësi do të bëjë pagesën e shumës së kërkuar në datën e specifikuar nga Banka, datë e cila duhet të jetë jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë nga data e kërkesës.

4.3.A(2) *Pari passu* për financimin jo-EIB

Nëse Huamarrësi parapaguan vullnetarisht (për shmangien e dyshimit, parapagimi do të përfshijë një riblerje ose anulim, kur është e mundur) për një pjesë ose të gjithë financimin jo-EIB, Banka mund, me njoftimin e Huamarrësit, të anulojë pjesën e kredisë së padisbursuar dhe të kërkojë parapagimin e huas së papaguar, së bashku me interesin e llogaritur dhe të gjitha shumat e tjera të llogaritura dhe të papaguara sipas kësaj Kontrate në raport me përqindjen e huas së papaguar që duhet të bëhet me parapagesë. Përqindja e huas së papaguar që Banka mund të kërkojë për t'u parapaguar do të jetë e njëjtë me atë që masa e papaguar e financimit jo-EIB do të ketë në shumën totale të papaguar të të gjithë financimit jo-EIB.

Huamarrësi do të kryejë pagesën e shumës së kërkuar në datën e specifikuar nga Banka, një datë e tillë që do të jetë jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë nga data e kërkesës.

Për qëllime të këtij neni, “Financimi jo-EIB” përfshin çdo hua (përveç Huas dhe çdo hua tjetër direkte nga Banka për Huamarrësin, bonot e huas ose formë tjetër të borxhit financiar ose ndonjë detyrim për pagesën ose shlyerjen e parave fillimisht në dispozicion të Huamarrësit për një afat më të gjatë se tre (3) vjet.

4.3.A(3) Ndryshimi i ligjit

Huamarrësi do të informojë menjëherë Bankën nëse ka ndodhur ose mund të ndodhë një rast i ndryshimeve të ligjit. Në këtë rast, ose nëse Banka ka arsye të besojë se një rast i ndryshimit të ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë, Banka mund të kërkojë që Huamarrësi të konsultohet me të. Ky konsultim duhet të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e kërkesës së Bankës. Nëse pas kalimit të afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga data e kërkesës për konsultim, Banka ka mendimin e arsyeshëm se efektet e rastit të ndryshimit të ligjit nuk mund të zbuten sipas kërkesave të saj, Banka, nëpërmjet njoftimit të Huamarrësit, mund të anulojë pjesën e padisbursuar të kredisë dhe/ose të kërkojë parapagimin e Huas së papaguar, së bashku me interesin e llogaritur dhe të gjitha shumat e tjera të akumuluar dhe të papaguara sipas kësaj Kontrate.

Huamarrësi do të kryejë pagesën e shumës së kërkuar në datën e specifikuar nga Banka, një datë e tillë që do të bjerë jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë nga data e kërkesës.

Për qëllimet e këtij neni, “Rast i ndryshimit të ligjit” nënkupton miratimin, shpalljen, ekzekutimin ose ratifikimin ose ndryshimin e ndonjë ligji, rregulli ose rregulloreje (ose në zbatimin ose interpretimin zyrtar të çdo ligji, rregulli ose rregulloreje) që ndodh pas datës së kësaj Kontrate dhe, që sipas mendimit të arsyeshëm të Bankës, do të dëmtonte materialisht aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate.

4.3.A(4) Paligjshmëria

Nëse:

a) bëhet e paligjshme në çdo juridiksion të zbatueshëm për Bankën, për të përmbushur ndonjë nga detyrimet e saj, siç parashikohet në këtë Kontratë ose për të financuar ose mbajtur Huan;

b) Marrëveshja Kuadër është ose, në opinionin e arsyeshëm të Bankës, mund të jetë:



i. refuzohet ose zgjidhet/ndërpritet nga Republika e Shqipërisë ose nuk është e detyrueshme për Republikën e Shqipërisë në ndonjë aspekt;

ii. joefektive, në përputhje me kushtet e saj ose pretendohet nga Republika e Shqipërisë për të qenë joefektive, në përputhje me kushtet e saj; ose

iii. shkelur si rezultat i Republikës së Shqipërisë, duke mos përmbushur ndonjë detyrim të ndërmarrë nga Marrëveshja Kuadër, në lidhje me çdo hua të realizuar për çdo huamarrës në territorin e Republikës së Shqipërisë nga burimet e Bankës ose Bashkimit Evropian; ose

c) në lidhje me garancinë e BE-së:

i. nuk është më e vlefshme ose në fuqi të plotë;

ii. kushtet për mbulimin e tyre nuk janë plotësuar;

iii. nuk zbatohet për asnjë transh të disbursuar ose që do të disbursohet sipas kësaj Kontrate; ose

iv. nuk është efektive në përputhje me kushtet e saj ose pretendohet të jetë joefektive në përputhje me kushtet e saj.

Banka, me anë të njoftimit të Huamarrësit, menjëherë: 1. pezullon ose anulon pjesën e padisbursuar të kredisë; dhe/ose 2. kërkon parapagimin e Huas, së bashku me interesin e grumbulluar dhe të gjitha shumat e tjera të llogaritura ose të paguara sipas kësaj Kontrate, në datën e caktuar nga Banka në njoftimin e saj për Huamarrësin.

4.3.B Mekanizmat e parapagimit

Çdo shumë e kërkuar nga Banka, në përputhje me nenin 4.3A, së bashku me çdo interes ose shuma të tjera të llogaritura ose të paguara sipas kësaj Kontrate, duke përfshirë, pa kufizim, çdo kompensim të pagueshëm sipas nenit 4.3C, duhet të paguhet në datën e caktuar nga Banka në njoftimin e saj të kërkesës.

4.3.C Dëmshpërblimi i parapagimit

Në rastin e një ngjarjeje të parapagimit të zhdëmtimit, zhdëmtimi, nëse ka, do të përcaktohet në përputhje me nenin 4.2B.

4.4 Të përgjithshme

4.4.A Pa cenuar nenin 10

Ky nen 4 nuk duhet të cenojë nenin 10.

4.4.B Jo Rihuamarrje

Shuma e paguar ose e parapaguar nuk mund të rimerret hua.

Neni 5

Pagesat

5.1 Detyrimi i numërimit të ditëve

Çdo shumë që duhet paguar me anë të interesit ose zhdëmtimit nga Huamarrësi, sipas kësaj Kontrate dhe llogaritet në lidhje me një pjesë të një viti do të përcaktohet në detyrimet përkatëse vijuese:

a) në lidhje me interesin dhe dëmshpërblimet për shkak të një transhi me normë fikse, një vit prej 360 (treqind e gjashtëdhjetë) ditësh dhe një muaji prej 30 (tridhjetë) ditësh; dhe

b) në lidhje me interesat dhe dëmshpërblimet që duhet të paguhet, sipas një transhi me normë të ndryshueshme, një vit prej 360 (treqind e gjashtëdhjetë) ditësh dhe numri i ditëve të kaluara.

5.2 Koha dhe vendi i pagesës

a) përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë Kontratë ose me kërkesën e Bankës, të gjitha shumat përveç shumave të interesit, dëmshpërblimit dhe principalit paguhet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës së Huamarrësit nga Banka;

b) çdo shumë e pagueshme nga Huamarrësi sipas kësaj Kontrate do të paguhet në llogarinë përkatëse të njoftuar nga Banka për Huamarrësin. Banka do të njoftojë llogarinë jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së caktuar për pagesën e parë nga Huamarrësi dhe do të njoftojë çdo ndryshim të llogarisë jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së pagesës së parë në të cilën kryhet ndryshimi. Kjo periudhë njoftimi nuk zbatohet në rastin e pagesës sipas nenit 10;

c) Huamarrësi do të caktojë numrin e kontratës në detajet e pagesës për secilën pagesë të kryer sipas kësaj;

d) një shumë e detyrueshme për t'u paguar nga Huamarrësi do të konsiderohet e paguar kur Banka e merr atë;

e) çdo disbursim nga dhe pagesa për Bankën sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhet duke përdorur llogarinë (llogaritë) e pranueshme për Bankën. Çdo llogari në emër të Huamarrësit e mbajtur me një institucion financiar të autorizuar në juridiksionin ku Huamarrësi është përfshirë ose kur Projekti është ndërmarrë, konsiderohet i pranueshëm për Bankën.



5.3 Mos kompensimi nga Huamarrësi

Të gjitha pagesat që duhet të bëhen nga Huamarrësi sipas kësaj Kontrate do të llogariten dhe do të bëhen pa (dhe të çliruara nga ndonjë zbritje për) kompensimin ose kundërkërkesën/kundërpadinë.

5.4 Ndërprerja e sistemeve të pagesave

Nëse Banka përcakton (në diskrecionin e saj) se ka ndodhur një rast i ndërprerjes ose Banka njoftohet nga Huamarrësi se ka ndodhur një rast i ndërprerjes:

a) Banka mund dhe nëse kjo kërkohet nga Huamarrësi, të konsultohet me Huamarrësin për të rënë dakord me Huamarrësin për ndryshime të tilla për operimin ose administrimin e kësaj Kontrate, siç Banka mund të konsiderojë të nevojshme sipas rrethanave.

b) Banka nuk është e detyruar të konsultohet me Huamarrësin në lidhje me çdo ndryshim të përmendur në paragrafin “a”, nëse, sipas mendimit të saj, nuk është praktike ta bëjë këtë sipas rrethanave dhe, në asnjë rast, nuk është e detyruar të pajtohet për këto ndryshime; dhe

c) Banka nuk do të jetë përgjegjëse për dëmet, kostot ose humbjet që lindin si rezultat i një rasti të ndërprerjes ose për marrjen ose mosmarrjen e ndonjë veprimi, sipas ose në lidhje me nenin 5.4

5.5 Aplikimi i shumave të pranuara

5.5.A Të përgjithshme

Shumat e marra nga Huamarrësi do të përmbushin detyrimet e pagesës vetëm nëse pranohen në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.

5.5.B Pagesat e pjesshme

Nëse Banka merr një pagesë që nuk është e mjaftueshme për të përmbushur të gjitha shumat që i takojnë dhe paguhen nga Huamarrësi, sipas kësaj Kontrate, Banka do të aplikojë atë pagesë:

a) së pari, në apo drejt pagesave *pro rata* për secilën prej tarifave, shpenzimeve, dëmshpërblimeve dhe kostove të paguara sipas kësaj Kontrate;

b) së dyti, në ose drejt pagesës së çdo interesi të llogaritur të detyrueshëm për t’u paguar por të papaguar sipas kësaj Kontrate;

c) së treti, në ose drejt pagesës së çdo detyrimi kryesor të detyrueshëm për t’u paguar por të papaguar sipas kësaj Kontrate; dhe

d) së katërti, në ose drejt pagesës së ndonjë shume tjetër të detyrueshme për t’u paguar por të papaguar sipas kësaj Kontrate.

5.5.C Shpërndarja e shumave që lidhen me transhet

a) në rastin e:

i. një parapagim i pjesshëm vullnetar i një transhi që është objekt i shlyerjes në disa këste, shuma e parapagimit do të zbatohet proporcionalisht për secilin këst të papaguar ose me kërkesë të Huamarrësit, në rendin e anasjellë të maturimit; ose

ii. një parapagim i pjesshëm i detyrueshëm i një transhi, që është objekt i një shlyerjeje në disa këste, shuma e parapagimit do të zbatohet në reduktimin e kësteve të paguara në rendin e anasjellë të maturimit;

b) shumat e pranuar nga Banka, sipas një kërkesë, sipas nenit 10.1 dhe të aplikuar për një transh, do të zvogëlojnë këstet e mbetura në rendin e anasjellë të maturimit. Banka mund të aplikojë shumat e marra midis transheve në diskrecionin e saj;

c) në rast të pranimit të shumave që nuk mund të identifikohen si të aplikueshme për një transh të veçantë dhe kur nuk ka marrëveshje ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit për aplikimin e tyre, Banka mund t’i zbatojë ato midis transheve, në diskrecionin e saj.

Neni 6

Angazhimet dhe përfaqësitë e Huamarrësit

Angazhimet në këtë nen 6 mbeten në fuqi nga data e kësaj Kontrate, për sa kohë që çdo shumë është e papaguar, sipas kësaj Kontrate ose kredisë, është në fuqi.

A. ANGAZHIMET E PROJEKTTIT

6.1 Përdorimi i huas dhe disponueshmëria e fondeve të tjera

Zbatuesi, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, do të përdorë të gjitha shumat e huazuara sipas kësaj Kontrate për ekzekutimin e Projektit.

Huamarrësi duhet të sigurojë që ai të ketë në dispozicion fondet e tjera të renditura në paragrafin “b” dhe që fondet e tilla të shpenzohen, në masën që kërkohet, për financimin e Projektit.



6.2 Përfundimi i Projektit

Huamarrësi do të sigurojë që Zbatuesi do ta zbatojë Projektin, në përputhje me përshkrimin teknik që mund të modifikohet herë pas here me miratimin e Bankës dhe ta përfundojë atë deri në datën e caktuar në të.

6.3 Rritja e kostos së Projektit

Nëse kostoja totale e Projektit tejkalon shifrën e parashikuar në paragrafin “b”, Huamarrësi do të sigurojë financimin për të financuar koston e tepërt pa iu drejtuar Bankës, në mënyrë që të mundësojë që Projekti të përfundojë në përputhje me përshkrimin teknik. Planet për financimin e kostos së tepërt duhet t'i komunikohen Bankës pa vonesë.

6.4 Procedura e prokurimit

Huamarrësi duhet të sigurojë që Zbatuesi të blejë pajisje, të sigurojë shërbime dhe të urdhërojë punime për Projektin, me procedura të pranueshme të prokurimit, në përputhje me kërkesat e Bankës me politikën e saj, siç përshkruhet në udhëzuesin e tij për prokurim.

6.5 Angazhime të vazhdueshme të Projektit

Huamarrësi duhet të sigurojë që Zbatuesi:

a) **mirëmbajtja:** të mirëmbajë, riparojë, rishikojë dhe rinovojë të gjithë pronën si pjesë e Projektit, siç kërkohet për ta mbajtur atë në gjendje të mirë pune

b) **asetet e Projektit:** vetëm nëse Banka ka dhënë pëlqimin paraprak me shkrim për të mbajtur titullin dhe pronësinë e të gjitha ose kryesisht të gjitha pasurive që përbëjnë Projektin ose, sipas rastit, zëvendësimin dhe rinovimin e aseteve të tilla dhe mbajtjen e Projektit në një veprim kryesisht të vazhdueshëm sipas qëllimit të saj origjinal; Banka mund të refuzojë pëlqimin e saj vetëm kur veprimi i propozuar do të dëmtonte interesat e Bankës si Huadhënës ndaj Huamarrësit ose do ta bënte Projektin të papërshtatshëm për financim nga Banka, në bazë të Statutit të tij ose sipas nenit 309 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian;

c) **sigurimi:** të sigurojë të gjitha punët dhe pasuritë që janë pjesë e Projektit me shoqëritë e sigurimit të klasit të parë, në përputhje me praktikat më të rëndësishme të industrisë;

d) **të drejtat dhe lejet:** të mbajë në fuqi të gjitha të drejtat e mënyrës ose të përdorimit dhe të gjitha autorizimet e nevojshme për ekzekutimin dhe funksionimin e Projektit;

e) **mjedisore dhe sociale:**

i. zbatimi dhe veprimi i Projektit në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale, duke përfshirë:

1. të sigurojë që çdo masë mjedisore dhe sociale për zbutjen dhe kompensimin të zbatohet në përputhje me dokumentet mjedisore dhe sociale dhe planin e veprimit social dhe menjëherë të njoftojë Bankën për çdo ndikim mjedisor ose social që mund të ndodhë gjatë zbatimit;

2. nuk do të fillojë asnjë rivendosje përpara se të arrihet marrëveshja e Bankës me RAP-në përkatëse;

3. të sigurojë që punimet fizike në zonën e prekur do fillojnë vetëm pasi kompensimi i PPP-së është përfunduar;

4. të vërë mekanizmin e ankesave në dispozicion për të gjithë personelin e Projektit, duke përfshirë kontraktorët dhe nënkontraktorët;

5. të sigurojë përfshirjen e kërkesave në lidhje me menaxhimin e aspekteve mjedisore dhe sociale të punëve kontraktuese, në përputhje me ligjin për mjedisin dhe shoqërinë, në dokumentet e tenderit dhe marrëveshjet e mëvonshme me kontraktuesit e përzgjedhur;

6. të monitorojnë periodikisht përputhjen e kontraktorëve me standardet e punës:

ii. të marrë, të mirëmbajë dhe të përputhet me miratimet mjedisore ose sociale për kërkesat e Projektit;

f) **ligji i BE-së:** ekzekutimi dhe operimi i Projektit në përputhje me ligjet përkatëse të Republikës së Shqipërisë dhe standardet përkatëse të së drejtës së BE-së, përveç për çdo derogim të përgjithshëm të bërë nga Bashkimi Evropian.

6.6 Angazhime të tjera

Huamarrësi do të sigurojë që Zbatuesi:

a) të mbajë një NJZP me termat e referencës, stafin, burimet, të gjitha sipas kërkesave të Bankës;

b) të ketë një mekanizëm efektiv të korrigjimit që siguron procedurat e shqyrtimit të pranueshme për Bankën dhe i vë ato në dispozicion të çdo personi ose enti që ka ose ka pasur interes në marrjen e një kontrate të financuar nga EIB-i dhe (në rrezik të) dëmtimit nga një shkelje e supozuar e rregullave të prokurimit në fuqi. Mekanizmi i mësipërm do të jetë sipas kërkesave të Bankës dhe disponueshmëria e saj do t'i konfirmohet Bankës para fillimit të procesit të parë të prokurimit;

c) të sigurojë që dokumentet e tenderit për të gjitha kontratat që do të financohen nga Banka do



të përfshijnë një referencë në mekanizmin e lartpërmendur, efektiv për shqyrtimin e ankesave lidhur me procesin e prokurimit;

d) të informojë menjëherë Bankën për çdo ndryshim në planin fillestar të prokurimit;

e) të konsultohet me Bankën lidhur me ndryshimin e kontratave të financuara nga EIB-i dhe do të kërkojë moskundërshtimin e Bankës, para se të hyjë në ndonjë ndryshim material në këto kontrata;

f) të sigurojë që auditimet e sigurisë rrugore të kryhen në përputhje me parimet e Direktivës së Sigurisë Rrugore 2008/96/EC dhe t'i ofrohen Bankës së bashku me tabelat përmbledhëse me konfirmimin e Zbatuesit se rekomandimet do të zbatohen ose, për masat që nuk mund të zbatohen, arsyetim për përjashtimin e tyre. Gjithashtu, do të përfshihet vlerësimi i aksesueshmërisë dhe sigurisë së këmbësorëve për të identifikuar nevojat dhe rreziqet për këmbësorët në veçanti

B. ANGAZHIME TË PËRGJITHSHME

6.7 Pajtueshmëria me ligjet

Huamarrësi do dhe do të sigurojë që Zbatuesi të përputhet në të gjitha aspektet me të gjitha ligjet dhe rregullat ndaj të cilave ai ose Projekti janë subjekt.

6.8 Librat dhe procesverbalet

Huamarrësi duhet dhe do të sigurojë që Zbatuesi:

a) të sigurojë që ka mbajtur dhe do të vazhdojë të mbajë libra dhe procesverbale të duhura të llogarisë në të cilën do të bëhen shënime të plota dhe korrekte të të gjitha transaksioneve financiare dhe pasurive dhe biznesit të Huamarrësit, duke përfshirë shpenzimet në lidhje me Projektin, në përputhje me GAAP-në që është në fuqi herë pas here; dhe

b) të mbajë procesverbale mbi kontratat e financuara me të ardhurat e Huas, duke përfshirë një kopje të vetë kontratës dhe dokumenteve materiale që kanë të bëjnë me prokurimin për të paktën 6 vjet nga kryerja e kontratës.

6.9 Integriteti

6.9.A Sjellje e ndaluar

a) Huamarrësi do të dhe do të sigurojë që Zbatuesi nuk do të angazhohet (dhe nuk do të autorizojë ose lejojë asnjë filial ose ndonjë person tjetër që vepron në emër të tij për t'u angazhuar) në çdo procedurë të ndaluar në lidhje me Projektin ose çdo transaksion i parashikuar nga Kontrata,

çdo procedurë tenderimi për Projektin, ose çdo transaksion i parashikuar nga Kontrata.

b) Huamarrësi merr përsipër të marrë dhe të sigurojë që Zbatuesi ndërmerr një veprim të tillë, që Banka do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të hetuar ose përfunduar çdo ngjarje të supozuar ose të dyshuar të çdo sjelljeje të ndaluar në lidhje me Projektin.

c) Huamarrësi merr përsipër dhe siguron që Zbatuesi të sigurojë që kontratat e financuara nga kjo hua përfshijnë dispozitat e nevojshme për të mundësuar Huamarrësin dhe/ose të hetojë ose të përfundojë çdo dukuri të pretenduar ose të dyshuar të ndonjë sjelljeje të ndaluar në lidhje me Projektin.

6.9.B Sanksionet

Huamarrësi nuk do dhe do të sigurojë që Zbatuesi nuk do të:

a) hyjë në një marrëdhënie biznesi me çdo Person të Sanksionuar; ose

b) vendosë çdo fond në dispozicion ose dobi, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, për çdo person të sanksionuar.

6.9.C Menaxhimi i Huamarrësit dhe Zbatuesit

Huamarrësi merr përsipër të marrë dhe të sigurojë se Zbatuesi do të marrë brenda një afati të arsyeshëm masat e duhura deri në masën e lejuar nga ligji i zbatueshëm në lidhje me çdo anëtar të organeve të tyre, i cili:

a) bëhet person i sanksionuar; ose

b) është subjekt i një vendimi të formës së prerë dhe të parevokueshme të gjykatës në lidhje me sjelljen e ndaluar të kryer gjatë ushtrimit të detyrave të tyre profesionale,

në mënyrë që të sigurojë se një anëtar i tillë pezullohet, shkarkohet ose në çdo rast të jetë i përjashtuar nga çdo aktivitet i Huamarrësit në lidhje me huan dhe Projektin.

6.10 Përfaqësitë e përgjithshme dhe garancitë

Huamarrësi përfaqëson dhe i garanton Bankës, se:

a) ka fuqinë të nënshkruajë, dorëzojë dhe përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate dhe të gjitha aksionet e nevojshme, aksionarët dhe veprimet e tjera janë marrë për të autorizuar nënshkrimin, dorëzimin dhe kryerjen e të njëjtit nga ai;

b) kjo Kontratë përbën detyrimet e saj ligjërish të vlefshme, detyruese dhe imponuese;

c) nënshkrimi dhe dorëzimi i, përmbushja e detyrimeve të tij dhe përmbushja e dispozitave të



kësaj Kontrate nuk kundërshtohet ose nuk bie ndesh, me:

i. çdo ligj, statut, rregull ose rregullore në fuqi, ose ndonjë aktgjykim, dekret ose leje për të cilin është subjekt; dhe

ii. çdo marrëveshje ose instrument tjetër detyrues për të, që arsyeshmërisht mund të pritët të ketë një efekt material negativ në aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate;

d) nuk ka pasur ndryshime materiale negative nga data 9 nëntor 2018;

e) asnjë ngjarje ose rrethanë, e cila përbën një rast të parapagesës ose një rast të mospërmbushjes së detyrimit, ka ndodhur dhe po vazhdon vëmendje i parregulluar ose nga i cili nuk është hequr dorë;

f) asnjë proces gjyqësor, arbitrazhi, procedura administrative ose hetimi nuk është aktuale ose në dijeni të tij është kërcënuar ose në pritje para ndonjë gjykate, organi ose agjencie të arbitrazhit që ka rezultuar ose nëse është përcaktuar keq, ka mundësi të arsyeshme të rezultojë në një ndryshim material negativ, ekzistojnë kundër tij ose ndonjë prej filialeve të saj çdo gjykim ose vendim të pakënaqur;

g) ka marrë të gjitha autorizimet e nevojshme në lidhje me këtë Kontratë dhe në mënyrë që të zbatojë me përputhshmëri në mënyrë të ligjshme detyrimet e saj në vijim, dhe Projekti dhe të gjitha autorizimet e tilla janë në fuqi të plotë dhe të pranueshme në prova;

h) detyrimet e saj të pagesës sipas kësaj Kontrate nuk janë më të ulëta se *pari passu* në të drejtën e pagesës me të gjitha detyrimet e tjera të tashme dhe të ardhshme të pasigurta dhe të pambaruara, sipas ndonjë prej instrumenteve të saj të borxhit, përveç obligimeve të parashikuara me ligj që zbatohen për kompanitë në përgjithësi;

i) është në përputhje me nenin 6.5(e) dhe sipas njohurive dhe besimit të saj më të mirë (pasi ka bërë hetim të duhur dhe të kujdesshëm) nuk është iniciuar ose nuk mund të paraqitet kundër tij një pretendim mjedisor ose social që nuk është njoftuar më parë te Banka; dhe

j) është në përputhje me të gjitha angazhimet sipas këtij neni 6; dhe

k) në maksimum të njohurive të tij, asnjë fond i investuar në Projekt nga Huamarrësi ose nga Zbatuesi nuk ka origjinë të paligjshme, përfshirë

produktet e pastrimit të parave ose të lidhura me financimin e terrorizmit;

l) as Huamarrësi, Zbatuesi, zyrtarët dhe drejtorët e tyre, as ndonjë person tjetër që vepron në emër të tij ose në emër të tyre ose nën kontrollin e tij ose të tyre, nuk ka kryer as nuk do kryejë:

i. ndonjë sjellje të ndaluar në lidhje me Projektin ose çdo transaksion të parashikuar nga Kontrata; ose

ii. ndonjë aktivitet të paligjshëm në lidhje me financimin e terrorizmit ose pastrimit të parave;

m) Projekti (duke përfshirë pa kufizim, negocimin, dhënien dhe përmbushjen e kontratave të financuara ose që do të financohen nga huaja) nuk ka përfshirë ose nuk ka krijuar ndonjë sjellje të ndaluar;

Përfaqësitë dhe garancitë e përcaktuara më sipër do t'i mbijetojnë ekzekutimit të kësaj Kontrate dhe janë, me përjashtim të përfaqësimit të paraqitur në paragrafin “F” më sipër, të përsëritura në çdo datë të pranimit të disbursimit, data e disbursimit dhe në çdo datë të pagesës.

Neni 7 Siguria

7.1 Renditja *pari passu*

Huamarrësi do të sigurojë që detyrimet e tij të pagesës sipas kësaj Kontrate renditen dhe do renditen jo më pak se *pari passu* në të drejtën e pagesës me të gjitha detyrimet e tjera të tashme dhe të ardhme të pasigurta dhe të pakonsoliduara në secilën nga instrumentet e saj të borxhit përveç obligimeve të parashikuara me ligj.

Në veçanti, nëse Banka bën një kërkesë sipas nenit 10.1 ose nëse ka ndodhur një ngjarje ose një ngjarje e mundshme e mospagimit në ndonjë instrument të borxhit të jashtëm të pavarur dhe të pasiguruar dhe të Huamarrësit ose të ndonjë prej agjencive apo instrumenteve të tij, Huamarrësi nuk duhet të bëjë (ose të autorizojë) asnjë pagesë në lidhje me ndonjë instrument tjetër të borxhit të jashtëm (nëse është planifikuar rregullisht ose ndryshe) pa paguar njëkohësisht, ose duke lënë mënjane në një llogari të caktuar për pagesë në Datën e Pagesës së ardhshme një shumë të barabartë me proporcionin e njëjtë të borxhit të papaguar, sipas kësaj Kontrate pasi proporcioni/raporti që pagesa në këtë instrument të borxhit të jashtëm mbart në borxhin total të papaguar në atë instrument të borxhit të jashtëm.



Për këtë qëllim, nuk duhet të merret parasysh asnjë pagesë e instrumentit të borxhit të jashtëm, e cila është kryer nga shuma e emetimit të një instrumenti tjetër, të cilit u janë nënshtruar kryesisht të njëjtët persona që kanë pretendime sipas instrumentit të borxhit të jashtëm.

Në këtë Kontratë, “Instrumenti i Borxhit të Jashtëm” do të thotë: a) një instrument, duke përfshirë çdo faturë ose pasqyrën e llogarisë, duke evidentuar ose përbërë një detyrim për të shlyer huan, depozitën, avancimin ose zgjerimin e ngjashëm të huas (duke përfshirë pa kufizim zgjerimin e huas, sipas një marrëveshje rifinancimi ose riplanifikimi), b) një detyrim të evidentuar nga një obligacion, detyrim ose prova të ngjashme me shkrim të borxhit; ose c) një garanci të dhënë nga Huamarrësi për një detyrim të një pale të tretë; me kusht që në çdo rast që një detyrim i tillë është: i. i qeverisur nga një sistem i ligjit, përveç ligjit të Huamarrësit; ose ii. të pagueshme në një monedhë të ndryshme nga monedha e vendit të Huamarrësit; ose iii. i pagueshëm një personi të përfshirë, banues, rezident ose me zyrën e tij qendrore ose vendin kryesor të biznesit jashtë vendit të Huamarrësit.

7.2 Siguria shtesë

Nëse Huamarrësi i jep një pale të tretë garanci për kryerjen e ndonjë instrumenti të borxhit të jashtëm ose ndonjë preferencë ose prioritet në lidhje me të, Huamarrësi, nëse kërkohet nga Banka, i siguron Bankës siguri ekuivalente për përmbushjen e detyrimeve të saj, sipas kësaj Kontrate ose i jep Bankës preference ose përparësi ekuivalente.

7.3 Klauzolat me përfshirje

Nëse Huamarrësi lidh një marrëveshje financimi me një huadhënës tjetër financiar që përfshin një klauzolë humbjeje të vlerësimit ose një zotim ose dispozitë tjetër në lidhje me raportet e saj financiare, nëse është e aplikueshme, që nuk është parashikuar në këtë Kontratë ose është më e favorshme për huadhënësin financiar se çdo dispozitë ekuivalente që kjo Kontratë është ndaj Bankës, Huamarrësi do të informojë menjëherë Bankën dhe do të sigurojë një kopje të dispozitës më të favorshme për Bankën. Banka mund të kërkojë që Huamarrësi të ekzekutojë menjëherë një marrëveshje për të ndryshuar këtë Kontratë, në mënyrë që të sigurojë një dispozitë ekuivalente në favor të Bankës.

Neni 8

Informacioni dhe vizitat

8.1 Informacion në lidhje me Projektin

Huamarrësi do të sigurojë që Zbatuesi:

a) të dorëzojë në bankë:

i. informacionin në përmbajtje dhe në formë, dhe në kohën e specifikuar në skedulën A ose, ndryshe, siç është rënë dakord herë pas here nga palët në këtë Kontratë; dhe

ii. çdo informacion ose dokument të mëtejshëm lidhur me financimin, prokurimin, zbatimin, funksionimin e Projektit dhe çështjet mjedisore ose sociale që Banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme brenda një kohe të arsyeshme,

me kusht që gjithmonë nëse një informacion ose dokument i tillë nuk dorëzohet në kohë dhe Huamarrësi nuk e korrigjon mosveprimin brenda një afati të arsyeshëm të përcaktuar nga Banka me shkrim, Banka mund të përmirësojë këtë mangësi, deri në masën e mundshme, duke përdorur stafin e saj, konsulent ose ndonjë pale të tretë, me shpenzimet e Huamarrësit dhe Huamarrësi do t'i sigurojë këta persona me gjithë ndihmën e nevojshme për këtë qëllim;

b) të paraqesë për miratimin e Bankës pa vonesë ndonjë ndryshim material në Projekt, duke marrë parasysh, gjithashtu, zbulimet e bëra Bankës në lidhje me Projektin përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate, në lidhje, ndër të tjera, me çmimin, Projektin, planet, afatet kohore ose programin e shpenzimeve ose planin e financimit për Projektin;

c) të njoftojë menjëherë Bankën, për:

i. çdo veprim apo protestë të iniciuar ose ndonjë kundërshtim i ngritur nga ndonjë palë e tretë ose ndonjë ankesë e vërtetë e marrë nga Huamarrësi ose Zbatuesi ose ndonjë kërkesë materiale mjedisore ose sociale që është në dijeni të saj, ka filluar ose është kërcënuar;

ii. kopje të njësuara me origjinalin, të kontratave të financuara me të ardhurat e Huas dhe dëshmi për shpenzimet që kanë të bëjnë me pagesat;

iii. çfarëdo fakti ose ngjarje të njohur nga Huamarrësi ose Zbatuesi, i cili mund të paragjykojë ose ndikojë në mënyrë të konsiderueshme në kushtet e ekzekutimit ose të veprimit të Projektit;

iv. çdo mospërputhje nga ajo me çdo standard mjedisor dhe social;

v. çdo pezullim, revokim ose modifikim të ndonjë aprovimi mjedisor ose social,



vi. një pohim të vërtetë ose ankesë lidhur me çdo sjellje të ndaluar lidhur me Projektin;

vii. nëse ai bëhet i vetëdijshëm për ndonjë fakt apo informacion që konfirmon ose arsyeton se: a) ka ndodhur ndonjë sjellje e ndaluar në lidhje me Projektin; ose b) ndonjë prej fondeve të investuara në kapitalin e saj ose në Projekt është nxjerrë nga një origjinë e paligjshme,

dhe të përcaktojë veprimin që duhet të merret në lidhje me këto çështje.

8.2 Informacion në lidhje me Huamarrësin

Huamarrësi duhet të:

a) dorëzojë herë pas here, informacion të mëtejshëm, dëshmi ose dokument, lidhur me:

i. gjendjen e tij financiare të përgjithshme ose certifikatat e tilla të pajtueshmërisë, në përputhje me angazhimet në nenin 6; dhe

ii. klientin ose ndonjë lloj tjetër çështjeje të kujdesit të duhur për Huamarrësin dhe/ose Zbatuesin, duke përfshirë pa kufizim përputhshmërinë me “njoh klientin tënd” (KYC) ose procedura të ngjashme identifikimi,

ashtu si Banka mund ta konsiderojë të nevojshme ose mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme që të sigurohet brenda një afati kohor të arsyeshëm; dhe

b) të informojë menjëherë Bankën, për:

i. çdo fakt që e detyron atë të parapagujë ndonjë borxh financiar ose ndonjë financim të Bashkimit Evropian;

ii. çdo ngjarje ose vendim që përbën ose mund të rezultojë në një ngjarje të parapagimit;

iii. çdo qëllim nga ana e tij për heqjen dorë nga pronësia e çdo komponenti material të Projektit;

iv. çdo fakt apo ngjarje që ka mundësi të mjaftueshme për të parandaluar përmbushjen të çdo detyrimi të Huamarrësit sipas kësaj Kontrate;

v. çdo ngjarje të mospërmbushjes së detyrimit të ndodhur ose ka pasur mundësi të ndodhë ose është parashikuar;

vi. çdo fakt apo ngjarje që rezulton në:

1. çdo anëtar të organeve të tij drejtuese; ose

2. çdo njësi kontrolluese që është person i sanksionuar;

vii. në masën e lejuar me ligj, çdo proces gjyqësor, arbitrazhi, procedurë administrative ose hetim të kryer nga një gjykatë, administratë ose autoritet i ngjashëm publik, i cili, në të mirë të njohurive dhe besimeve të tij, është i tanishëm, i afërt ose i pazgjidhur ende nga Huamarrësi ose

subjektet e tij kontrolluese ose anëtarët e organeve drejtuese të Huamarrësit, në lidhje me administrimin e ndaluar lidhur me huan ose Projektin;

viii. çdo masë e marrë nga Huamarrësi në lidhje me nenin 6.9 të kësaj Kontrate;

ix. çdo proces gjyqësor, arbitrazhi ose administrativ ose hetim i cili është i tanishëm, i paralajmëruar ose në pritje dhe i cili, nëse përcaktohet në mënyrë të kundërt, do të rezultojë në një ndryshim material negativ.

8.3 Vizitat, e drejta për akses dhe për hetim

Huamarrësi duhet dhe do të sigurojë që Zbatuesi të pranojë se Banka mund të jetë e detyruar të komunikojë informacionin në lidhje me Huamarrësin, Zbatuesin dhe Projektin te çdo institucion kompetent ose organ i Bashkimit Evropian, në përputhje me dispozitat përkatëse detyruese të ligjit të Bashkimit Evropian.

Huamarrësi dhe Zbatuesi do të lejojnë personat e caktuar nga Banka, si dhe personat e caktuar nga institucionet kompetente të BE-së, përfshirë Gjykatën e Auditorëve të Komuniteteve Evropiane, Komisionin Evropian dhe Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit, të:

a) vizitojnë vendet, instalimet dhe punimet që përfshijnë Projektin dhe të kryejnë kontrolle të tilla që ata dëshirojnë për qëllime të lidhura me këtë Kontratë dhe financimin e Projektit;

b) intervistojnë përfaqësuesit e Huamarrësit dhe/ose Zbatuesit dhe të mos pengojë kontaktet me ndonjë person tjetër të përfshirë në ose të ndikuar nga Projekti; dhe

c) shqyrtojnë librat dhe procesverbalet e Zbatuesit në lidhje me ekzekutimin e Projektit dhe të jetë në gjendje të marrë kopjet e dokumenteve në masën e lejuar nga ligji.

Huamarrësi dhe Zbatuesi do të lehtësojnë hetimet nga Banka dhe nga institucione ose organe të tjera kompetente të Bashkimit Evropian, në lidhje me çdo ngjarje të supozuar ose të dyshuar të një sjelljeje të ndaluar dhe do t'i sigurojë Bankës ose do të sigurohet që Bankës i është ofruar, e gjithë ndihma e nevojshme për qëllimet e përshkruara në këtë nen.

Huamarrësi pranon se Banka mund të jetë e detyruar të komunikojë informacionin në lidhje me Huamarrësin, Zbatuesin dhe Projektin te çdo institucion kompetent ose organ i Bashkimit Evropian duke përfshirë Gjykatën e Audituesve të



Komuniteteve Europiane, Komisionin Evropian dhe Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit, pasi janë të domosdoshme për kryerjen e detyrës së tyre, në përputhje me ligjet e Komunitetit Evropian, në përputhje me dispozitat e detyrueshme përkatëse të ligjit të Bashkimit Evropian.

Neni 9

Pagesat dhe shpenzimet

9.1 Tatimet, detyrimet dhe tarifat

a) Huamarrësi do të paguajë të gjitha taksat, detyrimet, tarifat dhe imponimet e tjera të çdo natyre, duke përfshirë detyrimet e vulës dhe tarifat e regjistrimit, që rrjedhin nga ekzekutimi ose zbatimi i kësaj Kontrate ose ndonjë dokumenti lidhur me të dhe në krijimin, përsosjen, regjistrimin ose zbatimin e çdo sigurimi të huas në masën e zbatueshme.

b) Huamarrësi do të paguajë të gjithë principalin, interesin, dëmshpërblimet dhe shumat e tjera që rrjedhin nga kjo Kontratë bruto, pa asnjë mbajtje ose zbritje të ndonjë imponimi kombëtar apo vendor që kërkohet me ligj ose sipas një marrëveshjeje me një autoritet qeveritar ose anasjelltas. Nëse Huamarrësi është i detyruar të bëjë ndonjë ndalim apo zbritje të tillë, ai do të paguajë bruto pagesën në Bankë, në mënyrë që pas mbajtjes në burim ose zbritjes, shuma neto e marrë nga Banka është e barabartë me shumën e detyrueshme për t'u paguar.

9.2 Pagesa të tjera

Huamarrësi do të bartë të gjitha pagesat dhe shpenzimet, duke përfshirë pagesat profesionale, bankare ose këmbimi të shkaktuara në lidhje me përgatitjen, nënshkrimin, zbatimin, përmbarimin dhe përfundimin e kësaj Kontrate ose ndonjë dokumenti të lidhur me të, çdo ndryshim, plotësim ose heqje dorë, në lidhje me këtë Kontratë çdo dokument të lidhur me të, si dhe në ndryshimin, krijimin, menaxhimin, zbatimin dhe realizimin e çfarëdo sigurie për huan. Banka do të sigurojë mbështetje dokumentare për çdo detyrim apo shpenzim të tillë 14 (katërmëdhjetë) ditë përpara se sa kërkesa e tij të bëhet e detyrueshme, me përjashtim të detyrimeve dhe shpenzimeve të vogla të lidhura me shuma deri në 50 euro (pesëdhjetë euro), për të cilat Banka do të paraqesë menjëherë mbështetje dokumentare me kërkesë të Huamarrësit.

9.3 Rritja e kostove, dëmshpërblimi dhe kompensimi

a) Huamarrësi do t'i paguajë Bankës çdo kosto ose shpenzim të shkaktuar ose të pësuar nga Banka si pasojë e paraqitjes ose ndonjë ndryshimi në (ose në interpretimin, administrimin ose zbatimin e çdo ligji ose rregulloreje ose pajtueshmëri me ndonjë ligj apo rregullore që ndodh pas datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate, në përputhje me ose si pasojë e së cilës:

i. Banka është e detyruar të pësojë kosto shtesë për të financuar ose për të kryer detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate; ose

ii. çdo shumë që i detyrohet Bankës sipas kësaj Kontrate ose të ardhurat financiare që rezultojnë nga dhënia e Huas ose Huas nga Banka të Huamarrësi, reduktohet ose eliminohet.

b) pa cenuar ndonjë të drejtë tjetër të Bankës, sipas kësaj Kontrate ose sipas ndonjë ligji të zbatueshëm, Huamarrësi do të dëmshpërblejë dhe mbajë Bankën të padëmtuar nga dhe kundër çdo humbjeje të shkaktuar si rezultat i çdo shkarkimi të plotë ose të pjesshëm që ndodh në një mënyrë tjetër, përveç asaj të përcaktuar shprehimisht në këtë Kontratë.

c) Banka mund të vendosë çdo detyrim të maturuar që duhet të paguhet nga Huamarrësi sipas kësaj Kontrate (deri në masën që përfiton nga Banka) kundrejt çdo detyrimi (të matur apo jo) që i detyrohet Banka Huamarrësit pavarësisht nga vendi i pagesës, dega e rezervimit ose monedha e detyrimit. Nëse detyrimet janë në valuta të ndryshme, Banka mund të konvertojë ose detyrojë me një normë të tregut të këmbimit në rrjedhën e zakonshme të biznesit të saj për qëllime kompensimi. Nëse njëra nga detyrimet është e paekuilibruar ose e papërcaktuar, Banka mund të vendosë në një shumë të vlerësuar prej saj në mirëbesim, për të qenë shuma e atij detyrimi.

Neni 10

Ngjarje të mospërmbushjes së detyrimit

10.1 E drejta për të kërkuar shlyerjen

Huamarrësi do të shlyejë menjëherë ose tërësisht një pjesë të Huas së papaguar (siç kërkohet nga Banka) së bashku me interesin e përlogaritur dhe të gjitha shumat e tjera të përlogaritura ose të papaguara sipas kësaj Kontrate, me kërkesën me shkrim të bërë nga Banka në përputhje me dispozitat e mëposhtme.



10.1.A Kërkesa e menjëhershme

Banka mund ta bëjë një kërkesë të tillë menjëherë:

a) nëse Huamarrësi nuk paguan në datën e caktuar ndonjë shumë të pagueshme sipas kësaj Kontrate në vendin dhe në monedhën në të cilën shprehet se do të paguhet, vetëm nëse:

i. dështimi i saj për pagesë është shkaktuar nga një gabim administrativ ose teknik ose një ngjarje për ndërprerje; dhe

ii. pagesa bëhet brenda 3 (tre) ditëve të punës nga data e detyrimit;

b) nëse ndonjë informacion ose dokument i dhënë Bankës nga ose në emër të Huamarrësit ose ndonjë përfaqësimi, garancie ose deklarate të bërë ose që konsiderohet se është bërë nga Huamarrësi, në përputhje me ose për qëllimet e lidhjes së kësaj Kontrate ose në lidhja me negocimin ose kryerjen e kësaj Kontrate është ose dëshmon të jetë e pasaktë, e paplotë ose mashtrim në çdo aspekt;

c) në qoftë se, pas ndonjë mospërbushjeje të detyrimit të Huamarrësit në lidhje me ndonjë hua ose çdo detyrim që rrjedh nga ndonjë transaksion financiar, përveç Huas:

i. Huamarrësit i kërkohet ose është i aftë t'i kërkohet ose do t'i kërkohet ose pas skadimit të ndonjë periudhe të zbatueshme kontraktuale pa interes, do t'i kërkohet të parapaguajë, përmbushë, mbyllë ose të përfundojë përpara afatit të maturimit një hua apo detyrim tjetër të tillë, pas skadimit të çdo periudhe të maturuar; ose

ii. çdo angazhim financiar për një hua apo detyrim tjetër të tillë anulohet ose pezullohet;

d) nëse Huamarrësi nuk është në gjendje të paguajë borxhet e tij ose pezullon borxhet e tij, ose bën ose kërkon të bëjë një ujdj me huatorët e tij;

e) nëse çdo procedurë ligjore ose çdo procedurë ose hap tjetër në lidhje me pezullimin e pagesave, një moratorium për çdo borxh ose ndonjë procedurë e ngjashme ose hap është marrë nën zbatimin e ligjit të zbatueshëm në çdo juridiksion ose çdo situatë e ngjashme me cilëndo nga sa më sipër ndodh sipas ndonjë ligji të zbatueshëm;

f) nëse bartësi që merr në zotërim ose marrësi, likuiduesi, administratori, marrësi administrativ ose zyrtari i ngjashëm emërohet, qoftë nga një gjykatë kompetente ose nga ndonjë autoritet kompetent administrativ ose nga cilido person, nga ose mbi çdo pjesë të biznesit ose pasurive të Huamarrësit ose ndonjë pronë që është pjesë e Projektit;

g) nëse Huamarrësi nuk është në gjendje të përmbushë ndonjë detyrim në lidhje me ndonjë hua tjetër të dhënë nga Banka ose instrumenti financiar i lidhur me Bankën;

h) nëse Huamarrësi nuk është në gjendje të përmbush ndonjë detyrimin në lidhje me ndonjë hua tjetër që i është dhënë nga burimet e Bankës ose Bashkimit Europian;

i) në qoftë se ndodh një ndryshim material i pafavorshëm, në krahasim me gjendjen e Huamarrësit në datën e kësaj Kontrate;

j) nëse është ose bëhet e paligjshme për Huamarrësin për të kryer ndonjë nga detyrimet e tij, sipas kësaj Kontrate ose kjo Kontratë nuk është efektive në përputhje me kushtet e saj ose pretendon që Huamarrësi të jetë i paefektshëm në përputhje me kushtet e tij;

10.1.B Kërkesë pas njoftimit për rikuperim

Banka mund të bëjë, gjithashtu, një kërkesë të tillë menjëherë:

a) nëse Huamarrësi nuk zbaton ndonjë dispozitë të kësaj Kontrate (përveç atyre të përmendura në nenin 10.1.A; ose

b) nëse ndonjë fakt i lidhur me Huamarrësin ose Projektin, i përmendur në paragrafë, ndryshon dhe nuk është materialisht i rivendosur dhe nëse ndryshimi paragjykon interesat e Bankës si huadhënës ndaj Huamarrësit ose ndikon negativisht në zbatimin ose funksionimin e Projektit,

përveç rasteve kur mospërputhja ose rrethanat që shkaktojnë mospajtueshmërinë janë në gjendje të korrigjohen dhe të zgjidhen brenda një periudhe të arsyeshme kohore të përcaktuar në një njoftim të shërbyer nga Banka për Huamarrësin.

10.2 Të drejta të tjera në ligj

Neni 10.1 nuk kufizon asnjë të drejtë tjetër të Bankës për të kërkuar parapagimin e huas të papaguar.

10.3 Dëmshpërblimi

10.3.A Transhet me normë fikse

Në rast të kërkesës sipas nenit 10.1, në lidhje me çdo transh me normë fikse, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës shumën e kërkuar së bashku me dëmshpërblimin për çdo shumë të principalit për shkak të parapagimit. Dëmshpërblimi i tillë: i. do të grumbullohet nga data e detyrueshme për pagesë e specifikuar në njoftimin e kërkesës së Bankës dhe llogaritet në bazë të saj se parapagimi është kryer në datën e përcaktuar në këtë mënyrë; dhe ii. do të jetë



për shumën e komunikuar nga Banka të Huamarrësi si vlera aktuale (e llogaritur në datën e parapagimit) e shumës, nëse ka, të:

a) interesit që do të rritet më pas në shumën e parapaguar gjatë periudhës nga data e parapagimit deri në datën e rivlerësimit/konvertimit të interesit, nëse ka, ose në datën e maturimit, nëse nuk ishte parapaguar; mbi

b) interesit që do të rritet në atë periudhë, në qoftë se është llogaritur me normën e rivendosjes, më pak se 0.15% (pesëmbëdhjetë pikë bazë).

Vlera e thënë aktuale llogaritet me një normë skontimi të barabartë me normën e rivendosjes, që zbatohet për secilën datë përkatëse të pagesës së transhit në fuqi.

10.3.B Transhet me norma të ndryshueshme

Në rast të kërkesës, sipas nenit 10.1, në lidhje me ndonjë transh me normë të ndryshueshme, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës shumën e kërkuar, së bashku me një shumë të barabartë me vlerën aktuale prej 0.15% (pesëmbëdhjetë pikë bazë) në vit të llogaritura dhe të përlllogaritura në shumën e principalit për t'u parapaguar në të njëjtën mënyrë si interesi do të ishte llogaritur dhe do të ishte përlllogaritur, nëse kjo shumë do të ishte e papaguar sipas programit të amortizimit të transhit, deri në datën e rivlerësimit/konvertimit të interesit, nëse ka, ose datën e maturimit.

Vlera do të llogaritet me një normë skontimi të barabartë me normën e rivendosjes që zbatohet për secilën datë përkatëse të pagesës.

10.3.C Të përgjithshme

Shumat e pagueshme nga Huamarrësi, sipas këtij neni 10.3, do të paguhën në datën e specifikuar në kërkesën e Bankës.

10.4 Ndalimi i heqjes dorë

Asnjë dështim ose vonesë ose ushtrimi i vetëm ose i pjesshëm i Bankës në ushtrimin e ndonjë prej të drejtave të tij ose mjeteve juridike sipas kësaj Kontrate, do të interpretohet si një heqje dorë nga kjo e drejtë ose mjet juridik. Të drejtat dhe mjetet juridike të parashikuara në këtë Kontratë janë kumulative dhe nuk përjashtohen nga asnjë të drejtë ose mjet juridik të parashikuara nga ligji.

Neni 11

Ligji dhe juridiksioni, të ndryshme

11.1 Ligji qeverisës

Kjo Kontratë rregullohet nga ligjet e Luksemburgut.

Faqe | 12088

11.2 Juridiksioni

a) Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian ka juridiksion ekskluziv për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje (një “mosmarrëveshje”) që rrjedh nga ose në lidhje me këtë Kontratë (duke përfshirë një mosmarrëveshje në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë ose përfundimin e kësaj Kontrate ose pasojat e pavlefshmërisë së saj) ose ndonjë detyrim jokontraktual që rrjedh nga ose në lidhje me këtë Kontratë.

b) Palët pajtohen që Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian është gjykata më e përshtatshme dhe e favorshme për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje ndërmjet tyre dhe, për rrjedhojë, se ata nuk do të argumentojnë të kundërtën.

c) Palët e kësaj Kontrate heqin dorë nga çdo imunitet ose e drejta për të kundërshtuar juridiksionin e këtyre gjykatave. Vendimi i gjykatave të dhëna sipas këtij neni është përfundimtar dhe detyrues për secilën palë pa kufizim ose rezervim.

11.3 Vendi i kryerjes

Vetëm nëse është rënë dakord ndryshe nga Banka, me shkrim, vendi i kryerjes sipas kësaj Kontrate do të jetë selia e Bankës.

11.4 Dëshmia e shumave të detyrueshme

Në çdo veprim ligjor që rrjedh nga kjo Kontratë, certifikata e Bankës për çdo shumë ose normë për shkak të Bankës sipas kësaj Kontrate, në mungesë të gabimit të dukshëm, do të jetë evidence kryesore e shumës ose normës së tillë.

11.5 Marrëveshja e plotë

Kjo Kontratë përbën gjithë marrëveshjen midis Bankës dhe Huamarrësit, në lidhje me dhënien e kredisë në vijim, dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme, qoftë të shprehur apo të nënkuptuar, për të njëjtën çështje.

11.6 Pavlefshmëria

Nëse në çdo kohë ndonjë term i kësaj Kontrate është ose bëhet i paligjshëm, i pavlefshëm ose i pazbatueshëm në çfarëdo kuptimi, ose kjo Kontratë është ose bëhet e paefektshme në çdo aspekt, sipas ligjeve të çdo juridiksioni, kjo paligjshmëri, pavlefshmëri, pazbatueshmëria ose joefektshmëria nuk do të ndikojë:

a) ligjshmërinë, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë në atë juridiksion të çdo afati tjetër të kësaj Kontrate ose efektshmërinë në çdo aspekt tjetër të kësaj Kontrate në atë juridiksion; ose

b) ligjshmërinë, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë në juridiksionet e tjera të asaj ose ndonjë



term tjetër të kësaj Kontrate ose efektshmërinë e kësaj Kontrate sipas ligjeve të këtyre juridiksioneve të tjera.

11.7 Ndryshimet

Çdo ndryshim i kësaj Kontrate do të bëhet me shkrim dhe do të nënshkruhet nga palët. Ministri i Financave dhe Ekonomisë i Republikës së Shqipërisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim, i cili duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Ndryshimet e kësaj Kontrate që prekin vetëm afatet e disbursimit nuk do të kërkojnë miratimin paraprak nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

11.8 Kopjet

Kjo Kontratë mund të ekzekutohet në çdo numër të kopjeve, të cilat të gjitha së bashku do të përbëjnë një dhe të njëjtin instrument. Çdo kopje është një origjinal, por të gjitha kopjet duhet të përbëjnë së bashku një dhe të njëjtin instrument.

Neni 12

Klauzolat përfundimtare

12.1 Njoftimet

12.1.A Forma e njoftimit

a) çdo njoftim ose komunikim tjetër i dhënë sipas kësaj Kontrate duhet të jetë me shkrim dhe, përveç nëse deklarohet ndryshe, mund të jetë me letër dhe postë elektronike.

b) njoftimet dhe komunikimet e tjera për të cilat periudhat fikse janë të përcaktuara në këtë Kontratë ose që vetëcaktjnë afate të detyrueshme për të adresuarin, mund të bëhen me dorëzim dore, letër të regjistruar, faks ose me postë elektronike. Njoftimet dhe komunikimet e tilla do të konsiderohen se janë pranuar nga pala tjetër:

i. në datën e dorëzimit në lidhje me një letër të dorëzuar ose të regjistruar;

ii. në rast të ndonjë postimi elektronik të dërguar nga Huamarrësi në Bankë, vetëm kur është marrë në formë të lexueshme dhe vetëm nëse është adresuar në atë mënyrë që Banka specifikon për këtë qëllim; ose

iii. në rastin e ndonjë postimi elektronik të dërguar nga Banka te Huamarrësi, kur dërgohet postë elektronike.

c) çdo njoftim i dhënë nga Huamarrësi në Bankë me postë elektronike do të:

i. përmendë numrin e kontratës në linjën e subjektit; dhe

ii. jetë në formën e një imazhi elektronik jo të redaktueshëm (PDF, TIF ose format tjetër të paredaktueshëm të rënë dakord midis palëve) të njoftimit të nënshkruar nga një nënshkruarës i autorizuar me të drejtë individuale të përfaqësimit ose nga dy ose më shumë nënshkruarës të autorizuar me të drejtë të përfaqësimit të përbashkët të Huamarrësit të bashkangjitur në postën elektronike;

d) pa ndikuar në vlefshmërinë e njoftimeve të postës elektronike ose të faksit, ose të komunikimit të bërë në përputhje me këtë nen 12.1, njoftimet, komunikimet dhe dokumentet e mëposhtme do të dërgohen edhe me letër të regjistruar te pala relevante, jo më vonë se dita e punës pasardhëse:

i. pranimi i disbursimit;

ii. çdo njoftim dhe komunikim në lidhje me shtyrjen, anulimin dhe pezullimin e një disbursimi të ndonjë transhi, rishikimin e interesit ose konvertimin e çdo transhi, ngjarja e mosfunksionimit të tregut, kërkesën e parapagimit, njoftimin për parapagim, ngjarja e mospagimit, çdo kërkesë për parapagim; dhe

iii. çdo njoftim tjetër, komunikim ose dokument tjetër që kërkohet nga Banka;

e) palët bien dakord që çdo komunikim i mësipërm (duke përfshirë edhe postën elektronike) është një formë e pranuar e komunikimit, përbën dëshmi të pranueshme në gjykatë dhe do të ketë të njëjtin vlerë dëshmie si një marrëveshje në dorëzim.

12.1.B Adresat

Adresa, numri i faksit dhe adresa e postës elektronike (dhe departamenti ose oficeri, nëse ka, për vëmendjen e të cilit duhet të bëhet komunikimi) të secilës palë për çdo komunikim që duhet të bëhet ose dokumenti të dorëzohet nën ose në lidhje me këtë Kontratë është:

Për Bankën:

Vëmendje: OPS/MA-3 PUB SEC (SI,HR,WBs)

100 boulevard Konrad Adenauer

L-2950 Luxembourg

Facsimile no: +352 4379 58417

Adresa e-mail: OPS_MA-3_SecDiv@eib.org

Për Huamarrësin:

Vëmendje: Ministria e Financës dhe Ekonomisë

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3

Republika e Shqipërisë

Adresa e-mail: sekretariamin@finance.gov.al

12.1.C Njoftimi i detajeve të komunikimit



Banka dhe Huamarrësi do të njoftojnë menjëherë palën tjetër me shkrim për çdo ndryshim në detajet e tyre të komunikimit.

12.2 Gjuha angleze

Çdo njoftim ose komunikim i dhënë në ose në lidhje me këtë Kontratë duhet të jetë në gjuhën angleze.

Të gjitha dokumentet e tjera të siguruar në ose në lidhje me këtë Kontratë duhet të jenë:

a) në anglisht; ose

b) nëse nuk është në gjuhën angleze, dhe nëse kërkohet nga Banka, shoqëruar me një përkthim të certifikuar në gjuhën angleze dhe, në këtë rast, do të mbizotërojë përkthimi në gjuhën angleze.

12.3 Data e hyrjes në fuqi

Kjo Kontratë do të hyjë në fuqi pas konfirmimit nga Banka për Huamarrësin se ajo ka marrë një kopje të vërtetuar të Fletores Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, që boton ligjin për ratifikimin e kësaj Kontrate nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë (hyrja në fuqi).

12.4 Paragrafët, skedulët

Paragrafët dhe skedulët e mëposhtme janë pjesë e kësaj Kontrate:

Skeduli A:	Specifikimi dhe raportimi i Projektitshman
Skeduli B:	Përkufizimet e EURIBOR-it
Skeduli C:	Formulari i ofertës së disbursimit/të përmirësimit
Skeduli D:	Rishikimi dhe konvertimi i normës së interesit
Skeduli E:	Formulari i certifikatës nga Huamarrësi

Palët, këtu, kanë bërë që kjo Kontratë të nënshkruhet në 3 origjinale, në gjuhën angleze dhe kanë shkaktuar që përfaqësuesit e secilës palë të siglojnë çdo faqe të kësaj Kontrate në emër të tyre.

Poznan, më 5 korrik 2019

Nënshkruar për dhe në emër të:

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Ministri i Financave dhe Ekonomisë

Anila Denaj

Nënshkruar për dhe në emër të:

BANKA EVROPIANE E INVESTIMIT

Drejtor i Përgjithshëm

Zëvendës-drejtor i Operacioneve

Luca Lazzaroli

Këshilltar ligjor

Alessandro Cagnato

Skeduli A

Specifikimi dhe raportimi i Projektit

A.1.1 PËRSHKRIMI TEKNIK

Qëllimi, vendndodhja

Shtrati i lumit Lana – Projekti i Zhvillimit Urban (Projekti), përfshin vepra rreth 1.8 km të lumit Lana dhe përfundon rehabilitimin e lumit të bërë përgjatë përafërsisht 16 km në rrjedhën e sipërme të zonës së Projektit në Bashkinë e Tiranës.

Përshkrimi

Projekti përfshin zgjerimin e dy bulevardëve, të cilat janë paralele me lumin Lana, përkatësisht bulevardet “Gjergj Fishta” dhe “Bajram Curri”, duke kontribuar në rigjenerimin urban përmes pajisjes në zonën e lumit me infrastrukturë urbane (drenazhimi, kanalizimi, ndriçimi publik, autobusë dhe korsi të biçikletave) dhe përmirësimin e integritetit dhe lidhjes së dy brigjeve të lumenjve me qytetin. Gjithashtu, do të përfshijë punimet pastrimi dhe pastrimi në shtratin e lumit Lana, rregullimin dhe ridrejtimin e rrjedhës së lumit për të cilat janë parashikuar problemet e përmbytjeve në këtë zonë.

Tubat e kanalizimeve që do të vendosen si pjesë e Projektit do të lidhen me rrjetin e kanalizimit, i cili aktualisht, është duke u përmirësuar si pjesë e Projektit të Përmirësimit të Kanalizimit të Tiranës së Madhe. Paralelisht dhe si pjesë e këtij Projekti të Kanalizimeve, Autoriteti Kombëtar i Ujit (AKUK) po udhëheq ndërtimin e impiantit të parë të trajtimit të ujit në rrethin e Kasharit, që pritet të përfundojë deri në fund të vitit 2022.

Kalendari

Projekti do të ndërtohet gjatë periudhës 2019–2022.

A.2 INFORMACIONI MBI PROJEKTIN QË DO TË DËRGOHET BANKËS DHE METODA E TRANSMETIMIT

1. Dërgimi i informacionit: Përcaktimi i personit përgjegjës

Informacioni i mëposhtëm duhet t'i dërgohet Bankës nën përgjegjësinë e:



	Kontakt teknik
Kompania	Bashkia e Tiranës
Personi i kontaktit	Henrik Hysenbegasi
Titulli	Drejtor i Implementimit të Investimeve të Huaja (NJZP)
Departamenti teknik	Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike
Adresa	Sheshi “Skënderbej” Nd. 2, kodi ZIP 1001, Tiranë, Shqipëri
Telefon fiks	+ 355 42 266340
Celular	+ 355 674045752
E-mail	henrik.hysenbegasi@tirana.al

Personi kontaktues i lartpërmendur është kontakt i përgjegjshëm për momentin.

Huamarrësi do të informojë menjëherë EIB-në në rast të ndonjë ndryshimi.

2. Informacion mbi subjekte të veçanta

Huamarrësi do t'i dorëzojë Bankës informacionin e mëposhtëm më maksimumi në afatin e treguar më poshtë.

Dokumenti/informacioni	Afati
Termat e referencës për mekanizmin e mundshëm dhe efektiv të mjeteve juridike për kontratat e financuara nga EIB-ja, të kënaqshme për Bankën.	Para fillimit të procesit të parë të prokurimit.
Çdo ndryshim në planin fillestar të prokurimit.	Sapo të jetë në dispozicion
Kopja e autorizimit mjedisor të lëshuar nga autoriteti kompetent, duke përfshirë konfirmimin se Projekti nuk ndikon në ndonjë zonë të mbrojtur natyrore.	Sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast para disbursimit të parë.
Plani i veprimit të zhvendosjes për zhvendosjen e shkaktuar nga Projekti dhe plani i angazhimit të aksionarëve. Zbatuesi nuk do të fillojë asnjë rivendosje para se të marrë pëlqimin e Bankës në RAP-në përkatëse.	Sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast para rivendosjes dhe disbursimit të parë.
Kopja e auditimeve të sigurisë rrugore për Projektin dhe kryhet në përputhje me parimet e Direktivës së Sigurisë Rrugore 2008/96/EC së bashku me tabelat përmbledhëse me konfirmimin e Zbatuesit se rekomandimet do të zbatohen ose për masat që nuk mund të zbatohen - justifikimi për përjashtimin e tyre. Gjithashtu, do të përfshihet vlerësimi i aksesueshmërisë dhe sigurisë së këmbësorëve për të identifikuar nevojat dhe rreziqet për këmbësorët në veçanti.	Sapo të jetë në dispozicion
Evidenca që: - Punimet fizike në zonën e prekur do të fillojë vetëm pasi kompensimi i PPP-së ka përfunduar; - Njësia për Implementimin e Projektit është në veprim me termat e referencës, personelin, burimet dhe asistencë teknike, të gjitha për kënaqësinë e Bankës, në veçanti, në lidhje me aspektet mjedisore dhe sociale, duke përfshirë sigurinë në rrugë; - Ekipi i mbikëqyrjes së punës në funksion me termat e referencës, stafit dhe burimeve, të gjitha sipas kënaqësisë së Bankës.	Sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast para disbursimit të parë ose disbursimit në lidhje me punët.
- Dëshmi të kënaqshme për Bankën për statusin e zbatimit të Projektit të Përmirësimit të Kanalizimeve të Tiranës së Madhe, duke përfshirë edhe impiantin e trajtimit të ujit. Ky status implementimi do të garantojë që grumbulluesit e ujërave të zeza të përfshira në Projekt do të integrohen në Projektin e trajtimit të ujërave të ndotura në zbatim, përpara përfundimit të Frontit të Lumit – Rizhvillimi Urban përfundon në vitin 2021.	Para disbursimit përfundimtar.

3. Informacion mbi zbatimin e Projektit

Huamarrësi do t'i dorëzojë Bankës informacionin e mëposhtëm mbi progresin e Projektit gjatë implementimit deri në afatin e treguar më poshtë



Dokumenti/ informacioni	Afati	Shpeshtësia e raportimit
Raporti i progresit të Projektit: - Një përditësim të shkurtër në përshkrimin teknik, duke shpjeguar arsyet për ndryshime të rëndësishme kundrejt qëllimit fillestar; - Përditësim në datën e përfundimit të secilit prej komponentëve të Projektit kryesor, duke shpjeguar arsyet për ndonjë vonesë të mundshme; - Përditësim mbi koston e Projektit, duke shpjeguar arsyet për çdo ndryshim të mundshëm të koston kundrejt koston fillestare të buxhetuar; - Një përshkrim të çdo problemi të madh me ndikim në mjedis; - Progresi në rivendosjen dhe në zbatimin e planeve të tjera të menaxhimit mjedisor ose social; - Përditësimi i planit të prokurimit; - Çdo çështje e rëndësishme që ka ndodhur dhe çdo rrezik domethënës që mund të ndikojë në punën e Projektit; - Çdo veprim ligjor në lidhje me Projektin që mund të jetë në vazhdim; - Fotot që nuk lidhen me Projektet, nëse janë të disponueshme.	31 janar dhe 31 korrik, duke filluar më 31 korrik 2019	Çdo gjashtë muaj nga 2019 deri në vitin 2022 (ose deri në përfundimin e Projektit)

4. Informacion mbi përfundimin e punimeve dhe vitin e parë të punës

Huamarrësi do t'i dorëzojë Bankës informacionin e mëposhtëm mbi përfundimin e Projektit dhe operimin deri në afatin e treguar më poshtë.

Dokument/informacion	Data e dorëzimit në Bankë
Raporti i përfundimit të Projektit, duke përfshirë: - Një përshkrim i fundit teknik i Projektit, si e përfunduar, duke shpjeguar arsyet për ndonjë ndryshim të rëndësishëm në krahasim me përshkrimin teknik në A.1; - Datën e përfundimit të secilit prej komponentëve kryesorë të Projektit, duke shpjeguar arsyet për ndonjë vonesë të mundshme; - Kostoja përfundimtare e Projektit, duke shpjeguar arsyet për çdo ndryshim të mundshëm të koston kundrejt koston fillestare të buxhetit; - Burimet përfundimtare të fondeve për Projektin; - Efektet e punësimit të Projektit: personat-ditët e kërkuara gjatë zbatimit, si dhe krijimi i vendeve të reja të punës; - Një përshkrim të çdo çështjeje të rëndësishme me ndikim në mjedis ose ndikime sociale; - Përditësim i procedurave të prokurimit dhe sqarimi i devijimeve nga plani i prokurimit; - Përditësim mbi kërkesën ose përdorimin dhe komentet e Projektit; - Çdo çështje e rëndësishme që ka ndodhur dhe çdo rrezik domethënës që mund të ndikojë në punën e Projektit; - Çdo veprim ligjor në lidhje me Projektin që mund të jetë në vazhdim e sipër; - Fotot jokonfidenciale që lidhen me Projektet, nëse janë të disponueshme; - Numri i raportuar i fataliteteve rrugore nga policia gjatë operacionit të Projektit dhe shpërndarja e tyre në grupet e përdoruesve të rrugës për vit; - Një përditësim mbi treguesit e mëposhtëm të monitorimit, marrë si bazë në Projekt; - Zona e shërbyer nga infrastruktura për parandalimin e përmblytjeve dhe zona e rrizhvilluara: 110 ha - Gjatësia e korsive të ndërtuara të autobusëve: 3.60 km - Gjatësia e rrugëve urbane të ndërtuara: 1.83 km në bregun e djathtë dhe 1.79 km në të majtë. Totali prej 3.62 km - Zona të gjelbra: 37,395.00 m² - Gjatësia e tubave të kanalizimeve dhe/ose të stuhive të ndërtuara: kanalizim 3.22 km dhe stuhi 3.46 km. Totali prej 6.68 km; - Popullsia e shërbyer nga infrastruktura e re/rinovuar: 65,000 - Personat me rrezik të reduktuar nga përmblytjet: 20,000	31 mars 2024 (ose 15 muaj pas përfundimit të Projektit)



Financimi për këtë Projekt përfiton nga një garanci e BE-së për Bankën sipas vendimit nr. 466/2014/BE të Parlamentit European dhe të Këshillit. Në bazë të nenit 9(2) të këtij vendimi, Banka “do t’i kërkojë Zbatuesit të projekteve për të kryer monitorimin e plotë gjatë zbatimit të Projektit deri në përfundimin, ndër të tjera: impaktin ekonomik, zhvillimin, të drejtat sociale, mjedisore dhe njerëzore të Projektit të investimit. EIB-ja do të verifikojë në mënyrë të rregullt në informacionin e dhënë nga nxitësit e Projektit dhe të bëjë atë në dispozicion të publikut, nëse Zbatuesi i Projekti bie dakord. Kur është e mundur, raportet e përfundimit të projekteve, që lidhen me operacionet e financimit EIB, do të publikohen duke përjashtuar informacionin konfidencial”.

Prandaj, dhe pa paragjykuar detyrimin e Bankës për të bërë publik në dispozicion çdo informacion mjedisor lidhur me Projektin sipas Konventës së Aarhusit, Banka do të vërë në dispozicion të publikut të gjitha informatat e dhëna nga Huamarrësi në raportet e progresit të Projektit dhe raportin e përfundimit të Projektit, me kusht që informacioni i tillë është shprehimisht shënuar nga Huamarrësi, si: “për publikim në faqen e internetit të EIB-së”.

Në mënyrë alternative, Huamarrësi mund të vendosë, gjithashtu, ta publikojë këtë informacion në faqen e vet dhe t’i japë EIB-së linkun përkatës (URL), i cili do të përdoret si burim për publikimin e EIB-së.

EIB-ja nuk do të marrë asnjë përgjegjësi për përmbajtjen e informacioneve të tilla të bëra publike në faqen e saj të internetit. Dokumentet e shënuara, si: “për publikim në faqen e internetit të EIB-së” do të publikohen si të pranuar dhe nuk do të redaktohen nga EIB-ja. Vetëm URL-të e funksionimit që lidhen me informacionin përkatës të Projektit do të publikohen nga EIB-ja.

5. Informacioni i kërkuar 3 vjet pas raportit të përfundimit të Projektit

Huamarrësi do të dorëzojë në Bankë informacionin e mëposhtëm 3 vjet pas raportit të përfundimit të Projektit, deri në afatin e caktuar më poshtë.

Dokument/informacion	Data e dorëzimit në Bankë
Përditësim mbi treguesit e monitorimit të renditur në tabelën e mësipërme.	31 mars 2027
Gjuha e raporteve	Anglisht

Skeduli B

Përkufizimi i EURIBOR-it

A. EURIBOR

“EURIBOR” do të thotë:

a) në lidhje me një periudhë përkatëse, prej më pak se një muaj, norma ndërbankare londineze (siç përcaktohet më poshtë) për një periudhë prej një muaji;

b) në lidhje me një periudhë përkatëse, prej një ose më shumë muaj, për të cilin norma ndërbankare londineze është në dispozicion, norma ndërbankare londineze e zbatueshme për një afat për numrin përkatës të muajve; dhe

c) në lidhje me një periudhë përkatëse, prej më shumë se një muaj, për të cilin norma ndërbankare londineze nuk është e disponueshme, norma rezulton nga një interpolim linear, duke iu referuar dy normave ndërbankare londineze, njëra nga të cilat është e zbatueshme për një periudhë tjetër të shkurtër dhe të tjera për një periudhë tjetër më të gjatë, se sa kohëzgjatja e periudhës përkatëse,

(periudha për të cilën norma është marrë ose nga të cilat normat janë interpoluar, duke qenë “periudha përfaqësuese”).

Për qëllimet e paragrafëve “b” dhe “c” më sipër:

i. “i disponueshëm” nënkupton normat, për maturimet e dhëna, të cilat janë llogaritur dhe publikuar nga Global Rate Set Systems Ltd (GRSS) ose një ofrues i tillë i shërbimeve të përzgjedhura nga Instituti European i Tregjeve të Parave (EMMI), nën sponsorizimin e EMMI-së dhe EURIBOR ACI ose çdo pasues i atij funksioni të EMMI-së dhe EURIBOR ACI, siç përcaktohet nga Banka; dhe

ii. “normë ndërbankare londineze” nënkupton normën e interesit për depozitat në euro, për periudhën përkatëse, siç është publikuar në orën 11, ora e Brukselit apo në një orë të mëvonshme të pranueshme për Bankën në atë ditë (data e ricaktuar), e cila bie 2 (dy) ditë



të përshtatshme pune, para ditës së parë të periudhës përkatëse, në faqen e Reuters EURIBOR 01 ose në faqen e pasuesit të saj, ose, në mungesë të së cilës, me çdo mjet tjetër publikimi të zgjedhur për këtë qëllim nga Banka.

Nëse një normë e tillë ndërbankare londineze nuk është publikuar, Banka do të kërkojë zyrat kryesore të eurozonës së katër bankave të mëdha në eurozonë, të zgjedhur nga Banka, të japin kuotën e kursit në të cilën depozitat në euro, në një sasi të krahasueshme ofrohen nga secili prej tyre, rreth orës 11, ora e Brukselit, në datën e ricaktuar ndaj bankave kryesore në tregun ndërbankar të eurozonës, për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese. Nëse jepen të paktën 2 (dy) kuotime, norma për datën e ricaktuar do të jetë mesatarja aritmetike e kuotimeve.

Nëse jepen më pak se 2 (dy) kuotime sipas kërkesës, norma për datën e ricaktuar do të jetë mesatarja aritmetike e normave të kuotuar nga bankat kryesore në zonën euro, të përzgjedhur nga Banka, rreth orës 11, ora e Brukselit, dita që bie 2 (dy) ditë të përshtatshme pune pas datë së ricaktuar, për huat në euro në një sasi të krahasueshme me bankat evropiane kryesore për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese.

Nëse nuk ka norma të disponueshme, siç parashikohet më lart, EURIBOR-i do të jetë norma (e shprehur si përqindje në vit), e cila caktohet nga Banka si kosto gjithëpërfshirëse për Bankën për financimin e transhit përkatës, bazuar në normën e referencës së Bankës të gjeneruar brenda vendit ose një metodë alternative të përcaktimit të normës së përcaktuar në mënyrë të arsyeshme nga Banka.

B. TË PËRGJITHSHME

Për qëllimet e përkufizimeve të mësipërme:

a) të gjitha përqindjet që rezultojnë nga llogaritjet e përmendura në këtë skedul do të jenë të rrumbullakosura, nëse është e nevojshme, me një të njëmijtën e një pikë përqindjeje më të afërt, me gjysma të rrumbullakosura;

b) Banka do të informojë Huamarrësin pa vonesë për kuotimet e marra nga Banka;

c) nëse ndonjë nga dispozitat e mësipërme bëhet në kundërshtim me dispozitat e miratuara nën kujdesin e EMMI-s1 dhe EURIBOR ACI (ose ndonjë pasues të atij funksioni të EMMI-së

dhe EURIBOR ACI, siç përcaktohet nga Banka) në lidhje me EURIBOR-in, siç përcaktohet nga Banka në lidhje me EURIBOR-in,

Banka, me anë të njoftimit të Huamarrësit, mund të ndryshojë dispozitën për ta sjellë atë në përputhje me dispozitat e tjera të tilla.

Skeduli C

Forma e disbursimit oferta/pranimi (nenet B dhe C)

Për: Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Nga: Banka Europiane e Investimeve

Data:

Lënda: Oferta/pranimi disbursimi për Kontratën financiare ndërmjet Bankës Evropiane të Investimeve dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, e datës _____ (Kontrata financiare)

Titulli i Projektit: Fronti i Lumit Lana – Zhvillimi Urban

Numri Kontratës: </>Numri i veprimit: 2016–1020

Të nderuar zotërinj,

Ne i referohemi Kontratës financiare. Termat e përcaktuar në Kontratën financiare kanë të njëjtin kuptim kur përdoren në këtë dokument.

Në vijim të kërkesës suaj për ofertë të disbursimit nga Banka, në përputhje me nenin 1.2.D të Kontratës financiare, ne ju ofrojmë mundësimin e transhit të mëposhtëm:

a) shuma që do të disbursohet në euro:

b) data e planifikuar e disbursimit:

c) baza e interesit:

d) periodiciteti i pagesave të interesit:

e) datat e pagesës:

f) kushtet për shlyerjen e principalit:

g) datat e shlyerjes dhe datën e parë dhe të fundit të shlyerjes së transhit:

h) data e rivlerësimit/konvertimit të interesit:

i) norma fikse ose shtrirja, e zbatueshme deri në datën e rivlerësimit të interesit/konvertimit, nëse ka, ose deri në datën e maturimit.

Për ta bërë transhin të disponueshem sipas termave dhe kushteve të Kontratës financiare, Banka duhet të marrë një pranim disbursimi, në formën e një kopjeje të ofertës së disbursimit të nënshkruar, siç duhet në emrin tuaj, në numrin e



mëposhtëm të faksit [] ose me *e-mail* [] jo më vonë se afati i pranimi të disbursimit të [orës] orës së Luksemburgut në [data].

Pranimi i disbursimit, më poshtë, duhet të nënshkruhet nga një nënshkrues i autorizuar dhe duhet të plotësohet plotësisht, siç përcaktohet, për të përfshirë detajet e llogarisë së disbursimit.

Nëse nuk është pranuar në mënyrë të rregullt deri në orën e mësipërme, oferta e përfshirë në këtë dokument do të konsiderohet se është refuzuar dhe do të ndërpritet automatikisht.

Nëse e pranoi transhin, siç përshkruhet në këtë ofertë të disbursimit, të gjitha kushtet dhe afatet e lidhura me Kontratën e financimit do të zbatohen në veçanti në dispozitat e nenit 1.4.

Me respekt,

BANKA EUROPIANE E INVESTIMEVE

Ne pranojmë ofertën e mësipërme të disbursimit:

për dhe në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Data:

NJOFTIM I RËNDËSISHËM PËR HUAMARRËSIN:

DUKE SIGLUAR MË LART, JU KONFIRMONI SE LISTA E NËNSHKRUESVE TË AUTORIZUAR DHE LLOGARITË E DHËNA TE BANKA, JANË PËRDITËSUAR SIÇ DUHET, SIPAS RREGULLAVE PËRPARA PARAQITJES SË OFERTËS SË MËSIPËRME TË DISBURSIMIT NGA BANKA.

NË RAST SE NDONJË NËNSHKRUES APO LLOGARITË QË PARAQITEN NË KËTË PRANIM TË DISBURSIMIT NUK JANË PËRFSHIRË NË LISTËN E FUNDIT TË NËNSHKRUESVE TË AUTORIZUAR DHE TË LLOGARIVE TË MARRA NGA BANKA, OFERTA E DISBURSIMIT MË SIPËR DUHET TË KONSIDEROHET SI JO E BËRË.

Skeduli D

Rivlerësimi dhe konvertimi i normës së interesit

Nëse një datë rivlerësimi/konvertimi të interesit është përfshirë në ofertën e disbursimit për një transh, do të zbatohen dispozitat e mëposhtme.

A. Mekanizmat e rivlerësimit/konvertimit të interesit

Me marrjen e një kërkesë për rivlerësim /konvertim interesi, gjatë periudhës prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh dhe që mbaron 30 (tridhjetë) ditë para datës së rivlerësimit /konvertimit të interesit, Banka i dorëzon Huamarrësit një propozim për rivlerësim /konvertim interesi që përcakton:

a) normën fikse dhe/ose diferencën që do të zbatohet për kështu ose pjesën e tij të treguar në kërkesën për rivlerësim/konvertim të interesit sipas nenit 3.1; dhe

b) që norma e tillë do të zbatohet deri në datën e maturimit ose deri në datën e re të rivlerësimit/konvertimit të interesit, nëse ka, dhe ky interes paguhet çdo tre muaj, çdo gjashtë muaj ose mbi baza vjetore, në përputhje me nenin 3.1, në shumën të prapambetura në datat e caktuara të pagesës.

Huamarrësi mund të pranojë me shkrim një propozim për rivlerësimin/konvertimin e interesit deri në afatin e caktuar në të.

Çdo ndryshim i kësaj Kontrate të kërkuar nga Banka, në lidhje me këtë, do të kryhet me një marrëveshje që do të përfundojë jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës përkatëse të rivlerësimit/konvertimit.

Normat fikse dhe shtrirjet janë të disponueshme për periudha jo më pak se 4 (katër) vjet ose në mungesë të shlyerjes së principalit gjatë kësaj periudhe, jo më pak se 3 (tre) vjet.

B. Efektet e rivlerësimit/konvertimit të interesit

Nëse Huamarrësi pranon me shkrim një normë fikse ose një diferencë në lidhje me një propozim për rivlerësimin/konvertimin e interesit, Huamarrësi do të paguajë interes të llogaritur në datën e rivlerësimit /konvertimit të interesit dhe më pas në datat e caktuara të pagesës.



Para datës së rivlerësimit/konvertimit të interesit, dispozitat përkatëse të kësaj Kontrate dhe oferta e disbursimit dhe pranimi të disbursimit do të zbatohen për transhin në tërësinë e tij. Nga dhe duke përfshirë datën e rivlerësimit/konvertimit të interesit më tutje, dispozitat që përmbahen në propozimin e rivlerësimit/konvertimit të interesit në lidhje me normën e re fikse ose shtrirjen do të zbatohen në transhe (ose në ndonjë pjesë të tij, siç caktohet në kërkesën e rivlerësimit/konvertimit të interesit) deri në datën e re të rivlerësimit/konvertimit të interesave, nëse ka, ose deri në datën e maturimit.

C. Rishikimi/konvertimi i pjesshëm ose jo i interesave

Nëse Huamarrësi nuk paraqet një kërkesë për rivlerësim të interesit ose nuk pranon me shkrim propozimin e rivlerësimit/konvertimit të interesit për transhin ose nëse palët nuk arrijnë të bëjnë një ndryshim të kërkuar nga Banka në përputhje me paragrafin A më sipër, Huamarrësi do të paguajë transhin (ose një pjesë të tij, siç caktohet në kërkesën e rivlerësimit/konvertimit të interesit) në datën e rivlerësimit/konvertimit të interesit pa dëmshpërblim.

Në rast të një rivlerësimi/konvertimi të pjesshëm të interesit, Huamarrësi do të paguajë, pa asnjë dëmshpërblim, në datën e rivlerësimit/konvertimit të interesit çdo pjesë të transhit, i cili nuk është i mbuluar nga kërkesa për rivlerësim/konvertim të interesit dhe për këtë arsye nuk është subjekt rivlerësimit/konvertimit të interesit.

Skeduli E

Forma e certifikatës nga Huamarrësi (neni 1.4.C)

Për: Banka Europiane e Investimeve

Nga: Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë

Data:

Lënda: Certifikata për Kontratën financiare ndërmjet Bankës Europiane të Investimeve dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë e datës _____ (Kontrata financiare)

Titulli i Projektit: Shtrati i Lumit Lana – Zhvillimi Urban

Numri i Kontratës: </> Numri i veprimi:
2016–1020

Të nderuar zotërinj,

Termat e përcaktuar në Kontratën financiare kanë të njëjtin kuptim kur përdoren në këtë letër.

Për qëllimet e nenit 1.4 të Kontratës financiare, ne ju vërtetojmë si më poshtë:

a) nuk ka ndodhur ndonjë rast i parapagimit dhe vazhdon i parregulluar ose nuk është hequr dorë;

b) nuk është krijuar apo nuk ekziston asnjë garanci e tipit të ndaluar sipas nenit 7.4;

c) nuk ka pasur ndonjë ndryshim material në asnjë aspekt të Projektit ose në lidhje me të cilin ne jemi të detyruar të raportojmë sipas nenit 8.1, përveçse siç na është komunikuar më parë;

d) kemi fonde të mjaftueshme për të siguruar përfundimin në kohë dhe zbatimin e Projektit në përputhje me skedulin A.1;

e) asnjë ngjarje ose rrethanë që përbën ose me kalimin e kohës ose dhënien e njoftimit sipas Kontratës financiare, do të përbente një rast të mospagimit, i cili vazhdon i parregulluar ose nuk është hequr dorë;

f) asnjë proces gjyqësor, procedurë administrative arbitrazhi ose hetim nuk është aktual ose, sipas njohurisë sonë, është i mundshëm ose në pritje para çdo gjykate, organi arbitrazhi ose agjencie që ka rezultuar ose nëse është përcaktuar negativisht, mund të ndodhë që të rezultojë në një ndryshim material negativ, duke ekzistuar kundër nesh ose ndonjërit nga filialet tona, çdo gjykim ose vendim të papërmbyshur;

g) përfaqësimet dhe garancitë që duhet të bëhen ose përsëriten nga ne sipas nenit “b” janë të vërteta në të gjitha aspektet; dhe

h) nuk ka pasur ndryshime materiale negative, në krahasim me situatën në datën e Kontratës financiare.

Me respekt,

Për dhe në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë



LIGJ
Nr. 64/2019

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË GRANTIT NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS
EUROPIANE TË INVESTIMEVE PËR
PROJEKTIN “SHTRATI I LUMIT LANA –
ZHVILLIM URBAN”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 3.10.2019.

Numri i kontratës (FI N°) 87316
Numri i veprimt (Serapis N°) 2016-1020

**SHTRATI I LUMIT LANA –
ZHVILLIM URBAN**

**MARRËVESHJA E GRANTIT
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE
TË INVESTIMEVE**
Poznan, 5 korrik 2019

Kjo kontratë është lidhur ndërmjet:

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, znj. Anila Denaj, për llogari të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (“Marrësi”),

në njërën anë,

Bankës Evropiane të Investimeve, me seli në adresën: 100 Blvd. “Konrad Adenauer”, Luxembourg, L-2950 Luxembourg, përfaqësuar nga z. Luca Lazzaroli, Drejtor i Përgjithshëm dhe zëvendës drejtor i Operacioneve, dhe z. Alessandro Cagnato, këshilltar ligjor (“Banka”),

në anën tjetër.

Duke pasur parasysh se:

a) Në datën 5 korrik 2019, Marrësi dhe Banka kanë lidhur një kontratë financiare (“Kontrata Financiare”), në shumën deri në 8,000,000.00 euro (tetë milionë euro) (“Huaja EIB”) për të mbështetur, përmes Bashkisë të Tiranës (“Zbatuesi”), një projekt të zhvillimit urban të shtratit të lumit Lana (rreth 2 km) në qytetin e Tiranës, siç përshkruhet në shtojcën I (“Projekti”). Zbatuesi do të jetë përgjegjës për zbatimin e Projektit, me të gjithë mbështetjen e nevojshme nga dhe nën mbikëqyrjen e Marrësit.

b) Në lidhje me Projektin, Marrësi kërkoi mbështetjen e Bankës për të marrë fonde jo të rimbursueshme për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve të Projektit (“Granti”). Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është përcaktimi i termave dhe kushteve të Grantit për të mbështetur financiarisht dhe teknikisht Projektin.

c) Më 13 dhjetor 2016, Bordi i Drejtorëve të Bankës miratoi krijimin e fondit të iniciativës ekonomike (“Fondi ERI”), një mjet përmes të cilit burimet e donatorëve mund të kanalizohen në operacionet e pranueshme të zbatuara në



kuadër të Iniciativës për Elasticitet Ekonomik (“ERI”). ERI është një iniciativë e zhvilluar nga Banka në përgjigje të një kërkesë të Këshillit Evropian të BE-së për të mobilizuar financime shtesë në mbështetje të rritjes së qëndrueshme dhe kohezionit social në Lagjen Jugore të BE-së dhe rajoneve të Ballkanit Perëndimor.

d) Fondi ERI u krijua në përputhje me rregullat e zbatueshme për platformën multirajonale, me shumë kontribues dhe partneritete multisektoriale për fondet e vendosura nga Banka për të siguruar një kuadër ligjor gjithëpërfshirës për fondet e krijuara nga Banka për të menaxhuar kontributet e palëve të treta (“Rregullat e Platformës”).

e) Banka ka lidhur dhe mund të lidhë marrëveshje të mëtejshme me disa donatorë (“Kontribuesit e ERI”) për menaxhimin dhe zbatimin e kontributeve të tyre në Fondin ERI (“Marrëveshjet e Kontributit të ERI”), në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në përshkrimin e Fondit ERI, të bashkëlidhura si skeduli 2 i tyre (“Përshkrimi i Fondit ERI”).

f) Komiteti i Kontribuuesve të ERI-t ka miratuar mbështetjen e Grantit për të mbuluar një pjesë të kostove të Projektit me anë të një propozimi të hollësishëm financiar (“Propozimi financiar”).

g) Kjo Marrëveshje hyn në fuqi duke u bazuar në: i) Rregullat e platformës; ii) Marrëveshjet e Kontributit, dhe iii) Përshkrimi i Fondit ERI; dhe iv) Propozimi financiar.

h) Kostoja totale e investimit e Projektit të pranueshëm për bashkëfinancim nga Granti vlerësohet në 2,400,000 euro (dy milionë e katërqind mijë euro).

i) Më 5 shkurt 1998, Republika e Shqipërisë dhe Banka nënshkruan një Marrëveshje Kuadër që rregullon veprimtaritë e Bankës në Republikën e Shqipërisë (siç zëvendësohet ose rilidhet herë pas here, “Marrëveshja Kuadër”), e cila do të vazhdojë të jetë në fuqi dhe efekt të plotë gjatë gjithë afatit të kësaj Marrëveshjeje.

j) Përpunimi i të dhënave personale kryhet nga Banka në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm të Bashkimit Evropian për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga institucionet dhe organet e BE-së dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave.

Si rrjedhojë, është rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Interpretimi dhe përkufizimet

1.1 Referencat për nenet, paragrafët dhe anekset janë, përveç nëse përcaktohen shprehimisht ndryshe, referencat përkatësisht në nenet, paragrafët dhe anekset e kësaj Marrëveshjeje.

1.2 Përveç nëse përcaktohet ndryshe, termat e specifikuar në kontratën financiare do të kenë të njëjtin kuptim në këtë Marrëveshje.

Neni 2

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

2.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas konfirmimit nga Banka për Marrësin se ka marrë një kopje të certifikuar të Fletores Zyrtare të Republikës së Shqipërisë që publikon ligjin për ratifikimin e kësaj Marrëveshjeje nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë (“Hyrja në fuqi”).

2.2 Periudha e zbatimit të Projektit (“Periudha e zbatimit”) duhet të përfundojë në më të shpejtën nga: i) 31 dhjetor 2021 (“Data e përfundimit”); ose ii) datën e përfundimit të Fondit ERI, siç mund të vendoset në çdo kohë me një vendim të Komitetit të Kontribuuesve të Fondit ERI, me pëlqimin unanim të Kontribuuesve dhe miratimin e organeve drejtuese të Bankës, në përputhje me Rregullat e Platformës (“Data e përfundimit”).

Neni 3

Shuma e Grantit

3.1 Në bazë të marrjes së Bankës së të gjithë shumës së grantit nga Kontribuesit në pajtim me marrëveshjet e tyre të kontributeve dhe në varësi të Fondit ERI që ka burime të mjaftueshme, Banka merr përsipër t’i japë grantin Marrësit në një shumë deri në 2,400,000 euro (dy milionë e katërqind mijë euro) (“Shuma maksimale e grantit”). Shpenzimet e grantit nuk i nënshtrohen rregulloreve të kontrollit valutor dhe rregullave të kontrollit të Republikës së Shqipërisë.

3.2 Shuma përfundimtare e grantit do të vendoset si më poshtë:

a) shuma e grantit nuk mund të tejkalojë koston totale të vlerësuar të Projektit siç është specifikuar në pikën “h”; dhe



b) nëse kostot totale të investimit të Projektit në përfundim të tij janë më të ulëta se kostoja totale e vlerësuar e Projektit siç është specifikuar në deklarinimin “h”, granti mund të vlerësohet sipas investimit aktual të shkaktuar.

3.3 Zbatuesi pranon që shuma maksimale e grantit është një shumë maksimale e cila mund të reduktohet nga Banka, sipas gjykimit të saj, nga çdo shumë e nevojshme për të mbuluar, ndër të tjera, çdo kosto që është shkaktuar ose pësuar nga Banka për të financuar ose për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje duke përfshirë, por pa u kufizuar në menaxhimin nga Banka të Grantit (siç janë tarifat e menaxhimit të parashikuara sipas Rregullave të Platformës dhe në Përkrahimin e Fondit ERI, të ndryshuara herë pas here, dhe çdo kosto ose humbjet, duke përfshirë normat negative të interesit, të shkaktuara nga Banka si rezultat i investimit të grantit në Fondin Unik ose format e tjera të menaxhimit të thesarit të krijuara nga Banka).

Neni 4

Përdorimi i grantit

4.1 Marrësi dhe Zbatuesi duhet të përdorin grantin vetëm për qëllime të financimit të Projektit, siç përcaktohet në aneksin 1. Për shmangien e dyshimit, granti nuk do të përdoret për financimin e taksave, detyrimeve dhe pagesave që rrjedhin nga ose në lidhje me zbatimin e Projektit. Proporcionet/raportet dhe shumatat në lidhje me çdo burim të bashkëfinancimit të Projektit janë të përcaktuara në shtojcën 1 dhe Marrësi dhe Marrësi do të financojnë Projektin në përputhje me rrethanat.

4.2 Palët me këtë rast pranojnë dhe pranojnë që shuma e grantit para se të disbursohet tek Marrësi, do të kreditohet në një llogari të hapur dhe të mbajtur nga Banka në librat e saj në EUR (“Llogaria e grantit”). Marrësi pranon se: i) çdo humbje ose kosto e shkaktuara në lidhje me llogarinë e grantit, duke përfshirë si rezultat të aplikimit të normave të interesit negativ; ii) çdo tarifë të zbatueshme të ngarkuar nga Banka në Fondin ERI; dhe iii) çdo ngarkesë bankare në lidhje me mbajtjen e llogarisë së grantit do të jetë një humbje ose kosto për llogarinë e grantit dhe do të konsiderohet kosto e pranueshme e

mbuluar nga granti dhe zbritet nga llogaria e grantit.

Neni 5

Pagesa e grantit

5.1 Banka do të transferojë grantin në një llogari të Marrësit (“Llogaria e Projektit”), e ndarë nga çdo aset tjetër i Marrësit, të shprehur në euro dhe nga të cilat pagesat e llogarisë do të kryhen vetëm për qëllim të zbatimit të Projektit dhe që do t'i njoftohen Bankës në ose para datës që rezulton 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune para datës së planifikuar të pagesës sipas nenit 5 (3) (a). Pagesat do të bëhen në euro.

5.2 Pagesat e grantit janë të kushtëzuara me përmbushjen e kushteve të përcaktuara në këtë nen 5 (2).

a) Pagesa e parë kushtëzohet nga kushtet e mëposhtme, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën:

i. marrjen nga Banka të një opinionit të brendshëm në gjuhën angleze në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën sipas ligjit shqiptar, ndër të tjera, për nënshkrimin e duhur, ligjshmërinë, vlefshmërinë, natyrën detyruese dhe zbatueshmërinë (për shmangien e dyshimit, duke përfshirë zgjedhjen e klauzolave të ligjit dhe të juridiksionit) të kësaj Marrëveshjeje në lidhje me Marrësin dhe Zbatuesin, si dhe konstatimin e duhur, ekzistencën dhe kapacitetin e vlefshëm dhe autorizimin e duhur të Marrësit dhe Zbatuesit për të lidhur këtë Marrëveshje. Ky opinion duhet të mbështetet nga dokumentet përkatëse që vërtetojnë miratimin dhe autorizimin e Marrësit dhe Zbatuesit për të lidhur këtë Marrëveshje, duke përfshirë dëshminë se çdo person që nënshkruan Marrëveshjen në emër të Promovuesit dhe Marrësit është i autorizuar për ta bërë këtë së bashku me nënshkrimin e secilit person apo personave të tillë;

ii. marrja e një kërkesë pagese kryesisht në formën e aneksit II (“Kërkesa e pagesës”) nga Banka nga Zbatuesi në ose para datës që rezulton 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune para datës së planifikuar të pagesës të specifikuar në kërkesën e pagesës, të shoqëruar me dëshmi të autoritetit të personit ose personave të autorizuar për ta nënshkruar atë në emër të Marrësit dhe nënshkrimin e këtij personi ose personave;



iii. marrja nga Banka në ose para datës që rezulton të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune para datës së planifikuar të pagesës sipas nenit 5(3)(a) të shumës së grantit, që do të transferohen nga kontribuesit tek Banka në përputhje me marrëveshjet e kontributeve;

iv. Zbatuesi i ka dhënë Bankës një vërtetim të nënshkruar nga një përfaqësues ligjor i Zbatuesit dhe duke konfirmuar se janë plotësuar kushtet e specifikuara në nenin 9; dhe

v. kushtet e mëparshme specifike në nenin 1.4 (B) të kontratës financiare janë përmbushur sipas Bankës

b) Pagesat që pasojnë të parat janë të kushtëzuara nga:

i. marrja e një kërkesë pagese nga Banka nga Zbatuesi në ose para datës që rezulton 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune para datës së caktuar të pagesës të specifikuar në kërkesën e pagesës, të shoqëruar me dëshmi të autoritetit të personit ose personave të autorizuar për ta nënshkruar atë në emër të Marrësit dhe nënshkrimit të këtij personi ose personash, përveç nëse një dëshmi e tillë e autoritetit nënshkruar dhe nënshkrimi i modelit të nënshkrimit tashmë janë siguruar në pajtim me nenin 5(2)(a)(ii) dhe nuk kanë ndryshuar (për shmangien e dyshimit, nëse Marrësi nuk paraqet dëshmi të tillë të autoritetit të nënshkrimit dhe nënshkrimit të modelit të nënshkrimit në lidhje me një disbursim të ri, në të njëjtën kohë me kërkesën përkatëse të pagesës, Banka ka të drejtë të supozojë se dëshmitë e paraqitura më parë të autoritetit të nënshkrimit dhe nënshkrimit të modeleve të nënshkrimit vazhdojnë të jenë të zbatueshme dhe të vlefshme).

ii. marrja e dokumenteve nga Zbatuesi në emër dhe për llogari të Marrësit, duke evidentuar, në një mënyrë të kënaqshme për Bankën, (I) se Zbatuesi ka kryer shpenzime në kostot e pranueshme lidhur me Projektin sipas nenit 9 në një shumë të paktën të barabartë me totalin e: i) [80]% (tetëdhjetë për qind) të shumës së pagesës së mëparshme të menjëhershme; ii) 100% (njëqind për qind) të shumave të të gjitha pagesave të mëparshme, nëse ka, dhe (II) kursi i këmbimit valutor që ishte aplikuar dhe komercialisht në dispozicion të Zbatuesit, në kohën e konvertimit në EUR të çdo shpenzimi të tillë;

iii. Zbatuesi në emër dhe për llogari të Marrësit i ka dhënë Bankës një vërtetim të nënshkruar nga një përfaqësues ligjor i Marrësit dhe duke konfirmuar se janë plotësuar kushtet e specifikuara në nenin 9; dhe

iv. Banka, duke u bindur se kredia e EIB-së nuk është anuluar dhe se Marrësi ka të drejtë të vazhdojë të tërheqë ose të mbajë kredi sipas kontratës financiare.

5.3 Pagesat e grantit do të kryhen si më poshtë:

a) Në varësi të përmbushjes së kushteve të përcaktuara në nenin 3(1) dhe 5(2), Banka do të transferojë në llogarinë e Projektit të përcaktuar në nenin 5(1) shumën e specifikuar në kërkesën përkatëse të pagesës brenda [15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune] nga marrja e kësaj kërkesë për pagesë;

b) Në varësi të aneksit I, çdo pagesë përveç pagesës së fundit, do të mbulojë 100% (njëqind për qind) të fondeve të grantit që parashikohet të disbursohen për 12 (dymbëdhjetë) muajt e ardhshëm nga data e kërkesës së pagesës siç caktohet në raportin e fundit të progresit, siç përcaktohet në nenin 10(1);

c) Shuma përfundimtare e grantit do të disbursohet maksimumi deri në datën e përfundimit.

5.4 Pa cenuar të drejtën e saj për të ndërprerë këtë Marrëveshje në pajtim me nenin 15, Banka mund të pezullojë ose anulojë një pagesë në rast se Marrësi nuk kryen ndonjë rol të caktuar ndaj tij sipas kësaj Marrëveshjeje ose nuk përmbush ndonjë nga detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje ose kontratës financiare dhe kjo pamundësi ka vazhduar për një periudhë prej [15 (pesëmbëdhjetë) ditësh] pasi njoftimi me shkrim i është dhënë Marrësit nga Banka.

Neni 6

Angazhimet, përfaqësitë dhe garancitë e Marrësit

6.1 Përfundimi i Projektit

Marrësi do të sigurojë që Zbatuesi të realizojë Projektin në përputhje me përshkrimin teknik, që mund të modifikohet herë pas here me miratimin e Bankës dhe ta plotësojë atë deri në datën përfundimtare të specifikuar aty.



6.2 Ndërmarrjet e vazhdueshme të projektit
Marrësi do të sigurojë që Zbatuesi, do të:

a) Mirëmbajtja: mirëmbajtje, riparime, kontrollojë dhe rinovojë të gjithë pronën, pjesë të Projektit, siç kërkohej për ta mbajtur atë në gjendje të mirë pune;

b) Asetet e projektit: përveç nëse Banka ka dhënë pëlqimin paraprak me shkrim, mban titullin dhe zotërimin e të gjitha ose kryesisht të gjitha mjeteve që përbëjnë Projektin ose, sipas rastit, zëvendësojnë dhe rinovojnë këto asete dhe mbajnë Projektin në një veprim kryesisht të vazhdueshëm në përputhje me qëllimin e tij fillestar; Banka mund të refuzojë pëlqimin e saj vetëm kur veprimi i propozuar do të cenonte interesat e Bankës si financues ndaj Marrësit ose do ta bënte Projektin të papërshtatshëm për financim nga Banka në bazë të Statutit të tij ose sipas nenit 309 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian.

c) Sigurimi: Sigurimi i të gjitha punëve dhe pronave që janë pjesë e projektit me shoqëritë e sigurimit të klasit të parë në përputhje me praktikën më gjithëpërfshirëse të industrisë;

d) Të drejtat dhe lejet: të mbajë në fuqi të gjitha të drejtat e kalimit ose të përdorimit dhe të gjitha autorizimet e nevojshme për ekzekutimin dhe funksionimin e Projektit;

e) Informacioni mjedisor dhe social:

i) të zbatojë dhe të operojë Projektin në përputhje me Standardet Mjedisore dhe Sociale (siç përcaktohet në kontratën financiare), duke përfshirë:

1. Të sigurojë që çdo masë mjedisore dhe sociale për zbutjen dhe kompensimin të zbatohet në përputhje me dokumentet mjedisore dhe sociale dhe planin e veprimit social (siç përcaktohet në kontratën financiare) dhe menjëherë të njoftojë Bankën për çdo ndikim mjedisor ose social që mund të ndodhë gjatë zbatimit;

2. Nuk do të fillojë asnjë rivendosje përpara se të arrihet marrëveshja e Bankës me RAP përkatëse;

3. Të sigurojë që punimet fizike në zonën e prekur do fillojnë vetëm pasi kompensimi i PAP-së të ketë përfunduar;

4. Të vërë mekanizmin e ankesave në dispozicion për të gjithë personelin e Projektit, duke përfshirë kontraktuesit dhe nënkontraktuesit;

5. Të sigurojë përfshirjen e kërkesave në lidhje me menaxhimin e aspekteve mjedisore dhe sociale të punimeve kontraktuese, në përputhje

me ligjin për mjedisin dhe shoqërinë (siç përcaktohet në kontratën financiare), në dokumentet e tenderit dhe marrëveshjet e mëvonshme me kontraktuesit e përzgjedhur;

6. Të monitorojë periodikisht përputhjen e kontraktuesve me standardet e punës

ii) të marrë, të mirëmbajë dhe të pajtohet me miratimet mjedisore ose sociale për kërkesat e Projektit (siç përcaktohet në kontratën financiare);

f) Ligji i BE-së: ekzekutimi dhe operimi i projektit në përputhje me ligjet përkatëse të Republikës së Shqipërisë dhe standardet përkatëse të së drejtës së BE-së, përveç për çdo derogim të përgjithshëm të bërë nga Bashkimi Evropian.

6.3 Angazhime të tjera

Marrësi do të sigurojë që Zbatuesi:

a) të mirëmbajë një NJZP (siç përcaktohet në kontratën financiare) me termat e referencës, stafin, burimet, të gjitha sipas kërkesave të Bankës;

b) të ketë një mekanizëm efektiv të korigjimit që siguron procedurat e shqyrtimit të pranueshme për Bankën dhe t'i vendosë në dispozicion të çdo personi ose enti që ka ose ka pasur interes në marrjen e një kontrate të financuar nga EIB-ja dhe (në rrezik të) dëmtimit nga një shkelje e dyshuar e rregullave të prokurimit në fuqi. Mekanizmi i mësipërm do të jetë sipas kërkesave të Bankës dhe disponueshmëria e saj do t'i konfirmohet Bankës para fillimit të procesit të parë të prokurimit;

c) të sigurojë që dokumentet e tenderit për të gjitha kontratat që do të financohen nga Banka do të përfshijnë një referencë në mekanizmin e lartpërmendur, efektiv për shqyrtimin e ankesave lidhur me procesin e prokurimit;

d) të informojë menjëherë Bankën për çdo ndryshim në planin fillestar të prokurimit;

e) të konsultohet me Bankën lidhur me ndryshimin e kontratave të financuara nga EIB-ja dhe të kërkojë moskundërshtimin e Bankës para se të hyjë në ndonjë ndryshim material në këto kontrata;

f) të sigurojë që auditimet e sigurisë rrugore të kryhen në përputhje me parimet e direktivës së sigurisë rrugore 2008/96/EC dhe t'i ofrohen Bankës së bashku me tabelat përmbledhëse, me konfirmimin e Marrësit se rekomandimet do të



zbatohen ose – për masat që nuk mund të zbatohen – arsyetim për përjashtimin e tyre. Gjithashtu, do të përfshihet vlerësimi i aksesueshmërisë dhe sigurisë së këmbësorëve për të identifikuar nevojat dhe rreziqet për këmbësorët në veçanti.

6.4 Integriteti

6.4.1 Sjellja e ndaluar

a) Marrësi do të sigurojë që Zbatuesi nuk do të angazhohet (dhe nuk do të autorizojë ose lejojë asnjë filial ose person tjetër që vepron në emër të tij për t'u angazhuar) në ndonjë procedurë të ndaluar (siç përcaktohet në kontratën financiare) në lidhje me Projektin, ose çdo transaksion të parashikuar nga kontrata, çdo procedurë tenderimi për Projektin ose çdo transaksion të parashikuar nga kontrata.

b) Marrësi merr përsipër të marrë dhe të sigurojë që Zbatuesi ndërmerr një veprim të tillë që Banka do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të hetuar ose përfunduar çdo rast të supozuar ose të dyshuar të çdo sjelljeje të ndaluar në lidhje me Projektin.

c) Marrësi merr përsipër dhe siguron që Zbatuesi të sigurojë që kontratat e financuara nga ky grant përfshijnë dispozitat e nevojshme për të mundësuar Marrësin dhe/ose të hetojë ose të përfundojë çdo rast të pretenduar ose të dyshuar të ndonjë sjelljeje të ndaluar (siç përcaktohet në kontratën financiare) në lidhje me Projektin.

6.4.2 Sanksionet

Marrësi do të sigurojë që Zbatuesi nuk do të:

a) hyjë në një marrëdhënie biznesi me ndonjë person të sanksionuar (siç përcaktohet në kontratën financiare); ose

b) vendosë çdo fond në dispozicion ose interes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, për çdo person të sanksionuar (siç përcaktohet në kontratën financiare).

6.4.3 Menaxhimi i Marrësit dhe Zbatuesit

Marrësi merr përsipër të marrë dhe të sigurojë se Zbatuesi do të marrë brenda një afati të arsyeshëm masat e duhura deri në masën e lejuar nga ligji i zbatueshëm në lidhje me çdo anëtar të organeve të tyre, i cili:

a) bëhet person i sanksionuar (siç përcaktohet në kontratën financiare); ose

b) është objekt i një vendimi të formës së prerë dhe të parevokueshëm të gjykatës në lidhje me sjelljen e ndaluar (siç përcaktohet në

kontratën financiare) të kryer gjatë ushtrimit të detyrave të tyre profesionale,

në mënyrë që të sigurojë se një anëtar i tillë pezullohet, shkarkohet ose në çdo rast të jetë i përjashtuar nga çdo aktivitet i Marrësit në lidhje me grantin dhe Projektin.

6.5 Informacioni në lidhje me Marrësin

Marrësi duhet të informojë menjëherë Bankën, për:

i. çdo fakt që e detyron atë të parapaguajë ndonjë borxh financiar ose financim të Bashkimit Evropian;

ii. çdo rast ose vendim që përbën ose mund të rezultojë në një rast të parapagimit;

iii. çdo qëllim nga ana e tij për heqjen dorë nga pronësia të çdo komponenti material të Projektit;

iv. çdo fakt apo rast që ka mundësi të mjaftueshme për të parandaluar përmbushjen e çdo detyrimi të Marrësit sipas kësaj kontrate;

v. çdo rast të mospërmbushje detyrimi të ndodhur ose që mund të ndodhë ose është parashikuar;

vi. çdo fakt apo rast që rezulton në:

1. çdo anëtar të organeve të tij drejtuese; ose

2. çdo njësi kontrolluese që është person i sanksionuar;

vii. në masën e lejuar me ligj, çdo proces gjyqësor, arbitrazhi, procedurë administrative ose hetim i kryer nga një gjykatë, administratë ose autoritet i ngjashëm publik, i cili, në interes të njohurive dhe besimeve të tij, është i tanishëm, i afërt ose i pazgjidhur ende nga Marrësi ose subjektet e tij kontrolluese ose anëtarët e organeve drejtuese të Marrësit në lidhje me administrimin e ndaluar (siç përcaktohet në kontratën financiare) lidhur me Grantin ose Projektin;

viii. çdo masë e marrë nga Marrësi në lidhje me nenin 6.9 të kësaj kontrate;

ix. çdo proces gjyqësor, arbitrazhi ose administrativ ose hetim, i cili është i tanishëm, i afërt ose në pritje dhe i cili, nëse përcaktohet në mënyrë të kundërt, do të rezultojë në një ndryshim material negativ (siç përcaktohet në kontratën financiare).



Neni 7

Pronësia dhe të drejtat e pronësisë intelektuale

7.1 Asetet, pajisjet dhe mallrat e tjera të paguara nga granti do të jenë pronë e Marrësit, i cili duhet të mbajë dëshmi dokumentare të kësaj pronësie për verifikim.

7.2 Pronësia, titulli dhe të drejtat industriale dhe intelektuale të pronësisë në rezultatet e zbatimit të Projektit dhe raportet dhe dokumentet e tjera që lidhen me të, do t'i jepen Marrësit ose siç mund të bien dakord ndryshe ndërmjet Bankës dhe Marrësit. Marrësi do të sigurojë që çdo palë tjetër, duke përfshirë secilën nga bankat dhe kontribuesit në Fondin ERI, të ketë të drejtën të përdorë pa pagesë dhe sipas nevojës të gjitha raportet dhe dokumentet e përgatitura në lidhje me zbatimin e Projektit, cilado qoftë forma e tyre, me kusht që të mos shkelë të drejtat ekzistuese industriale dhe intelektuale të pronësisë.

Neni 8

Prokurimi i mallrave, punëve dhe shërbimeve

8.1 Neni 6.4 (Procedura e prokurimit) e kontratës financiare do të zbatohet *mutatis mutandis* për këtë Marrëveshje.

Neni 9

Kostot e pranueshme

9.1 Për t'u konsideruar si pagesë e pranueshme e kostove sipas këtij granti, shpenzimet e mbuluara nga kërkesat e pagesës të dorëzuara nga Zbatuesi në emër dhe për llogari të Marrësit sipas nenit 5 duhet të:

a) jenë të nevojshme për realizimin e Projektit, të parashikohen në këtë Marrëveshje dhe të jenë në pajtim me parimin e menaxhimit të saktë financiar, në veçanti vlera për para dhe kosto-efektivitet;

b) kenë ndodhur në të vërtetë midis datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe përfundimit të Periudhës së Zbatimit, pavarësisht nga koha e disbursimit aktual nga Banka; dhe

c) regjistrohen në llogaritë e Marrësit, të jenë të identifikueshme, të mbështetura nga origjinalet

e provave mbështetëse (siç mund të jetë rasti në formë elektronike) dhe të verifikueshme në përputhje me dispozitat e nenit 10.

Për shmangien e dyshimit, kostoja e jashtme që ka të bëjë me zbatimin e Projektit si auditimi do të konsiderohet si shpenzim i pranueshëm dhe do të paguhet nga Marrësi.

Neni 10

Raportimi dhe vlerësimi

10.1 Zbatuesi, në emër dhe llogari të Marrësit, do të informojë Bankën pa vonesë për çdo rrethanë që mund të pengojë ose vonojë zbatimin e Projektit dhe do të informojë Bankën rregullisht dhe të paktën gjashtë herë në vit për progresin në zbatimin e projektit.

10.2 Zbatuesi, në emër dhe llogari të Marrësit, duhet t'i paraqesë Bankës çdo gjashtë muaj jo më vonë se data 31 korrik dhe 31 janar të çdo viti, duke filluar nga data 31 korrik 2019 deri në përfundimin e projektit, një raport mbi zbatimin e projektit, siç përshkruhet më mirë në kontratën financiare ("Raportet e Zbatimit").

10.3 Zbatuesi, në emër dhe llogari të Marrësit, do të ofrojë çdo vit një pasqyrë financiare të audituar nga jashtë për vitin kalendarik të mëparshëm. Deklarimi i tillë financiar duhet të auditohet nga një auditues i jashtëm i pranueshëm nga Banka dhe do të dorëzohet jo më vonë se data [31 janar] çdo vit. Për shmangien e dyshimit, shpenzimet e jashtme që lidhen me auditimin do të paguhet nga Marrësi dhe Marrësi nga të ardhurat e grantit dhe do të konsiderohen si kosto të pranueshme sipas grantit në përputhje me nenin 9.

10.4 Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) muajve nga data e përfundimit, Zbatuesi do të paraqesë në Bankë një raport përfundimtar që mbulon periudhën e plotë të zbatimit të projektit dhe shfrytëzimin e grantit ("Raporti përfundimtar"). Raporti Vjetor i Zbatimit dhe Raporti Përfundimtar duhet të hartohen në anglisht, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën dhe informacioni financiar do të konsolidohet në EURO. Raporti Përfundimtar do të japë një përshkrim të detajuar të aktiviteteve të kryera, rezultateve dhe ndikimit të Projektit që mbulon të gjithë periudhën e Zbatimit.



10.5 Përveç raporteve të mësipërme, Banka, në çdo kohë, mund të kërkojë me shkrim informacion shtesë nga Zbatuesi në emër dhe për llogari të Marrësit në lidhje me zbatimin e Projektit, i cili duhet të ofrohet nga Zbatuesi në emër dhe për llogari të Marrësit brenda [pesëmbëdhjetë (10)] ditësh pune nga një kërkesë e tillë.

10.6 Nëse Banka kryen një vlerësim të grantit, Marrësi dhe Zbatuesi do të sigurojnë përfaqësuesit e Bankës ose personat e autorizuar nga kjo e fundit për çdo dokument ose informacion që do të ndihmojë me vlerësimin dhe do t'u japë atyre të drejtat e aksesit të specifikuar në nenin 11.

Neni 11

Vizitat, të drejtat e aksesit dhe hetimet

11.1 Neni 8.3 (Vizitat, të drejtat e aksesit dhe hetimet) e kontratës financiare do të zbatohen, *mutatis mutandis*, për këtë Marrëveshje.

11.2 Marrësi dhe Zbatuesi pranojnë se Banka mund të jetë e detyruar të komunikojë informacionin në lidhje me Marrësin, Zbatuesin dhe Projektin të Kontribuesit në Fondin ERI siç janë të nevojshme për kryerjen e detyrës së tyre në përputhje me ligjet në fuqi.

Neni 12

Shlyerja e grantit

12.1 Kur Projekti pezullohet, nuk zbatohet ose nuk kryhet siç duhet dhe pa cenuar të drejtën e tij për të ndërprerë këtë Marrëveshje sipas nenit 15, Banka mund të kërkojë kthimin e shumës së përgjithshme të grantit ose të zvogëlojë grantin proporcionalisht për zbatimin aktual të Projektit.

12.2 Nëse ndonjë pjesë e grantit bëhet e shlyeshme në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, Marrësi dhe Zbatuesi duhet të kthejnë të gjithë ose një pjesë të grantit menjëherë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve ose çdo ditë tjetër të rënë dakord nga Palët, me kërkesën me shkrim nga Banka në përputhje me dispozitat e mëposhtme.

12.3 Nëse Projekti nuk përfundon brenda periudhës së zbatimit, çdo fond që mbetet i pashpenzuar do t'i rimbursohet Bankës.

12.4 Në rast se granti nuk përdoret në

përputhje me: i) procedurat dhe kushtet e përshkruara këtu; dhe ii) specifikimet e Projektit të përcaktuara në shtojcën I, Banka do të ketë të drejtën të rimarrë nga Marrësi dhe Zbatuesi pjesën e grantit mbi vlerën e fondeve të paguara gabimisht ose të përdorura gabimisht në Projekt.

12.5 Nëse granti nuk i vihet në dispozicion Zbatuesit brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e pagesës së parë të Bankës ndaj Marrësit sipas kësaj Marrëveshjeje, Banka mund të kërkojë kthimin e shumës totale të grantit të shpërndarë deri tani.

12.6 Çdo shumë e grantit e papërdorur, e rikuperuar ose e kthyer do të kthehen nga Marrësi te Banka brenda 30 ditëve nga marrja e njohurive për shumën të tilla të papërdorura, të rikuperuara ose të kthyera, por jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të Periudhës së Zbatimit.

12.7 Çdo shumë e paguar padrejtësisht ose e papërdorur ose e keqpërdorur nga Marrësi ose Zbatuesi dhe i kthyer Bankës do të shprehet në euro dhe është e barabartë me shumën korresponduese të shprehur në euro fillimisht të paguar nga Banka për Marrësin.

12.8 Nëse Marrësi ose Zbatuesi nuk i paguan të gjitha ose një pjesë të grantit deri në datën e caktuar, shumën e detyruar do të mbajë interes në normën e aplikuar nga Banka Qendrore Evropiane në operacionet kryesore të rifinancimit, siç është publikuar në serinë C të Gazetës Zyrtare të Bashkimit Evropian në ditën e parë të muajit në të cilin duhet kryer pagesa, u rrit me tre pikë e gjysmë përqindjeje. Interesi do të paguhet për periudhën që kalon nga dita pas skadimit të afatit të pagesës deri në ditën e pagesës. Çdo pagesë e pjesshme fillimisht mbulon interesin.

12.9 Pagesat bankare të kryera nga shlyerja e shumave ndaj Bankës do të mbulohen tërësisht nga Marrësi.

Neni 13

Konfliktet dhe interesat

13.1 Marrësi dhe Zbatuesi marrin përsipër të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për parandalimin, zbutjen ose përfundimin e ndonjë konflikti të interesave që rrjedhin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje. Ekziston një konflikt interesi ku ushtrimi i paanshëm dhe objektiv i



funksioneve të cilitdo person në lidhje me Projektin është komprometuar për çfarëdo arsye. Marrësi dhe Zbatuesi do të informojnë Bankën pa vonesë për çdo situatë që përbën ose që mund të çojë në ndonjë konflikt të tillë.

13.2 Banka rezervon të drejtën për të verifikuar që çdo masë e vendosur nga Marrësi dhe Zbatuesi për të parandaluar, zbutur ose përfunduar konfliktet e interesit është e mjaftueshme dhe mund të kërkojë të merren masa shtesë, nëse është e nevojshme.

Neni 14

Pezullimi i kësaj Marrëveshjeje

14.1 Banka mund të pezullojë të gjitha ose një pjesë të kësaj Marrëveshjeje nëse në rrethana të arsyeshme, sipas mendimit të saj, përjashton zbatimin efikas dhe të sigurt të Projektit. Ajo do të informojë Marrësin e saj pa vonesë. Çdo pezullim i tillë do të vazhdojë derisa Banka të përfundojë pezullimin ose të ndërpresë Marrëveshjen. Nëse kjo Marrëveshje nuk ndërpritet, Banka do të përpiqet të minimizojë kohëzgjatjen e pezullimit dhe mund të rifillojë zbatimin e Projektit sapo të lejojnë kushtet dhe do të informojë Marrësin në përputhje me rrethanat.

14.2 Periudha e Zbatimit zgjatet automatikisht për një kohë të barabartë me kohëzgjatjen e pezullimit. Kjo nuk cenon ndonjë ndryshim të kësaj Marrëveshjeje që mund të jetë i nevojshëm për të përshtatur Projektin me kushtet e reja të zbatimit.

14.3 Asnjë zhdëmtim nuk do të paguhet pas pezullimit ose ndërprerjes nga Banka në përputhje me këtë nen.

Neni 15

Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje

15.1 Nëse një Palë çmon se qëllimet e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të kryhen në mënyrë efektive apo të përshtatshme, ai do të konsultohet me Palën tjetër. Në mungesë të marrëveshjes për zgjidhjen, çdo Palë mund ta përfundojë këtë Marrëveshje duke i drejtuar një njoftim me shkrim 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike Palës tjetër.

15.2 Nëse për çfarëdo arsye, Fondi ERI ose kontrata financiare ndërpritet ose pushon së qeni i vlefshëm dhe në fuqi të plotë, Banka rezervon të drejtën, pasi i dërgon Marrësit një njoftim me shkrim prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike ta ndërpresë këtë Marrëveshje dhe ta informojë Marrësin për kushtet e një ndërprerjeje të tillë pa ndonjë përgjegjësi për Bankën.

15.3 Përveç ndonjë shkakut tjetër për ndërprerjen e parashikuar në këtë Marrëveshje, Banka mund ta përfundojë këtë Marrëveshje pas njoftimit me shkrim prej 7 (shtatë) ditësh kalendarike të Marrësi, kur:

a) Marrësi ose Zbatuesi nuk e kanë njoftuar Bankën për ndonjë situatë që shkakton konflikt interesi me pasojë negative për Projektin dhe rezultatet e pritshme të tyre;

b) Marrësi ose Zbatuesi ka transferuar ose caktuar këtë Marrëveshje ose grant për një palë të tretë në çfarëdo mënyre, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës;

c) Nëse ndonjë informacion ose dokument i dhënë Bankës nga ose në emër të Marrësit ose Zbatuesit ose ndonjë përfaqësim ose deklaratë të bërë ose që konsiderohet se është bërë nga Marrësi ose Zbatuesi në këtë Marrëveshje ose në lidhje me negocimin e kësaj Marrëveshjeje është ose dëshmon se ka qenë e pasaktë ose mashtruese në çfarëdo aspekti material;

d) Marrësi ose Zbatuesi ofrojnë raporte që nuk pasqyrojnë realitetin, me qëllim të marrjes së grantit të parashikuar në këtë Marrëveshje;

e) Marrësi ose Zbatuesi kryejnë parregullsi të qëllimshme financiare;

f) Marrësi ose Zbatuesi i nënshtrohen ndryshimeve ligjore, financiare, teknike ose organizative që mund të ndikojnë kryesisht në këtë Marrëveshje;

g) Mospërbushja e Marrësit në kryerjen e ndonjë detyrimi në lidhje me ndonjë kredi, grant ose instrument financiar të dhënë nga Banka;

h) Nëse Marrësi ose Zbatuesi nuk përmbush detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 16

Ndryshimi

Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje do të bëhet me shkrim dhe do të nënshkruhet nga palët në këtë dokument. Ministri i Financave dhe



Ekonomisë i Republikës së Shqipërisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim, i cili duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. Ndryshimet e kësaj Kontrate që prekin vetëm afatet e disbursimit nuk do të kërkojnë miratimin paraprak nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.

Neni 17

Ligji rregullues dhe juridiksioni

17.1 Kjo Marrëveshje do të qeveriset nga ligjet e Luksemburgut.

17.2 Çdo mosmarrëveshje, pretendim, ndryshim ose kundërthënie që rrjedh nga, që lidhet ose ka ndonjë lidhje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë çdo mosmarrëveshje për ekzistencën, vlefshmërinë, interpretimin, performancën, shkeljen ose ndërprerjen e saj ose pasojat e pavlefshmërisë së saj dhe çdo mosmarrëveshje që lidhet me çdo detyrim jo kontraktual që rrjedh nga ose në lidhje me të, duhet të paraqitet nën juridiksionin e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian.

Neni 18

Njoftimet dhe komunikimet

18.1 Çdo njoftim ose komunikim tjetër që do të dërgohet sipas kësaj Marrëveshjeje duhet të jetë me shkrim dhe duhet të përcaktojë kodin e identifikimit (“FI N° [...]”) dhe titullin (“RIZHVILLIMI URBAN I SHTRATIT TË LUMIT LANA”) e kësaj Marrëveshjeje.

18.2 Çdo njoftim ose dokument i dhënë në ose në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të jetë në gjuhën angleze, ose nëse nuk shoqërohet me përkthimin e tij zyrtar të gjuhës angleze dhe në këtë rast përkthimi në anglisht do të ketë përparësi, përveç nëse dokumenti është zyrtar kushtetues, statutor ose dokument zyrtar tjetër të ngjashëm.

18.3 Me përjashtim të njoftimeve që lidhen me çështje gjyqësore, qoftë nëse janë në pritje ose të mundshme, të cilat duhet të dërgohen në adresat e specifikuar më poshtë, ekskluzivisht me postë përmes letrës zyrtare me konfirmim të pranimit, të gjitha njoftimet dhe korrespondenca në lidhje me këtë Marrëveshje do të dërgohen me postë, faks ose në masën e rënë dakord nga Palët

me shkrim, me postë elektronike ose me mjete të tjera të komunikimit elektronik, në adresat e mëposhtme:

Për Bankën:

Në vëmendje: OPS/MA-3 PUB SEC (SI,HR,WBs)

100 boulevard “Konrad Adenauer”

L-2950 Luxembourg

Faks nr.: +352 4379 58417

Adresa e e-mail-it:

OPS_MA-3_SecDiv@eib.org

Për Marrësin:

Në vëmendje: Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”

Republika e Shqipërisë

Adresa e e-mail-it:
sekretariamin@finance.gov.al

18.4 Çdo ndryshim i bërë në detajet e mësipërme të komunikimit do të ketë efekt vetëm pasi të jetë njoftuar me shkrim në letër ose në formë elektronike Palës tjetër në adresat e mësipërme.

18.5 Njoftimet dhe komunikimet e tjera konsiderohen se janë bërë kur të jenë marrë nga Pala pritëse.

Neni 20

Marrëveshja e plotë

Kjo Marrëveshje përbën një deklaratë të plotë dhe ekskluzive të kushteve të marrëveshjes midis Palëve lidhur me çështjen e saj, dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme ndërmjet Palëve, qoftë të shprehura apo të nënkuptuara, në lidhje me të njëjtën çështje.

Neni 21

Pavlefshmëria

Nëse në çdo kohë ndonjë term i kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet i paligjshëm, i pavlefshëm ose i pazbatueshëm në ndonjë aspekt, ose kjo Marrëveshje është ose bëhet e paefektshme në ndonjë aspekt, sipas ligjeve të çdo juridiksioni, kjo paligjshmëri, pavlefshmëri, pazbatueshmëri ose joefektivitet nuk do të ndikojë në:



a) ligjshmërinë, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë në atë juridiksion të çdo afati tjetër të kësaj Marrëveshjeje ose efektivitetin në çdo aspekt tjetër të kësaj Marrëveshjeje në atë juridiksion; ose

b) ligjshmëria, vlefshmëria ose zbatueshmëria në juridiksione të tjera të kësaj apo çfarëdo afati tjetër të kësaj Marrëveshjeje ose efektivitetin e kësaj Marrëveshjeje sipas ligjeve të këtyre juridiksioneve të tjera.

Neni 22

Gjuha angleze

Kjo Marrëveshje është hartuar në gjuhën angleze. Nëse kjo Marrëveshje përkthehet në një gjuhë tjetër, teksti i gjuhës angleze do të ketë përparësi.

Neni 23

Anekset

Dokumentet e mëposhtme i bashkëlidhen kësaj Marrëveshjeje dhe janë pjesë përbërëse e saj:

Aneksi I: Specifikimet e Projektit

Aneksi II: Kërkesa e pagesës

Në dëshmi të kësaj, palët kanë marrë masa që kjo Marrëveshje të ekzekutohet në 3 (tri) origjinale në gjuhën angleze 2 (dy) për Bankën dhe 1 (një) për Marrësin dhe kanë marrë masa që përfaqësuesit e secilës Palë që të siglojnë çdo faqe të kësaj Marrëveshjeje në emër të tyre.

Në Poznan, më 5 korrik 2019

Nënshkruar për dhe në emër të:

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Ministri i Financave dhe Ekonomisë

Anila Denaj

Nënshkruar për dhe në emër të:

Banka Evropiane e Investimit

Drejtor i Përgjithshëm, zëvendësdyrëtor i Operacioneve

Luca Lazzaroli

Këshilltar ligjor:

Alessandro Cagnato

ANEKSI I

SPECIFIKIMET E PROJEKTTIT

Projekti synon të mbështesë Zbatuesin me Projektin e Rihzvivillimit Urban – Shtrati i Lumit Lana (Projekti), i cili përfshin punime përgjatë përafërsisht 1.8 km të lumit Lana dhe plotëson rehabilitimin e lumit të kryer përgjatë përafërsisht 16 km në rrjedhën e sipërme të zonës së Projektit në qytetin e Tiranës.

Projekti përfshin zgjerimin e dy bulevardëve, të cilat janë paralele me lumin Lana, përkatësisht bulevardet “Gjergj Fishta” dhe “Bajram Curri”, duke kontribuar në rigjenerimin urban përmes pajisjes së zonës rrethuese të lumit me infrastrukturë urbane (drenazhime, kanalizime, ndriçim publik, autobusë dhe korsi biçikletash) dhe përmirësimin e integritetit dhe lidhjes së dy brigjeve të lumenjve me qytetin. Gjithashtu do të përfshijë punime pastrimi në shtratin e lumit Lana, rregullimin dhe ridrejtimin e rrjedhës së lumit për të shmangur problemet e përmytjeve në këtë zonë.

Tubat e kanalizimeve do të vendosen si pjesë e punimeve, do të lidhen me rrjetin e kanalizimit, i cili aktualisht është duke u përmirësuar si pjesë e Projektit të Përmirësimit të Kanalizimit të Tiranës së Madhe. Paralelisht dhe si pjesë e këtij Projekti të Kanalizimeve, Autoriteti Kombëtar i Ujit (AKUK) po udhëheq ndërtimin e impiantit të parë të trajtimit të ujit në rrethin e Kasharit që pritet të përfundojë deri në fund të vitit 2022.

Granti do të bashkëfinancojë Projektin.

Investimi i përgjithshëm pritet të financohet si më poshtë:

Treguesit e buxhetit të Projektit EE & RE (EURO m)	
Huaja EIB	8
Granti ERI	2.4
Fondet personale të Zbatuesit	13.37
TOTALI	23.77

Zbatuesi do të ketë autoritet kontraktues për zbatimin e projektit.



ANEKSI II
KËRKESA E PAGESËS

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë – SHTRATI I LUMIT LANA – PROJEKT I
RIZHVILLIMIT URBAN - GRANTI ERI

Data:

Ju lutem vijoni me pagesën e mëposhtme që do të përdoret për financimin e Projektit:

Emri i grantit:

**SHTRATI I LUMIT LANA – PROJEKT I RIZHVILLIMIT
URBAN-
Granti ERI**

Data e nënshkrimit:

Numri FI i Marrëveshjes
(nëse është e zbatueshme):

Shuma e kërkuar euro	
EURO	Shuma

Data e propozuar e disbursimit:

Rezervuar për EIB-in	EURO
Shuma totale e grantit:	
Paguar deri më sot:	
Bilanci për pagesë:	
Pagesa aktuale:	
Bilanci pas pagesës:	

Llogaria që do të kreditohet:

Nr. llog.:

(Ju lutem, jepni formatin IBAN ose formatin përkatës në përputhje me praktikën bankare lokale)

Nr. i Kodit BIC:

Emri dhe adresa e Bankës:

Ju lutem, transmetoni informacionin e duhur, për:

Emri dhe nënshkrimi i personit të autorizuar për të vepruar në emër të Zbatuesit:

**UDHËZIM****Nr. 9, datë 25.10.2019****PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË 14.5.2019 “PËR KRITERET DHE NIVELIN E VLERËSIMIT, SI DHE DETAJIMI I PIKËSIMIT PËR TË GJITHA KATEGORITË UJORE NË UJËRAT E BRENDSHME, FORMAT E TJERA TË PESHKIMIT NË DET PA PËRDORIMIN E MJETEVE LUNDRUESE, DHE ZHVILLIMIN E AKUAKULTURËS NË SIPËRFAQE PUBLIKE TOKËSORE DHE UJORE, PËR PROCEDURËN E KONKURRIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 7, të nenit 30, dhe të pikës 3, të nenit 52, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, si dhe pikës 19, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 712, datë 31.7.2013 “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural,

UDHËZOJ:

1. Në kreun III “Kriteret e konkurrimit dhe të vlerësimit”, të udhëzimit nr. 4, datë 14.5.2019 “Për kriteret dhe nivelin e vlerësimit, si dhe

detajimi i pikësimit për të gjitha kategoritë ujore në ujërat e brendshme, format e tjera të peshkimit në det pa përdorimin e mjeteve lundruese, dhe zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike tokësore dhe ujore, për procedurën e konkurrimit publik”, pas pikës 10, shtohet pika 10/1 me këtë përmbajtje:

“Pika 10 e kreut III, nuk zbatohet në rast se paraqitet një konkurrent i vetëm. Ky përjashtim nuk zbatohet në rastin e lagunave bregdetare dhe të akuakulturës”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, dhe Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi**

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 1008 (4264), datë 11.9.2019, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasës Eni Bujar Themeli, e lindur më datë 18.8.1992, dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë e Shoqatës Shqiptare “Projekti Shpresa”, Shkodër.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 364 lekë